

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 17

ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË

EUROPEAN AND SECURITY AFFAIRS

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi botues:**Kryetar:**

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Anëtarë të Bordit, Rrjeti i Menaxhimit të Sigurisë:

Arian Dyrmishi, MA

Agron Sojati, MA

Gjergji Vurmo, MA

Mariola Qesaraku, MA

Besnik Baka, MA

Elona Dhëmbo, Kandidate për Dr

Edlira Peço, Kandidate për Dr

Besar Likmeta

Genc Kojdheli, MA

Eurona Leka, MA

Geron Kamberi, MA

Konsulentë:

Artan Karini – Kandidat për Dr., Universiteti i Manchester (UK)

Arshi Cela, Dr

Redaktor përgjegjës:

Elira Hroni – MA

Ndihmuan në përgatitje:

Besiana Kuçi

Egest Gjokutaj

Marsida Bandilli

Denisa Kamberi

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** dhe **Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund**

PËRMBAJTJA

Paul Belkin

Sfidat e Sigurisë Energjitike 7

Stefan Bouzarovski

Një perspektivë kritike ndaj reformave post-socialiste në
fushën e energjisë: kufijtë e ngatërruar, shkallët dhe
trajktoret e ndryshimit. 48

CSIS-EKEM - Raporti i Politikës

Rilidhja e Ballkanit Perëndimor: Dimensioni i Energjisë 78

Viktoriya Khasson

Debate dhe interesa në marrdhëniet energjitike midis BE-
Rusi 91

Dušan Janjić

Siguria Energjitike dhe Konflikti Etnik – Sfidat në Ballkanin
Perëndimor 121

Summary 132

Paul Belkin*

SFIDAT E SIGURISË ENERJGJITIKE TË BASHKIMIT EVROPIAN

30 janar 2008

Përmbledhje

Rritjet e fundit në çmimin e energjisë dhe rritja e vazhdueshme e kërkesës globale për energji, e cila pritet që të rritet me afërsisht 60% gjatë 20 viteve të ardhshme, ka çuar në angazhimin e politikë-bërësve të ShBA-së në një debat të gjerë mbi mënyrën më të mirë për adresimin e kërkesave të ardhshme të vendit për energji. Në mënyrë të njëjtë, siguria energjitike është bërë prioritet për Bashkimin Evropian (BE) dhe 27 vendet anëtare të tij. BE-ja importon rreth 50% të nevojave të saj për energji. Pa marrë parasysh ndonjë ndryshim domethënës, Komisioni Evropian pret që kjo shifër të rritet në 65% deri në vitin 2030. Rreth gjysma e importeve të gazit natyror të Bashkimit Evropian dhe 30% e naftës së importuar prej tij vijnë nga Rusia. Varësia në rritje e Evropës prej energjisë ruse dhe marrëveshjet afatgjata energjitike ndërmjet firmave ruse dhe disa qeverive evropiane kanë krijuar spekulime sipas të cilave, Moska po përdor “armën e saj energjitike” në përpjekje për të ndikuar politikën e jashtme dhe atë ekonomike evropiane.

BE-ja ka ushtruar tradicionalisht pak ose aspak ndikim mbi politikën e energjitike individuale të vendeve anëtare. Megjithatë, në mars 2007, kundrejt shqetësimit në rritje për varësinë e Evropës nga energjia ruse si edhe përballë presionit publik në rritje për adresimin e ndryshimeve globale klimaterike, vendet anëtare të BE-së ranë dakord për krijimin e një “Politike të Energjisë për Evropën”. Ata kanë rënë dakord për vendosjen e një sërë objektivash të gjerë, disa prej të cilave ligjërisht të detyrueshme, për shtimin e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe për uljen e nxjerrjes së karbonit. Megjithatë, vendet anëtare vazhdojnë të ndjekin politika të ndryshme të jashtme energjitike, veçanërisht kundrejt Rusisë, dhe disa vende evropiane mbeten ende ngurruese për të dorëzuar kontrollin kombëtar mbi tregjet e energjisë.

*Analist në çështjet Evropiane, Departamenti i Punëve të Jashtme, Mbrojtjes dhe Tregtisë

Shtetet e Bashkuara dhe Evropa kanë zgjeruar në mënyrë të vazhdueshme dialogun transatlantik të energjisë, për të përfshirë nxitjen e përbashkët të sigurisë energjitike, eficientë energjitike dhe burimeve alternative të energjisë. Në samitin ShBA-BE në prill 2007, udhëheqësit e të dy brigjeve të Atlantikut ranë dakord që të avancojnë bashkëpunimin drejt zhvillimit të teknologjive alternative dhe të energjisë së rinovueshme. Megjithatë, zyrtarët e ShBA-së kanë shprehur shqetësimin e tyre kundrejt ngurrimit të disa vendeve evropiane për të ushtruar më tepër presion ndaj Ruisë, që ajo ti bindet parimeve të tregut të BE-së. Nga ana tjetër, udhëheqësit evropianë duken gjithnjë e më të shqetësuar nga ngurrimi i ShBA-së për të qenë pjesë e kuadreve detyruese rregullative shumëpalëshe për uljen e sasisë së karbonit të çliruar dhe për nxitjen e eficientë energjitike.

Anëtarët e Kongresit kanë shprehur interes në përpjekjet e tyre për të rritur sigurinë energjitike evropiane, sidomos kundrejt Ruisë. Në sesionin e parë të legjislaturës së 110-të të Kongresit, komitetet mbajtën seanca dëgjimore rreth çështjes së varësisë energjitike evropiane ndaj Ruisë, dhe për përpjekjet evropiane për rritjen e eficientë energjitike dhe rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme. Sesioni i dytë i legjislaturës së 110-të të Kongresit mund gjithashtu të mbajë seanca dëgjimore dhe të ndërmarrë ligje mbi aspekte të ndryshme të politikës energjitike të BE-së.

Ky raport analizon disa prej sfidave më kritike të Evropës në fushën e energjisë dhe përpjekjet e BE-së për të koordinuar një strategji të përbashkët evropiane energjitike. Ai përfshin gjithashtu një përmbledhje të gjerë të bashkëpunimit transatlantik për sigurinë energjitike dhe do të përmirësohet më tej sipas nevojave. Për më tepër informacion shih edhe Raportin e CRS-së *RL34261 "Politika Energjitike e Ruisë kundrejt Vendeve Fqinje"* nga Steven Woehrel dhe Raportin e CRS-së *RS22409 "NATO dhe Siguria Energjitike"* nga Paul Gallis.

Sfidat e Sigurisë Energjitike të Bashkimit Evropian

Hyrje¹

Edhe pse 27 vendet anëtarë të Bashkimit Evropian (BE) kanë hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre kombëtar (ose kompetencave

¹ Ky raport u konceptua dhe u shkrua në origjinal prej ish-analistit të CRS-së Vince L., Morrelli

të tyre) në një sërë fushash duke ia dhënë institucioneve të BE-së, përfshirë dhe politikën ekonomike dhe atë të tregtisë, politika energjitike mbetet kryesisht përgjegjësi e vendeve anëtare. Vendimet për sa i përket blerjeve afatgjata të rezervave të naftës dhe gazit natyror, zhvillimit dhe përmirësimit të infrastrukturës që lidhet me energjinë dhe përdorimit të lëndëve djegëse të veçanta vazhdojnë të merren në nivel kombëtar individualisht prej secilit prej vendeve anëtare.

Në samitin e tyre të marsit 2007, vendet anëtare të BE-së u orientuan drejt rritjes së koordinimit evropian për të ndihmuar sigurimin dhe diversifikimin e furnizimeve me energji, për të rritur zhvillimin dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe alternative të energjisë brenda BE-së dhe për uljen e kërkesës dhe konsumit të energjisë. Edhe pse qeveritë e vendeve anëtare mbeten ende ngurruese për sa i përket dorëzimit të sovranitetit kombëtar mbi aspektet e sigurisë energjitike të politikave të tyre të jashtme, ato kanë vendosur objektiva detyruese mbarë evropiane për përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe të lëndëve djegëse bio, dhe kanë rënë dakord për objektiva ambicioze por gjithsesi jo ligjërish të detyrueshme lidhur me efikasitetin energjitike dhe me uljen e çlirimit të karbonit për vitin 2020. Për më tepër, vendet anëtare po konsiderojnë reforma potencialisht të rëndësishme për liberalizimin e mëtejshëm të tregjeve energjitike. Megjithatë, shumë vëzhgues presin që vendet anëtare të vazhdojnë të kenë një nivel të konsiderueshëm kontrolli kombëtar mbi tregjet kombëtare të energjisë dhe mbi marrëdhëniet e jashtme me vendet prodhuese të energjisë. Kryetarët e shteteve të BE-së kanë vendosur të diskutojnë propozime specifike për politika në këto fusha gjatë samitit të pranverës së vitit 2008.

Interesi i rinovuar i Evropës për sigurinë energjitike është ndikuar prej faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Së brendshmi, çmimet e energjisë në rritje të vazhdueshme, ulja e prodhimit evropian të energjisë, dhe një treg i brendshëm energjistik i fragmentuar kanë kontribuar në krijimin e shqetësimit mbi aftësinë e Evropës për të përmbushur kërkesat për energji në të ardhmen. Rritja në kërkesën globale për energji e ushtruar nga ekonomitë në rritje si India dhe Kina, paqëndrueshmëria e vazhdueshme në rajonet prodhuese të energjisë, kërcënimi i sulmeve terroriste ndaj infrastrukturës energjitike dhe vullneti i dukshëm i Rusisë për të përdorur fuqinë e saj energjitike për qëllime politike, ngrenë të gjitha shqetësime për Evropën lidhur me mënyrën se si t'u adresohet shqetësimeve të jashtme që mund të ndikojnë mbi aftësinë e saj për përmbushjen e

kërkesave të ardhshme për energji.² Thirrjet e fundit për një koordinim energjistik mbarë-evropian janë udhëhequr nga shqetësimi evropian në rritje mbi efektet e prodhimit dhe konsumit të energjisë mbi ndryshimin klimaterik global. Me këtë qëllim, vendimet në kuadër të politikës energjitike të vendeve anëtare të BE-së kanë në qendër nxitjen e efijencës energjitike, zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe të burimeve të lëndëve djegëse të pastra, dhe uljen e nivelit të çlirimeve në ajër të gazrave serrë.

Duke qenë se ekzistojnë shqetësime të vazhdueshme rreth furnizimit dhe kërkesës globale për energji, çështjet që i përkasin ShBA-së, Evropës dhe sigurisë energjitike globale mund të marrin më tepër rëndësi në sesionin e dytë të Kongresit të 110-të. Anëtarët e të dyja partive kanë prezantuar nxjerrje ligjesh që synojnë rritjen e pavarësisë energjitike dhe sigurisë energjitike dhe uljen e çlirimeve të karbonit. Disa prej këtyre propozimeve përmbajnë skema të tregtimit të karbonit të njëjta me ato që përdoren në Evropë.³ Në disa seanca dëgjimore gjatë sesionit të parë të Kongresit të 110-të, anëtarët e Kongresit shprehën shqetësime rreth varësisë së Evropës ndaj burimeve energjitike të Rusisë dhe mbi potencialin për manipulim nga ana e Rusisë të tregjeve të energjisë Evropiane. Me këtë qëllim, Senatori Richard Lugar ka propozuar mundësinë për një rol më aktiv të NATO-s në garantimin e sigurisë energjitike për anëtarët e Aleancës.

Konteksti i Debatit për Sigurinë Energjitike të Evropës

Histori

Të marra së bashku, vendet anëtare të BE-së importojnë gjysmat e nevojave të tyre energjitike. Duke patur parasysh ndryshimet e mëdha politike, kjo shifër pritet të rritet në 65% deri në vitin 2030.⁴ Sot nafta, gazi natyror dhe qymyri përbëjnë 80% të energjisë së konsumuar në BE.

² Jos Van Gennip, “*Siguria Energjitike*.”, Letër nga Asambleja Parlamentare e NATO-s, 2006.

³ Për më shumë informacion mbi sistemin e tregtimit të nxjerrjeve të karbonit në Evropë shih CRS Report RL33581, “Ndryshimi Klimaterik: Sistemi i Tregtimit të Emisioneve të Bashkimit Evropian (EU-ETS)” nga Larry Parker.

⁴ Shih, “*Energy overview, Council of the European Commission*”, qershor 2006; Komunikatë nga Komisioni Këshilli Evropian dhe Parlamenti Evropian COM(2007) 1. 10 janar 2007.

Importet energjitike të Evropës vijnë kryesisht nga Rusia dhe Lindja e Mesme, nga ku e kanë origjinën rreth 70% e furnizimeve botërore me naftë dhe gaz natyror. Ende, rajoni i Lindjes së Mesme është i mbushur me luftë, terror dhe me regjime politike të paqëndrueshme. Prodhimi i naftës në Irak ende nuk ka arritur nivelet e para-luftës dhe ekziston frika se grupet terroriste mund të piketojnë tubacionet e naftës dhe pajisjet e tjera të prodhimit të saj në rajon. Irani ka kërcënuar se do të ndërpresë prodhimin e naftës nëse do të detyrohet që të braktisë programin e tij bërthamor. Për sa i përket Rusisë, sjelljet e fundit politike dhe ekonomike të shfaqura prej Moskës kanë ngritur spektrin e dyfishtë të besueshmërisë dhe “politikave energjetike”.

Kërkesa e lartë ka ngritur gjithashtu çështje që i përkasin disponueshmërisë në të ardhmen të rezervave të naftës dhe gazit natyror. Edhe pse nuk janë projektuar shkurtime domethënëse për dekadat e ardhshme, pasiguritë për shfrytëzimin dhe prodhimin e ardhshëm në zona të tilla si Rusia dhe Lindja e Mesme kanë ngritur shqetësime rreth disponueshmërisë afatgjatë të furnizimit. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (ANE) vlerëson se gjatë 30 viteve të ardhshme mund të nevojiten afro 16 trilionë USD për investime të reja për të përmbushur kërkesat e ardhshme globale për energji.⁵

Shqetësimet evropiane lidhur me sigurimin e furnizimit të saj me energji dolën në pah gjatë embargos arabe të naftës të viteve 1970-të. Në veçanti, embargoja theksoi tre çështje kryesore. Së pari, ajo nxori në pah nevojën për rritjen e bashkëpunimit në politikën energjitike ndërmjet vendeve evropiane si edhe ndërmjet Evropës dhe botës prodhuese të energjisë. Së dyti, u bë e qartë se mekanizmat institucionalë për rritjen e koordinimit në rast se paraqiteshin ndërprerje të tjera të furnizimit në të ardhmen, ishin të domosdoshëm. Së treti, u ra dakord që Evropa duhet të përgatitë strategji që të mos e lënë atë që të jetë viktimë e përpjekjeve të ardhshme nga vendet eksportuese për të përdorur energjinë si një armë ekonomike ose politike.⁶ Krijimi në vitin 1974 i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (ANE) e cila është bërë instrumenti kryesor i Evropës për të monitoruar dhe analizuar tregjet botërore të energjisë, ishte një përgjigje ndaj embargos. Në vazhdim të kësaj, vendet evropiane u përpoqën të zhvillonin strategji për diversifikimin e furnizimit me energji.

⁵ Shih Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (ANE), “*World Energy Investment Outlook*.”, 2005.

⁶ Daniel Yergin, “*Sigurimi i Sigurisë Energjitike*” *Foreign Affairs*, mars/prill 2006.

Pas embargos, vendet evropiane filluan të identifikonin Rusinë dhe vende të tjera Euroaziatike si furnizues potencialë me energji. Në atë kohë, Rusia sovjetike po fillonte të kuptonte potencialin e saj për prodhimin e energjisë por i nevojiteshin investime të mëdha në këtë sektor. Mundësia për një bashkëpunim në të ardhmen në fushën e energjisë filloi të luajë një rol kryesor në perspektivat evropiane për zhvillimin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik.

Në vitin 1991, Bashkimi Evropian inicioi Deklaratën e Kartës së Energjisë, një iniciativë e cila synonte të nxiste bashkëpunimin në fushën e energjisë dhe të diversifikonte furnizimin me energji të Evropës.⁷ Deklarata i hapi udhë në vitin 1994 Traktatit të Kartës së Energjisë i cili hyri në fuqi në vitin 1998 dhe krijoi një kuadër rregullash dhe marrëveshesh për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar për energjinë. Deri më sot, 51 vende dhe BE-ja kanë aderuar ose kanë nënshkruar traktatin në fjalë.⁸ Traktati synon të krijojë një nivel të zhvillimit të lojës për rregullat që lidhen me nxitjen investimeve të huaja në energji; tregtisë së lirë të materialeve, produkteve dhe prodhimeve energjitike; lirinë e kalimit transit të energjisë nëpërmjet tubacioneve dhe rrjeteve si dhe të japë mekanizmat e duhura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.⁹

Që prej nënshkrimit të Traktatit të Kartës së Energjisë, Komisioni Evropian ka përdorur kompetencat e tij ekzistuese në fushat e konkurrencës, të mjedisit dhe politikën e mbrojtjes së konsumatorit për t'u përpjekur që të hartojë një politikë Evropiane të energjisë me anë të një sërë mënyrash.¹⁰ Këtu përfshihen nxitja e një tregu të brendshëm të gazit dhe elektricitetit, inkurajimi i zhvillimit të alternativave për furnizimin me energji si edhe, në

⁷ Për një informacion më të detajuar mbi Traktatin shiko "Një Hyrje në Traktatin e Kartës së Energjisë." Organizata e Kartës së Energjisë. Në: [<http://www.encharter.org>].

⁸ Edhe pse ShBA-ja ka firmosur në vitin 1991 "*Deklaratën për Kartën e Energjisë*" ajo nuk ka firmosur "*Traktatin e Kartës së Energjisë*" dhe prandaj mban statusin e vëzhguesit në procesin e Kartës. Zyrtarët e ShBA-së, kanë theksuar dëshirën për ti ndjekur çështjet që lidhen me energjinë në nivel bilateral.

⁹ "Një Hyrje në Traktatin e Kartës së Energjisë.", cituar më sipër.

¹⁰ Komisioni Evropian është organi ekzekutiv i BE-së dhe ka të drejtën ekskluzive për ndërmarrjen e iniciativave ligjore. Megjithatë, në shumë fusha të politikë-bërjes, Komisioni mbetet thjesht një organ administrativ në shërbim të përfaqësuesve të qeverive kombëtare, të cilat përbëjnë trupin kryesor vendimmarrës të BE-së, Këshillin e Ministrave. Për më shumë informacion shiko CRS Report RS21372, "*Bashkimi Evropian: Pyetje dhe Përgjigje*.", nga Kristin Archick.

bashkëpunim me Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, ndjekja e një qasjeje më bashkëpunuese për marrëdhëniet e jashtme me furnizuesit aktualë me energji por dhe ata të ardhshëm.

Kthesa

Marrëveshja për gazsjellësin gjermano-rus e vitit 2005 dhe manipulimet më të fundit të Ruisë me prurjet e gazit dhe naftës në tregun evropian, kanë shpërndarë një ndjesi të re emergjence ndërmjet udhëheqësve evropianë për sa i përket nevojës për një strategji më të koordinuar. Këto ngjarje korrespondojnë me shqetësimin në rritje ndërmjet publikut dhe klasave politike evropiane për sa i përket lidhjes midis prodhimit dhe konsumit të energjisë dhe ndryshimeve klimaterike globale.

Në 2005, Gjermania dhe Rusia ranë dakord të ndërtonin një gazsjellës që lidhte vendet poshtë Detit Baltik, i ashtuquajturit Gazsjellësi i Evropës së Veriut (NEGP). Ndërsa Gjermania theksonte se gazsjellësi do të rriste në mënyrë të dukshme sigurinë dhe furnizimin energjitik të Gjermanisë dhe si rrjedhojë edhe të Evropës, një sërë vendesh evropiane duke përfshirë Poloninë dhe Lituaniën, protestuan kundër këtij vendimi. Ato ankohen se duke e kaluar gazsjellësin nën det, pra duke i anashkaluar të dy vendet në fjalë, dhe duke mos u konsultuar me vendet fqinje anëtare të BE-së kur negocioi me Rusinë, veprimet e Gjermanisë përbëjnë një kërcënim për sigurinë e tyre energjitike dhe për atë evropiane në përgjithësi.¹¹ Për më tepër zyrtarë suedezë me influencë kanë ngritur shqetësimin se gazsjellësi do t'i japi shkas Ruisë për të rritur prezencën dhe mbikëqyrjen ushtarake në rajonin me rëndësi strategjike të Detit Baltik.¹² Marrëveshja gjermano-ruse dhe reagimet në vazhdim të Lituaniës dhe Polonisë si dhe reagimi më i fundit i Suedisë kanë ri-ngjallur thirrjet për një strategji energjitike evropiane më të koordinuar.

Në vazhdim të konfliktit të brendshëm mbi gazsjellësin gjerman, mosmarrëveshjet ndërmjet Ruisë dhe Ukrainës dhe Ruisë dhe Bjellorusisë kanë nxjerrë në pah disa pasoja të padëshirueshme të varësisë evropiane ndaj burimeve energjitike ruse. Në fund të dhjetorit të vitit 2005, monopoli i gazit rus, Gazprom, ndërpreu përkohësisht rrjedhjen e gazit për Ukrainën

¹¹ "Shtypi Polak Kritikon Schroeder-in e Gjermanisë mbi Akordin e Gazsjellësitil." Agence France-Presse, 12 dhjetor, 2005.

¹² "Suedia e frikësuar nga Hija Ruse," Spiegel Online. 15 nëntor, 2006.

për shkak të një mosmarrëveshjeje mbi rritjen e çmimit të gazit. Disa orë pas ndërprerjes, disa vende evropiane, duke përfshirë Austrinë, Italinë, Poloninë dhe Gjermaninë raportuan rënie në presionin e gazsjellësve të tyre me një shifër që shkante deri në 30%.¹³ Kriza e gazit zgjati vetëm disa ditë dhe pasi Rusia dhe Ukraina ranë dakord mbi çmimet e gazit, gazi rrodhi sërish.

Një mosmarrëveshje thuajse identike ndërmjet Ruisë dhe Bjellorusisë me pasoja të ngjashme për vendet evropiane, sidomos për Gjermaninë, ndodhi në fillim të janarit të vitit 2007. Këtë herë, operatori i naftës-jellësit rus Transneft mbylli naftës-jellësin Druzhba nëpërmjet të cilit Gjermania merr 20% të importeve të saj të naftës. Gjermania dhe BE-ja kritikuan ashpër vendimin e Ruisë dhe ajo rifilloi furnizimin me naftë pas tri ditësh dhe pas negociimit të çmimeve me Bjellorusinë.

Shumë vëzhgues evropianë i kanë karakterizuar krizat e gazit dhe naftës Rusi-Ukrainë dhe Rusi-Bjellorusi si “një thirrje për t’u zgjuar” e cila nxjerr në pah brishtësinë e sigurisë energjitike të Evropës, edhe në rastet e ndërprerjeve të paqëllimita. Gjithsesi, ajo që është më e rëndësishme, është se kriza ngriti çështjen e dyfishtë mbi besueshmërinë e Ruisë si një partner energjitik dhe mbi dëshirën e Moskës për të përdorur fuqinë e saj energjitike si një armë politike. Në përgjigje të kësaj, udhëheqësit evropianë kanë bërë thirrje për vendime të koordinuara mbi furnizimin me energji, me qëllim që të paraqiten si një fron i unifikuar para vendeve prodhuese si Rusia, dhe kanë nxitur eficientësinë energjitike dhe një përdorim më efikas të energjisë. Pavarësisht këtyre thirrjeve, një sërë vendesh evropiane dhe një sërë kompanish energjitike kanë vazhduar të lidhin marrëveshje bilaterale afatgjata për energjinë. Gjatë viteve të shkuara, kompanitë nga Italia, Austria, Bullgaria dhe Serbia kanë nënshkruar kontrata me kompanitë energjitike ruse të cilat sipas disa vëzhguesve mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e përbashkët evropiane të energjisë.

Konsumi Evropian i energjisë: në shifra.


27 vendet anëtare të BE-së zënë afërsisht 17% të konsumit total të energjisë në botë.¹⁴ Në vitin 2005 rreth 80% e energjisë

¹³ Shih “Q&A: *Ukraine Gas Row.*” BBC News, 4 janar, 2006; dhe CRS Report RS22378, “*Ndërprerja Ruse e Gazit Natyror ndaj Ukrainës: Konteksti dhe Implikimet.*”, nga Jim Nichol, Steven Woehel dhe Bernard A. Ghelb.

¹⁴ Country Analysis Briefs: “*Bashkimi Europian, Administrata e Informacionit mbi Energjinë*”, janar 2006.

së konsumuar brenda bashkimit Evropian ishte lëndë djegëse fosil. **Figura 1** paraqet një përmbledhje të konsumit të energjisë në BE sipas burimit të lëndëve djegëse.

Evropa ka importuar rreth 50% të totalit të furnizimit të saj me energji, diçka më shumë se 80% e naftës së konsumuar dhe afërsisht 57% e gazit të saj natyror. Varësia e saj prej burimeve të importuara të energjisë sidomos prej gazit natyror, pritet të rritet në mënyrë të vazhdueshme gjatë dekadave në vazhdim. Vlerësime të Komisionit sugjerojnë se nëse tendencat aktuale vazhdojnë, Evropa do të importojë 65% të kërkesave të saj totale për energji deri në vitin 2030.¹⁵ Rusia, Norvegjia, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore janë furnizuesit më të mëdhenj të energjisë për BE-në. Në vitin 2005 Rusia zinte 45% të importeve të gazit natyror të BE-së dhe rreth 29% të importeve të saj të naftës.¹⁶



Burimi: Komisioni Evropian “Energjia dhe Transporti në Figura”, Libri Statistikor 2007.

Parashikuesit parashikojnë se konsumi i gazit natyror në BE do të dyfishohet në 25 vitet e ardhshme dhe se gazi është shndërruar me ritme të shpejta në lëndën djegëse të preferuar të Evropës për gjenerimin e energjisë. Konsumi i gazit natyror në Evropë aktualisht përfaqëson 18% të konsumit botëror.

¹⁵ “Një Politikë Energjitike për Europën.” cituar më sipër

¹⁶ Të Dhëna nga Politika Energjitike e BE-së, Dokument i Komisionit Evropian, SEC(2007)12, 10 Janar, 2007; “Komisioni Evropian “Energjia dhe Transporti në Figura”, statistical pocket book 2007”, në [http://ec.europa.eu/dgs/energy_transport/figures/pocketbook/2006_en.htm].

Importet e gazit të Evropës pritet të arrijnë pak më shumë se 80% të konsumit total në vitin 2030.¹⁷ Në vitin 2004, vendet anëtare të BE-së dhe Norvegjia zunë më shumë se gjysmën e furnizimit me gaz natyror të Evropës. Gjysma tjetër u importua kryesisht prej Rusisë (29%) dhe Algjerisë (13%). Disa vende anëtare të BE-së janë tërësisht të varura prej gazit natyror rus për konsumin e tyre të brendshëm. **Tabela 1** pasqyron nivelet e varësisë nga gazi natyror rus për vendet e përzgjedhura nga BE.

Table 1. Imported Gas and Gas from Russia

Country	Dependence on Imported Gas, 2005	Total Gas Consumed, Imported from Russia
Austria	88%	74%
Czech Republic	98%	70%
Estonia	100%	100%
France	98%	26%
Finland	100%	100%
Germany	81%	39%
Italy	85%	30%
Poland	70%	50%

Burimi: Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë; Eurostat; British Petroleum

Një politikë energjitike për Evropën ?

Shqetësimet lidhur me varësinë e Evropës ndaj burimeve ruse të energjisë kanë korresponduar me thirrjet publike gjithmonë e në rritje, për një veprim të BE-së mbi ndryshimet klimaterike. Udhëheqësit evropianë janë përgjigjur duke ri-filluar përpjekjet për vendosjen e një politike evropiane energjitike më gjithëpërfshirëse. Gjatë samitit të tyre në mars të vitit 2007 udhëheqësit e vendeve të BE-së miratuan një sërë propozimesh të Komisionit Evropian, të cilat ata mendojnë se do të shërbejnë si baza për krijimin e një "Politike të Energjisë për Evropën". Masat e ndërmarra janë pjesë e një grupi më të madh rekomandimesh të shpallura prej Komisionit në një "*Green Paper*" (*Letra Jeshile*) të marsit 2006 dhe planesh më të detajuara veprimi që u prezantuan në janar 2007 dhe 2008.¹⁸ Propozimet

¹⁷ Ibid.

¹⁸ *Green paper* i Komisionit ashtu dhe planet e detajuara të veprimit gjenden në [http://ec.europa.eu/energy/energy_policy/index_en.htm]

e Komisionit përqendrohen në tre qëllime kryesore të ndërlidhura me njëri-tjetrin: rritja e sigurisë energjitike në nivel mbarë-evropian; rritja e qëndrueshmërisë dhe forcimi i konkurrencës në tregun e brendshëm të energjisë së Evropës. Zyrtarët e Komisionit kanë vlerësuar si shumë të rëndësishme lidhjet ndërmjet sigurisë energjitike, efikasitetit të përdorimit të saj, dhe uljes së sasisë së karbonit të çliruar në mbarë BE-në.

Në atë që disa e konsiderojnë si një reflektim i presionit publik në rritje për adresimin e ndryshimeve klimaterike globale si edhe një ngurrimi i vazhdueshëm i vendeve anëtare për të hequr dorë nga autoriteti në hartimin e politikave ekonomike dhe të jashtme, politika e energjisë e propozuar nga BE fokusohet gjerësisht në nxitjen e qëndrueshmërisë. Vendet anëtare kanë rënë dakord në parim që të ndërmarrin disa hapa drejt liberalizimit të mëtejshëm të tregut energjistik të BE-së dhe kanë përqafuar gjerësisht koordinimin e politikave të jashtme për sigurimin e furnizimit me energji. Megjithatë, përpjekjet më të arrira evropiane fokusohen në rritjen e efikasitetit energjistik, uljen e efekteve të gazeve serë dhe nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe të lëndëve djegëse alternative dhe të teknologjive që lidhen me to.

Më konkretisht, vendet anëtare të BE-së kanë rënë dakord për uljen e totalit të çlirimit të karbonit në nivel evropian me 20% krahasuar me nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2020. Ato janë zotuar gjithashtu për të kërkuar marrëveshje ndërkombëtare për uljen me 30% të nxjerrjes së karbonit brenda vitit 2020 me anë të një traktati post-Protokollit të Kjotos për uljen ndërkombëtare të çlirimit të karbonit.¹⁹ Në vazhdim BE-ja kërkon një ngritje prej 20% në efikasitetit energjistik në nivel mbarë evropian brenda vitit 2020 dhe është zotuar që 20% e të gjithë energjisë evropiane vjen nga burime të rinovueshme si edhe 10% e karburantit që përdoret për transport të jetë bio brenda vitit 2020. Komisioni shpreson se kryetarët e shteteve të BE-së do të bien dakord mbi objektiva specifike në nivel shteti për të arritur qëllimet e tyre gjatë pranverës së vitit 2008.

Presidenti i Komisionit Evropian Jose Manuel Barroso vlerëson se arritja e këtyre objektivave mund të kushtojë deri në 87.7 miliardë USD ose 0.5% e GDP-së së përbashkët vjetore të vendeve të BE-së. Megjithatë, ai argumenton se kjo kosto

¹⁹ Protokollit i Kjotos i Kombeve të Bashkuara, ku ShBA nuk bën pjesë, është menduar që të përfundojë në vitin 2012. Udhëheqësit Evropianë gjithnjë e më shumë shohin vitin 2009 si afati përfundimtar për të rënë dakord mbi një traktat post-Kjoto.

është afërsisht 4.50 USD (3 Euro) për javë për çdo qytetar Evropian dhe përfaqëson shumë më pak se koston e mosveprimit.²⁰ Sipas një studimi të marsit të vitit 2007 ndërmarrë nga firma konsulente McKinsey and Company, vendet anëtare të BE-së do të nevojiten të investojnë për afërsisht 1.5 trilionë USD (1.1 trilionë Euro) në teknologji të reja gjatë 14 viteve në vazhdim për të përmbushur objektivat e tyre. Gjatë përgatitjes për shtysën e re drejt burimeve alternative dhe të rinovueshme të energjisë, Banka Evropiane e Investimeve ka prezantuar plane për dhënien e mbi 1 miliardë USD-ve (800 milionë Eurove) për kredi për projekte për energji të rinovueshme gjatë periudhës 2007-2010.²¹ Për më tepër, Komisioni parashikon 50% rritje në shpenzimet e BE-së për teknologjinë e karbonit gjatë shtatë viteve të ardhshme. Edhe pse qasja e BE-së duket se është e përqendruar gjerësisht në zhvillimin e teknologjive të reja dhe alternative, studimi i McKinsey-t sugjeron se mund të jetë më efikase nga pikëpamja e kostos që BE-ja të përqendroj më shumë përpjekjet e saj për uljen e përdorimit të energjisë sesa në zhvillimin dhe promovimin e burimeve alternative dhe të rinovueshme energjitike.

Krizat e naftës dhe gazit ruso-ukrainase dhe ruso-bjelloruse kanë ndezur thirrje nga Komisioni Evropian dhe nga disa vende të BE-së për rritjen e koordinimit të politikës së jashtme për të siguruar dhe diversifikuar furnizimin me energji. Me këtë qëllim, vendet anëtare të BE-së kanë rënë dakord të fillojnë bashkëpunimin për të formuar një politikë të jashtme të përqendruar në zgjerimin e partneritetit me, dhe në shtimin e investimeve për gazsjellësit dhe infrastrukturën energjitike në, vendet prodhuese dhe në ato transite. Vendet Evropiane kanë përzgjedhur qëllimisht vendet e Azisë Qendrore dhe të rajonit të Detit Kaspik si pika kryesore për aktivitete të tilla. Në vazhdim, BE-ja ka bërë thirrje për formimin e një dialogu për energjinë me vendet Afrikane me rëndësi strategjike. Projekti kryesor i BE-së në Azinë Qendrore dhe në rajonin e Kaspikut është gazsjellësi Nabucco. Gazsjellësi i propozuar i cili mbështetet nga një premtim prej 7 miliardë USD (5 miliardë Euro) nga financimi i Komisionit Evropian, do të sillte në Evropë gazin e

²⁰ Shih "20 20 nga 2020: Mundësia e Evropës për Ndryshim Klimaterik" Fjalim nga Jose Manuel Barroso, 23 janar 2008 në: http://ec.europa.eu/commission_barroso/president/index_en.htm

²¹ "Synimet e 2020 të Evropës pritet të kushtojnë mbi 1 Trilion.," EU Observer, 28 mars 2007.

Azisë Qendrore dhe të Kaspikut pa kaluar në Rusi. Megjithatë, siç u diskutua dhe më sipër, data potenciale e fillimit të ndërtimit, është shtyrë për vite me radhë dhe disa vëzhgues vënë në pikëpyetje realizueshmërinë e projektit.

Lidhur me Rusinë, disa vende anëtarë shpresojnë që të institucionalizojnë një angazhim të përbashkët për ndjekjen e parimeve të tregut siç u theksua në Traktatin e Kartës së Energjisë, nëpërmjet një Dialogu Evropë-Rusi për Energjinë dhe në një Marrëveshje të re Partneriteti dhe Bashkëpunimi Evropë-Rusi. Megjithatë, marrëveshjet bilaterale energjitike ndërmjet disa vendeve anëtare veçanërisht Gjermanisë, Italisë dhe Bullgarisë dhe firmave Ruse pasqyrojnë mosmarrëveshje të vazhdueshme brenda BE-së mbi mënyrën sesi duhet marrë vesh më mirë me Moskën. Duke patur parasysh një mos-akordim të tillë, Komisioni Evropian po kërkon të forcojë mekanizmat shumëpalësh, duke përfshirë dhe Kartën e Energjisë, për një koordinim më të mirë të politikës botërore të energjisë ndërmjet vendeve prodhuese, konsumatore dhe atyre transit.

Shumë vëzhgues, e konsiderojnë thirrjen e Komisionit Evropian për të rritur konkurrencën brenda dhe ndërmjet tregjeve energjitike evropiane tradicionalisht të mbrojtura, si një nga më të kundërshtueshmet. Komisioni ka avancuar propozimet e tij për uljen e fuqisë së kompanive energjitike në pronësi të shtetit duke i detyruar ato që të ndajnë pronësinë e bizneseve të gjenerimit dhe shpërndarjes. Përpara kundërshtimit të vendeve të tilla si Gjermania, Franca dhe Spanja, Komisioni mund të kërkojë mbështetje nga një propozim kompromisi i cili do të lejonte industritë kombëtare të energjisë që të vazhdojnë të operojnë në pajisjet e gjenerimit dhe ato të shpërndarjes, por do ti vinte ato nën mbikëqyrjen e një institucioni rregullator evropian. Udhëheqësit evropianë pritet të bien dakord mbi një zgjidhje gjatë gjysmës së parë të vitit 2008.

Edhe pse udhëheqësit evropianë paguajnë gjithnjë e më shumë shërbime që i shërbejnë rritjes së bashkëpunimit për energjinë, sukcesi i një strategjie energjitike të BE-së do të varet me shumë gjasa në aftësinë e vendeve anëtare për të kaluar divergjencat në adresimin e tre sfidave kryesore. Së pari si të përdorim dhe zhvillojmë më tej një partneritet të fortë ndërmjet rajoneve prodhuese dhe transite të burimeve energjitike, së dyti si të përdorim dhe zhvillojmë më tej burime të brendshme dhe alternative të energjisë ndërsa synohet të frenohet konsumi i përgjithshëm, dhe së treti si të vendosim një sistem të brendshëm për t'i ofruar furnizim të varur dhe të sigurt me energji gjithë Evropës.

Sfida 1: Një politikë e Jashtme për Sigurinë Energjitike

Kërkesa në rritje për energji në 27 vendet e BE-së pasqyrohet në rajonet në të gjithë botën. Rritja në Kinë dhe Indi ka shtuar konsiderueshëm kërkesën globale ashtu siç ka bërë dhe rritja e numrit të popullsisë dhe modernizimi ekonomik në Amerikën Latine, Afrikë si edhe në rajonin e pasur me energji të Lindjes së Mesme. Përbalë kësaj përpjekjeje mbi furnizimin e limituar, evropianët duhet të konkurrojnë për burime ekzistuese dhe të reja energjitike. Projektimet për konsumin evropian të energjisë tregojnë se një nga sfidat më të rëndësishme të sigurisë energjitike me të cilën do të përballlet BE-ja gjatë 20 viteve të ardhshme do të jetë aftësia e Evropës për të diversifikuar burimet dhe mënyrat e tranzitimit të importeve të saj të energjisë.

Grupi i burimeve energjitike botërore që ndodhet në Rusi, rajonin e Detit Kaspik në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut janë të gjitha të arritshme gjeografikisht prej Bashkimit Evropian. Në fakt, Evropa merr tashmë furnizime me energji prej secilit prej këtyre rajoneve. Megjithatë, varësia në rritje e Evropës nga Rusia dhe dëshira e dukshme e Rusisë për të përdorur burimet e saj energjetike për qëllime politike kanë nxitur thirrje prej disa prej vendeve anëtare si edhe prej Shteteve të Bashkuara për një politikë mbarë evropiane dhe më gjithëpërfshirëse për diversifikimin e mëtejshëm të furnizimit. Kryesore për Evropën mund të jetë që të vendosë pikën e ekuilibrit për furnizim nga secili prej rajoneve dhe si të menaxhojë sa më mirë marrëdhëniet me qeveritë në ato rajone. Duke forcuar marrëdhëniet politike me këto qeveri, BE-ja hap mundësi shtesë për strategjinë e saj të jashtme energjitike. Sipas disave, strategjia e BE-së në këtë drejtim ndryshon prej qëllimit të theksuar nga shumë politikanë të ShBA-së dhe zyrtarë të Administratës së saj, sipas së cilës evropianët e dinë se nuk mund të arrijnë kurrë pavarësi energjitike të plotë dhe prandaj kërkojnë mënyra për të menaxhuar më mirë varësinë energjitike në vend që të synojnë të arrijnë menjëherë atë.²²

Vendet anëtare të BE-së i janë bashkuar të gjithë thirrjes së Komisionit për të zhvilluar një politikë të përbashkët ndërkombëtare për energjisë. Pavarësisht kësaj, ndërsa njihet fakti se BE-ja mund të jetë ndonjëherë në një pozicion më të mirë për të përcaktuar se çfarë mjetesh duhen përdorur për të çuar përpara interesat e përbashkëta të Bashkimit si një i vetëm, vendet anëtare kanë qenë të kujdesshme që të mos sakrifikonin

²² Intervistë e zyrtarëve gjermanë dhe atyre të BE-së, janar-mars 2007

të drejtat e tyre individuale për të ndjekur në mënyrë të pavarur marrëdhënie të jashtme për të siguruar furnizimin me energji. Marrëdhëniet e Evropës me Rusinë në fushën e energjisë sqarojnë më së miri tensionin që ekziston ndërmjet thirrjeve për një politikë të përbashkët të jashtme të energjisë dhe mbështetjes për politikën individuale të vendeve anëtare. Disa prej vendeve anëtare më të reja të BE-së në Evropën Qendrore dhe Lindore duken skeptikë ndaj besueshmërisë së Rusisë si një partner energjistik, dhe prandaj u bëjnë thirrje vendeve anëtare që të punojnë së bashku për të ndaluar që Rusia të shfrytëzojë varësitë afatgjata për qëllime politike. Në të njëjtën kohë vende të tjera anëtare vazhdojnë të ndërmarrin kontrata afatgjata dypalëshe për furnizim, me kompanitë shtetërore ruse të energjisë duke rritur varësinë energjetike dhe, sipas disave, edhe varësinë politike prej Rusisë.

Rusia.²³ Rusia është një nga lojtarët kryesorë në tregjet botërore të energjisë. Në vitin 2004, rezervat e saj të gazit natyror prej 1,700 trilionë fut kub (tcf) ishin më të mëdha nga çdo vend tjetër, duke e bërë atë në të njëjtën kohë prodhuesen dhe eksportuesen më të madhe të gazit në botë. Rusia është gjithashtu dhe eksportuesja e dytë më e madhe e naftës në botë. Sipas Komisionit Evropian vendet anëtare të BE-së, kanë importuar 29% të gazit natyror dhe 26% të naftës së tyre nga Rusia në vitin 2004.²⁴ Duke patur parasysh se konsumi i gazit pritet të rritet më shpejt sesa konsumi i naftës në të ardhmen, disa ekspertë parashikojnë se Evropa do të jetë e varur prej Rusisë për më shumë se 44% të sasisë së saj të gazit deri në vitin 2020.²⁵ Ndërsa burimet ruse dhe afërsia me Evropën bëjnë që bashkëpunimi evropiano-rus të jetë një domosdoshmëri, dëshira e dukshme e Rusisë për të përdorur pasurinë e saj energjitike për të arritur objektiva kontradiktore të politikës së saj të jashtme ka nxitur debatin brenda Evropës mbi mënyrën sesi të menaxhohen sa më mirë marrëdhëniet e saj energjitike me Rusinë.

Shumica e vëzhguesve theksojnë se Presidenti rus Vladimir Putin i shikon burimet e mëdha energjitike të vendit të tij si një mjet për të ri-fituar statusin e Rusisë si një forcë kryesore në

²³ Për informacion shtesë për politikën energjitike të Rusisë shiko CRS Report RL34261, "*Politika Energjitike Ruse ndaj Vendeve Fqinjë*," nga Steven Woehrel

²⁴ Dokumenti i Komisionit European SEC (2007)12 Cituar më sipër.

²⁵ Keith Smith, "*Presioni Energjistik i Rusisë dështon në Bashkimin e Evropës*", Center for Strategic and International Studies (CSIS), Washington, DC. 24 janar, 2007.

çështjet botërore.²⁶ Pra, Putini e shikon energjinë si një forcë politike e rëndësishme përderisa është forca kryesore që e çon përpara ekonominë ruse. Disa ekspertë besojnë se Rusia kërkon të kontrollojë sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën energjitike të Evropës në shkëmbim të furnizimeve të besueshme energjitike. Parë nga ky këndvështrim, Moska e di se nëse BE-ja ja del mbanë të krijojë një treg unik evropian për elektricitetin dhe gazin atëherë, “[Rusisë] do ti paraqiten mundësi për të qenë pjesë e tregut më të madh dhe më të integruar të energjisë në botë mu në kufijtë e saj.”²⁷ Sipas analistit Daniel Yergin “Putini beson se siguria energjitike është e lidhur me ri-marrjen e kontrollit [nga Rusia] të ‘lartësive komanduese’ të industrisë energjitike dhe me zgjerimin e këtij kontrolli edhe më poshtë. ...”²⁸

Rëndësia politike e energjisë është e dukshme në faktin se dy gjigantët kryesorë të energjisë ruse Gazprom dhe Rosneft, janë të lidhura ngushtë me Kremlinin dhe në veçanti me vetë Presidentin Putin. Rosneft-i udhëhiqet nga një shok i ngushtë dhe ish koleg i KGB-së së Putinit. Gazpromi udhëhiqet prej Alexander Millerit, një aleat i ngushtë i Putinit, dhe Dmitry Medvedev, Zëvendësministrit të Parë të Rusisë dhe zgjedhja e Putinit për të qenë pasardhësi i tij. Gazpromi dominon sektorin e gazit rus dhe kontrollon 100% të gazit rus që rrjedh nëpër BE. Medvedevi pritet të fitojë zgjedhjet presidenciale në mars 2008.

Nga ana e investimeve, analistët gjithashtu vërejnë se Rusia po përdor kartën politike. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë vlerëson se sektori i gazit rus do të kërkojë një investim vjetor prej 10 miliardë USD për të përmbushur kërkesat e ardhshme botërore. BE-ja ka nxitur Rusinë që t’ju japë kompanive evropiane të energjisë mundësinë për të investuar në të gjithë zinxhirin e sektorit të energjisë që nga fushat e naftës dhe gazit e deri në sistemin e tubacioneve. Deri tani, Rusia ka refuzuar të plotësojë kërkesën e BE-së si dhe ka paralajmëruar BE-në që të mos pengojë planet e Gazpromit për të blerë ose investuar në sektorin energjitik të Evropës. Duke mënjeluar politikat e Evropës që lidhen me konkurrencën dhe me monopolet si dhe Kartën e Energjisë, udhëheqësi i Gazpromit, CEO Miller u tha Ambasadorëve të BE-së në një përpjekje jo dhe aq të fshehur për të ushtruar ndikimin

²⁶ Keith Smith, CSIS, “*Politika Energjitike Ruse dhe Sfidat e saj mbi Çështjet Politike Perëndimore*,” Dëshmi përpara Kongresit, 16 maj, 2006.

²⁷ Andrew Monaghan, “*Marrdhëniet Rusi-BE: Një Dilemë në Shfaqje e Sigurisë Energjitike*.” Russia Research Network, Londër, 2006.

²⁸ Daniel Yergin, “*Cfarë domethënë në të vërtetë Siguria Energjitike?*,” Wall Street Journal, 11 korrik, 2006.

energjitik të Ruisë, se “përpyqjet për të kufizuar aktivitetet e Gazpromit në tregun evropian, ... nuk do të japin rezultate të mira nuk është e rastit që konkurrenca për burimet energjitike po rritet. ... dhe nuk duhet harruar se ne [Gazpromi] po kërkojmë me ngulm tregje të reja si p.sh. Kina. ...”²⁹

Në vend që të mbështetet tek investimet e jashtme të rëndësishme në infrastrukturën e saj energjetike, Rusia synon të përmbushë kontratat e saj afatgjata me vendet Evropiane me anë të pothuajse monopolit të saj mbi gazin që vjen nga Azia Qendrore (Kazakistan, Turkmenistani, dhe Uzbekistani). Rusia kontrollon aktualisht shumicën dërrmuese të rrugëve transportuese të gazit dhe naftës nga Azia Qendrore, dhe sipas analistëve, synon të shfrytëzojë kontrollin e saj dhe mjetet politike mbi qeveritë e Azisë Qendrore dhe vendet evropiane, që të pengojë përpyqjet evropiane dhe ato të ShBA-së për të ndërtuar tubacione alternative, që anashkalojnë Rusinë. Për shembull, kritikët e aktivitetit të Gazpromit, si analisti Vladimir Socor, besojnë se strategjia e Gazpromit është që “të vendosë kontroll të përherëshëm mbi tregjet [Hungareze/Balkanike] përpara se gazi i Kaspikut t’i arrijë ato nëpërmjet gazsjellësit Nabuco.”³⁰ Më konkretisht, Socori dhe të tjerë theksojnë rastin e gazsjellësit Rryma e Jugut të propozuar prej Gazpromit i cili synon transportimin e gazit të Kaspikut dhe Azisë Qendrore me anë të një rruge po aq të drejtpërdrejtë sa dhe gazsjellësi të planifikuar Nabuco. Marrëveshjet e arritura ndërmjet Gazpromit dhe kompanive energjitike Italiane, Bullgare dhe Serbe në vitin 2007 dhe në janar të vitit 2008, duket se konfirmojnë pikëpamjen se Gazpromi mund të kërkojë të bindë vendet që kanë rënë dakord për financimin e gazsjellësit Nabuco që të tërheqin zotimet e tyre dhe të venë shpresat mbi gazsjellësin Rryma e Jugut.³¹ Këta kritikë gjithashtu paralajmërojnë se kompanitë shtetërore të energjisë të Ruisë synojnë të rrisin ndikimin e tyre përballë diversifikimit të mëtejshëm evropian duke kërkuar që të marrin role kontrolluese në çështjet që i përkasin gazit natyror në Afrikën Veriore.³²

²⁹ CEO Miller i Gazpromit në një fjalim të mbajtur për Ambasadorët e BE-së në Bruksel siç u raportua prej BBC News, 4 prill 2006.

³⁰ “Gazpromi Zgjeron, Thellon Sulmet në Tregjet e Brendshme, Sistemet e Transportit të Bashkimit Europian,,” Vladimir Socor, Eurasia Dailey Monitor, 21 mars, 2006.

³¹ Shih “Rusia: Avancimi i Gazprom në Evropë Vazhdon,” Radio Free Europe / RadioLiberty, 25 janar, 2008.

³² Keith Smith, “Presioni Energjitik i Ruisë Dështon në Bashkimin e Evropës”, Cituar më sipër.

Përgjigjja Evropiane. Vendet anëtare të BE-së kanë vendosur dy mekanizma kryesorë institucionalë me anë të të cilëve mund t'i adresohen në mënyrë të përbashkët marrëdhëniet energjitike me Rusinë: Traktati i Kartës së Energjisë dhe Dialogu për Energjinë Evropë-Rusi. Siç u theksua dhe më sipër Traktati i Kartës së Energjisë i cili është firmosur por nuk është ratifikuar prej Ruisë do të detyronte Rusinë që të miratonte një kuadër ligjor për drejtimin e investimeve, tranzitit dhe tregtimit të burimeve energjitike. Disa analistë theksojnë se udhëheqësit evropianë duhet ta bëjnë zbatimin e traktatit nga ana e Ruisë një kusht për çdo Marrëveshje Partneriteti dhe Bashkëpunimi BE-Rusi në të ardhmen. Thirrje të tilla kanë kontribuar në vonesën e negociatave aktuale të një marrëveshjeje të tillë dhe kanë penguar progresin Dialogut BE-Rusi për Energjinë.

Edhe kur udhëheqja e BE-së në Bruksel po ecën përpara me idetë e saj për një strategji të përbashkët të jashtme për energjinë, lindin shumë pyetje mbi faktin se deri në çfarë mase do të bien dakord vendet anëtare individuale për të shtyrë Rusinë (dhe Gazpromin) që të adoptojë parimet e BE-së për konkurrencën, të hapë sektorin e saj energjistik kundrejt investimeve të jashtme, dhe të ratifikojë Kartën e Energjisë. Disa besojnë se pa konçensione të tilla nga ana e Ruisë, Evropa do ta ketë sektorin e saj të energjisë gjerësisht nën kontrollin rus. Në të vërtetë, disa vende anëtare kanë ndërmarrë marrëveshje bilaterale energjitike me Rusinë të cilat do të shtojnë varësinë nga Rusia gjatë viteve të ardhshme. Si Gjermania ashtu edhe Italia, dy nga importueset më të mëdha të gazit rus, kanë negociuar marrëveshje afatgjata energjitike me Rusinë për të siguruar rezervat e ardhshme të gazit. Për Gjermaninë dhe disa pak vende të tjera "Roli i Ruisë si furnizuese kryesore e naftës dhe gazit, bën që Putini të jetë një partner kryesor strategjik i cili nuk mund të injorohet ose të kundërvihet."³³ Marrëveshje të tilla nuk janë kufizuar vetëm për konsumatorët kryesorë të energjisë. Sllovenia dhe Belgjika kanë hyrë në negociata me Gazpromin për ndërtimin e një gazsjellësi përgjatë të parës dhe për hyrjen në tregun e shpërndarjes së energjisë së të dytës. Kompania hungareze e naftës dhe gazit, Mol, është bashkuar me Gazpromin për zgjerimin e gazsjellësit të tij Rryma Blu (Blue Stream) përmes Detit të Zi, përgjatë Ballkanit për në Hungari. Në janar të vitit 2008, Bullgaria firmosi një marrëveshje me Gazpromin për t'u bërë pjesë e projektit Rryma e Jugut.

³³ William Drozdiak, "Rusia: Më e Vështirë, por gjithsesi e domosdoshme," European Affairs, Pranverë/Verë 2006.

Këta shembuj të shteteve individuale të cilët merren me Rusinë në mënyrë bilaterale kanë sjellë kritika të mëdha nga vendet e tjera anëtare, sidomos nga Polonia dhe vendet e Balltikut. Ato kanë paralajmëruar kolegët e tyre evropianë që të mos bëjnë marrëveshje energjitike që do t'i jepnin Ruisë një masë të madhe, të pakthyeshme dhe të rrezikshme ndikimi mbi vendimmarrjen evropiane. Shumë prej këtyre vendeve e kuptojnë se varësia e Evropës ndaj energjisë ruse ka gjasa të zgjasë pavarësisht alternativave që përfshihen në politikën energjitike të BE-së. Por ata ndiejnë gjithashtu se Evropa nuk përfiton siguri reale duke u bërë më e varur prej Ruisë. Në fakt, prezenca në rritje e Gazpromit nëpër tregun evropian të energjisë ka shkaktuar tek shumëkush shqetësimin rreth aftësive të BE-së për të zhvilluar një politikë energjitike, e cila ushqehet prej Gazpromit.³⁴ Gjatë një fjalimi në korrik të vitit 2006, Presidenti rumun Basescu, shkoi aq larg sa të paralajmëronte se: "Varësia e Evropës ndaj gazit dhe monopolit rus të gazit Gasprom. ... mund të përbëjë kërcënimin më të madh ndaj rajonit që nga koha e ushtrisë së ish-Bashkimit Sovjetik."³⁵

Përpyekjet fillestare për të institucionalizuar një dialog BE-Rusi për energjinë u konkretizuan në vitin 2000 me krijimin e Dialogut BE-Rusi për Energjinë. Megjithatë, rezultatet e këtij dialogu në rastin më të mirë, janë raportuar si të përziera. Pavarësisht ngurrimit të vazhdueshëm të Ruisë për të lejuar investime evropiane në sektorin e saj të energjisë dhe për tu përshtatur me parimet e tregut dhe të transportit energjistik të parashtruara në Kartën e Energjisë, një sërë shtetesh evropiane vazhdojnë të lejojnë ndikimin rus në rritje të vazhdueshme në sektorët e tyre të energjisë. Nga ana tjetër negociatat e vitit 2006 mbi rinovimin e një marrëveshjeje partneriteti ndërmjet BE-së dhe Ruisë u vonuan për shkak të shqetësimeve të Polonisë dhe të vendeve të tjera anëtare lidhur me ndërhyrjen e Ruisë në disa fusha, duke përfshirë dhe bashkëpunimin për energjinë. Përballë mosmarrëveshjeve të brendshme, BE-ja duket se ka rënë dakord që të përqendrohet në arritjen e qëllimeve të saj energjitike që lidhen me shtimin e qëndrueshmërisë, ndërsa Rusia ka treguar shenja të pakta devijimi prej politikave të saj të fundit.

Situata energjitike me Rusinë nuk është ende e qartë. Rusia do të vazhdojë të jetë furnizuesja kryesore me energji e Evropës

³⁴ Komentet e marra prej diskutimeve me shumë përfaqësues të vendeve anëtare evropiane. Washington, D.C. korrik 2006.

³⁵ Traian Basescu, President i Rumanisë gjatë një fjalimi mbajtur në Fondacionin Jamestown në Washington, D.C. korrik 2006.

për një periudhë afatgjatë dhe marrëdhëniet e shëndetshme Rusi-Evropë mbeten një prioritet për të dyja anët. Nëse do të krijohet një politikë e përbashkët e jashtme për sigurinë energjitike të BE-së duhen konsideruar dy mundësi. Së pari, Evropa duhet të lëvizë drejt zvogëlimit të varësisë së saj nga energjia ruse duke rritur diversifikimin e saj drejt rajoneve të tjera, pa kërcënuar sigurinë e tregut të Rusisë në Evropë. Duke bërë këtë, Evropa mund të pyesë nëse do të ketë një pikë kur Rusia mund të vendosë se angazhimi i BE-së për diversifikim, nuk e bënë atë më tërheqëse për Rusinë nga ana financiare, që ajo të vazhdojë të investojë në furnizime të reja të destinuara për tregun evropian. Së dyti, BE-ja mund të përpiqet të rregullojë sjelljen dhe praktikën e Gazpromit ndërsa ai bëhet gjithnjë e më shumë një lojtar dominant i energjisë në Evropë. Deri më sot, pak vende evropiane janë treguar të shtrënguara për sa i përket kërkesës për marrëveshje bilaterale me monopolin rus që do bënte vetëm këtë. Nëse kjo vazhdon, Evropa do të rrezikonte që Gazpromi të ndërhynte gjithnjë e më shumë në vendimmarrjen e saj të brendshme politike. Për të evituar këtë gjë, Bashkimi Evropian me shumë gjasa do të vazhdojë të ushtrojë presion mbi Gazpromin që ai të luajë sipas rregullave evropiane të konkurrencës dhe do të punojë për të ndryshuar mentalitetin e korporatës së Gazpromit, duke lejuar firmat evropiane që të investojnë në industrinë e gazit të Rusisë.

Megjithatë, sipas disa analistëve, mosmarrëveshjet e brendshme mbi mënyrën si ti afrosh Rusisë, po ndalon BE-në në aplikimin e këtij lloji presioni. Këta kritikë argumentojnë se BE-ja mund të ushtrojë presion të përbashkët ndaj Rusisë duke forcuar ligjet ekzistuese të konkurrencës si edhe duke përdorur anëtarësimin në të ardhmen të Rusisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) si një mënyrë për të hapur sektorin e brendshëm energjitik të Rusisë kundrejt investimeve të jashtme.³⁶ Nga ana tjetër, vende të tilla si Gjermania duken ngurruese për të ndërmarrë ndonjë veprim që mund të kundërshtojë Rusinë, duke theksuar si arsye për këtë, nevojën për një partneritet strategjik të shëndoshë, duke marrë parasysh varësitë euro-ruse dhe rëndësinë e bashkëpunimit me Rusinë në adresimin e çështjeve të tjera që përbëjnë shqetësim global, si për shembull programi bërthamor i Iranit dhe statusi i Kosovës.³⁷

³⁶ Keith Smith, "Presioni Energjitik i Rusisë Dështon në Bashkimin e Evropës", Cituar më sipër.

³⁷ Intervista të zyrtarëve gjermanë, janar-mars 2007.

Azia Qendrore dhe Rajonet e Kaspikut/Detit të Zi.³⁸ Një prej pikave kryesore të përqendrimit të strategjive evropiane për diversifikimin energjistik është rajoni i Azisë Qendrore dhe rajonet e Kaspikut dhe Detit të Zi. Vërtet, dokumenti i janarit të 2007 i politikës energjitike të BE-së, rekomandonte forcimin e të ashtuquajturës Politika e Fqinjësisë së BE-së me këto zona, dhe udhëheqësit evropianë janë përpjekur të forcojnë lidhjet me vendet e këtij rajoni.³⁹

Deti Kaspik në Azinë Qendrore kufizohet prej Azerbajxhanit, Iranit, Kazakistanit, Ruisë dhe Turkmenistanit. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, komuniteti ndërkombëtar pati një interes të veçantë për rajonin si pasojë e rezervave potenciale të naftës dhe gazit që mendohej se ndodheshin në të paktën gjashtë fusha të identifikuar hidrokarboni nën Detin Kaspik.

Aktualisht, rajoni i Detit Kaspik është një furnizues i rëndësishëm, por jo kryesor i naftës së pa përpunuar, në tregjet botërore. Rezervat e papërdorura që zotërohen nga katër prej këtyre shteteve mund t'i ofrojnë Evropës një mundësi që të largohet prej varësisë në rritje ndaj energjisë ruse. Vlerësimet e rezervave të identifikuar të naftës në rajonin e Detit Kaspik janë ndërmjet 40 dhe 50 miliardë fuçi. Nivelet e prodhimit gjatë vitit 2005 u vlerësuan se ishin rreth 2 milionë fuçi në ditë. Rezervat e gazit natyror në rajonin e Detit Kaspik vlerësohet se janë 232 trilionë fut kubik (tcf). Prodhimi i gazit natyror në vitin 2005 ishte afërsisht 5 tcf në ditë.

Interesi formal i Evropës mbi burimet energjitike të rajonit daton që në vitin 1995 me krijimin e Programit Ndërshtetëror të Transportit të Energjisë në Evropë (Inogate). Kjo iniciativë e BE-së (aktualisht me 21 vende anëtarë) u hartua për të nxitur ndërtimin e një gazsjellësi rajonal për të lehtësuar transportin e naftës dhe gazit në Evropë.⁴⁰ Ky u ndoq nga një tjetër propozim i BE-së, "Iniciativa e Baku-së", e cila u iniciua në nëntor 2004 me pjesëmarrjen e Komisionit Evropian dhe vendeve bregdetare të Detit të Zi dhe të Kaspikut. Iniciativa e Baku-së u hartua për

³⁸ Për më shumë informacion shih *CRS Report RS21190*, "Gazi dhe Nafta e Kaspikut: *Prodhimi dhe Prospektet*" nga Bernard Gelb, dhe *CRS Report RL30294*, "Azia Qendrore: *Zhvillimet Rajonale dhe Implikimet për interesat e SHBA-së*", nga Jim Nichol

³⁹ Për më shumë informacion mbi marrëveshjet politike dhe energjitike ndërmjet BE-së dhe shteteve në rajonin e Kaspikut dhe Azisë Qendrore shih, Richard Youngs, "*Politika e Jashtme Energjitike e Evropës: Midis Gjeopolitikës dhe Tregut*," Center for European Policy Studies, nëntor 2007.

⁴⁰ Një kronologji më e detajuar e aktiviteteve të Inogate gjendet në adresën e tij të internetit [<http://www.inogate.org>].

lehtësimin e integritit progresiv të tregjeve energjitike të rajoneve në fjalë me tregun e energjisë së BE-së si dhe për lehtësimin e transportit të sasisë së madhe të burimeve të gazit dhe naftës së Kaspikut drejt Evropës.

Në kohën kur u krijua Inogate, Rusia dominonte prodhimin dhe shpërndarjen e naftës dhe gazit në rajon. Duke qenë se shumica e vendeve të përfshira janë vende që nuk kanë dalje në det, gazi dhe nafta e tyre duhet të transportohet me anë të tubacioneve. Duke reflektuar diktatin dhe infrastrukturën e kohës sovjetike, gati e gjithë nafta e pa përpunuar e Kaspikut udhëtonte në veri ose perëndim nëpërmjet tubacioneve direkt ose nëpërmjet Rusisë për në tregjet evropiane. Një sasi naftë transportohet gjithashtu me anë të anijeve-cisterna përmes Bosforit drejt tregjeve të Evropës Perëndimore përgjatë Mesdheut. Transportimi i gazit natyror ishte i lidhur me gazsjellës që udhëtonin kryesisht drejt veriut ose perëndimit përmes Rusisë dhe sistemit të saj monopolistik të gazsjellësve, Gazpromit. Kjo ka pajisur Rusinë me fuqinë e tregut për të diktuar, pjesërisht, çmimin që ajo dëshiron të paguajë për naftën ose gazin ose për të vendosur tarifa transiti mbi energjinë e Kaspikut që shpërndahet kryesisht nëpërmjet rrjetit të saj të transportit si edhe për të përcaktuar në disa raste sasinë se sa, si edhe nëse, do të dëshironte ta kryente këtë transport. Kjo pikë e fundit doli në pah në vitin 2005 kur kompania naftësjellëse ruse, Transneft, refuzoi lejimin e naftës nga Kazakistani që të shpërndahej përmes tubacioneve të saj, për t'u rafinuar në Lituani. Vendet e rajonit të Kaspikut, kanë pra, incentiva për zhvillimin e alternativave për rrugët përmes Rusisë për të arritur tregjet evropiane dhe ato të tjera, si edhe që të gjejnë mënyra për të negociuar tarifat e tranzitimit për dërgesa që kalojnë nëpërmjet sistemit rus të tubacioneve.

Ndryshimi i rrjedhjes së energjisë në rajon nga aksi aktual Veri-Jug në një aks Lindje-Perëndim drejt Evropës mund të jetë thelbësor për strategjinë energjitike të Evropës. Aktualisht, tre projekte të mëdhenj tubacionesh shërbejnë për të ulur varësinë nga Rusia:

Projekti i Konsorciumit Kaspik të Naftësjellësve (CPC) lidh depozitat e naftës në zonën e Detin Kaspik të Kazakistanit me portin e Novorossysk-ut në Detin e Zi të Rusisë. Nafta që shkarkohet në këtë port, merret më pas me anë të anijeve-cisterna dhe transportohet në tregjet botërore nga ngushtica e Bosforit.⁴¹

⁴¹ Analizë të mëtejshme të rajonit të Kaspikut mund të gjendet tek "Country Analysis Brief: Caspian Sea" Energy Information Administration, U.S. Department of Energy, 2005.

Naftësjellësi Baku-Tbilisi – Ceyhan (BTC), i cili u hap në korrik të vitit 2006, transporton naftë nga Azerbajxhani dhe deri në 600 000 bl/d nga Kazakistani nëpërmjet një rruge prej 1, 040 miljesh nga Baku, Azerbajxhani nëpërmjet Gjeorgjisë në portin Mesdhetar Turk të Cyhan-it. Kjo do të lejonte që nafta të anashkalonte Ngushticën e Bosforit.

Gazsjellësi i Kaukazit të Jugut (SCGP), një sipërmarrje e re gazsjellësi e përfunduar në dhjetor të vitit 2006, operon paralelisht me naftësjellësin BTC për më të shumtën e rrugës së tij para se të lidhet me infrastrukturën energjitike turke dhe të vazhdojë në Evropë nëpërmjet një gazsjellësi transit përmes Greqisë.

Përveç këtyre tubacioneve që janë në përdorim, mund të përfshihen dhe një sërë projektesh shtesë në Evropë. Një mundësi për transportimin alternativ të naftës do të ishte përmirësimi i naftësjellësit aktual i cili shkon nga Baku-ja në Azerbajxhan në Supsa të Gjeorgjisë. Kjo linjë mund të zgjerohet nën Detin e Zi ose nafta mund të ngarkohet në anije-cisterna dhe të transportohet në Odessa, Ukrainë. Nafta më pas mund të pompohet në Poloni nëpërmjet naftësjellësit Odesa-Brody. Disa, duke përfshirë Polakët, kanë sugjeruar që linja e Brodyt të zgjerohet më tej në Poloninë veriore dhe në vendet Balltike për përdorim në rafinerinë e Mazeikait në Lituani.

Për sa i përket gazit, ka dy projekte shtesë që ofrojnë mundësi të rëndësishme për Evropën. Siç u përmend më sipër, projekti flamur i BE-së është gazsjellësi Nabucco. Projekti tjetër, gazsjellësi Trans-Kaspik, synon të sjellë më shumë gaz prej rajonit të Kaspikut në Gjeorgji dhe përmes Detit të Zi në Rumani dhe në Ballkan. Zyrtarët e BE-së shpresonin se puna për ndërtimin e gazsjellësit Nabucco, i cili do të transportonte deri në 31 miliardë metër kub gaz nga Azia Qendrore nëpërmjet Turqisë në Bullgari dhe më pas në Austri, do të fillonin në vitin 2007. Megjithatë, projekti është vonuar vazhdimisht dhe avancimet e fundit të Gazpromit me anë të firmosjes së kontratave për gazsjellësin e tij Rryma e Jugut kanë shkaktuar disa dyshime përsa i përket realizueshmërisë së Nabuccos. Zyrtarët e BE-së mbeten optimistë duke synuar që ndërtimi i gazsjellësit të fillojë në vitin 2009. Në atë çka prej shumë kritikëve shihet si përpjekje e Gazpromit për cenimin e projektit Nabucco, është raportuar se Gazpromi ka blerë 50% të aksioneve të stacionit fundor të planifikuar për kalimin e Nabuccos, qendrën e transmetimit Baumgarten në Austri, në janar të vitit 2008.⁴²

⁴² Shih Vladimir Socor, "OMV bashkohet me Gazprom për të goditur Nabucco-n," *Eurasia Daily Monitor*, Jamestown Foundation, 29 janar, 2008.

Nuk ka dyshim se burimet energjitike të rajonit të Detit Kaspik mund t'i ofrojnë Evropës një burim të vazhdueshëm furnizimi. Megjithatë, realizimi i plotë i potencialit energjistik të rajonit mund të ndalohet nga një sërë faktorë plotësues.

Një çështje e cila vazhdon të jetë shqetësuese për sa i përket stabilitetit rajonal është statusi ligjor i pa-zgjidhur i Detit Kaspik. Pavarësisht një sërë përpjekjesh, deri tani vetëm Azerbajxhani, Kazakistani dhe Rusia prej shteteve bregdetare të Kaspikut kanë arritur marrëveshje për përcaktimin e pronësisë së burimeve të Detit ose për të drejtat e tyre të zhvillimit. BE-ja mund te jepte ndihmën e saj ligjore për të zgjidhur çështjet kryesore.

Një çështje e dytë është aftësia e BE-së për të punuar për sigurimin e stabilitetit politik afatgjatë në rajon. Konflikti ndërmjet Azerbajxhanit dhe Armenisë mbi Nagorno-Karabaugh i lë tubacionet e BTC-së dhe SCP-në e ardhshëm të preکشëm nga sabotimi. Konfliktet e brendshme politike që përfshijnë Gjeorgjinë dhe dy rajonet e pavarura të saj kërcënojnë gjithashtu tubacionet e ardhshme në këtë vend. Pasiguria politike e vazhdueshme në Ukrainë dhe rritja e ndikimit Iranian në Kaukazin jugor mund të vonojë investimet e ardhshme afatgjata nga sektori privat. Megjithatë, hyrja në janar të vitit 2007 e Rumanisë dhe Bullgarisë në Bashkimin Evropian dhe marrëdhënia e veçantë e BE-së me Turqinë duhet të ndihmojnë që rajoni i Detit të Zi të mbahet i sistemuar.

Çështja e tretë përfshin vullnetin e BE-së për të konkurruar me Rusinë për ndikimin politik dhe ekonomik në rajon dhe për të ndaluar Gazpromin për mbylljen e tregut Kaspik, ose të paktën pjesën e rajonit që i përket Azisë Qendrore, ndaj Evropës dhe sektorit të saj privat. Eksportimi i gazit rus me çmim të lartë drejt Evropës varet nga aftësia e Gazpromit për të kontrolluar gazin që vjen nga Kazakistani dhe Turkmenistani. Kjo varësi pritet që të rritet gjatë 7-10 viteve të ardhshme, derisa fushat e mëdha të gazit të Rusisë në Detin Barents të futen në përdorim.⁴³ Sipas disave, edhe pse Gazpromi ishte i paaftë që të ndalonte përfundimin e tubacioneve të BTC-së, Gazpromi synon të vazhdojë të shtyj vendet përreth Detit Kaspik dhe Detit të Zi, të bien dakord me marrëveshjet për furnizimin me gaz dhe për transitin, që kënaqin qëllimet e kompanisë për të kanalizuar gazin me kosto të ulët të Azisë Qendrore drejt konsumatorëve rus dhe për mbrojtjen e tregut të saj fitimprurës Evropian.⁴⁴ Gazpromi ka

⁴³ Keith Smith, *Politika Ruse e Energjisë dhe Sfidat e saj ndaj +ështjeve Politike perëndimore,* cituar më sipër

⁴⁴ Zeyno Baran, "Furnizimet Energjitike drejt Euroazisë dhe Implikimet për Sigurinë Energjitike të ShBA-së," *dëshmi para Komitetit të Senatit për Marrdhëniet e Jashtme*, shtator 2005.

mbyllur tashmë shumicën e gazit të Turkmenistanit me anën e një kontrate 25 vjeçare dhe ka ndjekur një strategji të njëjtë me Kazakistanin.

Çështja e fundit silllet rreth faktit nëse Evropa është tregu optimal për naftën dhe gazin natyror të Kaspikut. Kërkesa për naftë në Evropë gjatë 10-15 viteve të ardhshme pritet të rritet me pak më shumë se 1 milionë fuçi në ditë. Eksportimi i naftës drejt lindjes, nga ana tjetër, mund t'u shërbejë tregjeve Aziatike, ku kërkesa për naftë pritet të rritet me afërsisht 10 milionë fuçi në ditë gjatë 15 viteve të ardhshme.⁴⁵ Në fakt, Kina e cila hapi një naftësjellës për në Kazakistan në vitin 2005, e shikon këtë të fundit si një burim kryesor nafte në periudhën afatgjatë.

Rajoni i Kaspikut do të vazhdojë të jetë një burim i rëndësishëm i prodhimit të energjisë për të ardhmen e parashikueshme, sidomos nëse llogaritet për rezervat e tij, e veçanërisht për ato të gazit, janë të sakta. Pra, rajoni mund të kontribuojë për diversifikimin e furnizimit me naftë dhe gaz të Evropës, çka do të shtojë në sigurinë energjitike të Evropës. Të përfituarit plotësisht prej këtij potenciali do të kërkonte një angazhim të plotë nga ana e BE-së për të inkurajuar sektorin privat që të ndërmarrë rreziqe financiare që janë të shoqëruara me sigurimin e një pjese të tregut të energjisë në Kaspik për Evropën, dhe për të vendosur një strategji të jashtme e cila është tërësisht e përgatitur për të adresuar dinamikat e të gjithë rajonit. Për disa "një strategji e besueshme [e energjisë] nevojitet të tregojë se BE-ja nënkupton biznes në rajonin e Kaspikut dhe Detit të Zi. Brukseli duhet të përfshijë furnizimin me energji dhe transitin si prioritet të larta ... për rajonin."⁴⁶

Lindja e Mesme/Afrika e Veriut. Përpjekjet e BE-së për të diversifikuar furnizimin evropian me energji dhe për të ulur varësinë nga Rusia kanë shtuar thirrjet brenda Evropës për një përfshirje më të madhe politike dhe ekonomike në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Megjithatë, paqëndrueshmëria politike në rajon dhe një konkurrencë e fortë për burimet e tij energjitike nga vendet e Azisë dhe Afrikës së Veriut përfaqësojnë sfida kundrejt përpjekjeve Evropiane.

Vendet e Gjirit Persik, (Bahrejni, Irani, Iraku, Kuvajti, Katari, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe) mbajnë më shumë se gjysmën (57%) e rezervave botërore të naftës dhe rajoni i Lindjes së Mesme prodhon më shumë se 31% të naftës

⁴⁵ CRS Report RS21190, cituar më sipër

⁴⁶ "Cfarë roli ka Rajoni I Detit të Zi në Strategjinë Energjitike të Bashkimit European," EurasiaDaily Monitor, 3 mars, 2006.

botërore.⁴⁷ Për më tepër, Libia vlerësohet se mbart rreth 44 bb dhe Algjeria rreth 12 bb. Rajoni i Gjirit Persik mbart gjithashtu përafërsisht 2,400 trilionë fut kub (tcf) rezerva gazi natyror duke përfaqësuar 45% të rezervës totale të gazit botëror. Algjeria vlerësohet se mbart (161 tcf) dhe Libia (52 tcf).⁴⁸

Evropa tashmë varet prej rajonit të Lindjes së Mesme/Afrikës së Veriut për afërsisht 30 % të importeve të saj të naftës dhe për 15% të gazit të thithur prej saj. Në vitin 2005 Evropa importoi përafërsisht 3.1 milionë fuçi naftë në ditë nga ky rajon. Pjesa më e madhe e kësaj nafte vjen nga Arabia Saudite, e ndjekur nga Libia dhe Irani.⁴⁹ Furnizuesi kryesor i Evropës me gaz natyror ka qenë Algjeria me anë të dy tubacioneve që hyjnë në Evropë nëpërmjet Italisë dhe Spanjës. Një sasi më e vogël vjen nga Libia me anë të një tubacioni nëpërmjet Italisë. Dy gazsjellës shtesë nga Algjeria për në Spanjë dhe Itali janë në ndërtim e sipër.

Ndoshta zhvillimi më i rëndësishëm për Evropën në këtë rajon ka qenë rritja e disponueshmërisë së gazit natyror të lëngëzuar (GNL). Sot Evropa zë gati 18% të konsumit botëror të GNL-së dhe në vitin 2005 GNL-ja përfaqësonte 15% të importit të gazit evropian, një ngritje prej 21% krahasuar me vitin 2004.⁵⁰ Spanja ku 65% e importeve të gazit janë GNL është udhëheqësja evropiane e importit të GNL-së e ndjekur prej Portugalisë (39%) dhe Francës (27%). Furnizuesit kryesorë të GNL-së për Evropën përfshijnë Algjerinë, Egjiptin, Omanin dhe Katarin. Algjeria është eksportuesi i tretë më i madh në botë i GNL-së dhe gati i gjithë gazi i saj (25 mld., metër kub) shkon në Evropë. Në vitin 2006 kompania kombëtare e naftës algjerieane Sonatrach, firmosi një kontratë furnizimi me GNL prej për 20 vjet me kompaninë spanjolle të energjisë, Endessa.⁵¹

GNL-ja është bërë gjithashtu një faktor kryesor në zhvillimet e eksportit të gazit nga Gjiri Persik. Edhe pse vendet si Katari, Omani dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë prodhuar GNL për tregun aziatik, kompanitë energjitike evropiane kanë filluar të shprehin interes për blerjen e GNL-së nga ky Gjir. Me shuma të mëdha rezervash gazi vendet e Gjirit janë në pozita për të përmbushur një pjesë të kërkesave të ardhshme të Evropës.

⁴⁷ Për më shumë informacion shih "Nafta e Gjirit Persik dhe të Dhënat për Eksportin e Gazit," EnergyInformation Administration, U.S. Department of Energy.

⁴⁸ Shih "Paqyra Statistike e Energjisë Botërore" British Petroleum (BP), korrik, 2006

⁴⁹ "Të dhëna nga Politika Energjitike e BE-së," cituar më sipër

⁵⁰ Statistika nga Eurogas, [<http://www.eurogas.org>].

⁵¹ Siç raportohet nga Lista e Lloyd-it. 25 maj 2006.

Marrëdhëniet evropiane me shtetet e Gjirit Persik dhe Afrikës së Veriut janë përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve. Marrëdhëniet e BE-së me Afrikën e Veriut u formalizuan në vitin 1995 me krijimin e Partneritetit Euro-Mesdhetar për Energjinë. BE-ja ka krijuar gjithashtu Dialogun e Këshillit të Bashkëpunimit Evropë-Gji (GCC) me vendet e Gjirit Persik dhe ka filluar dialog zyrtar me vendet e OPEK-ut. Kompanitë energjitike të Evropës janë përfshirë më shumë në Lindjen e Mesme. Nga ana tjetër, vëzhguesit vërejnë se këto forume janë zhvilluar ngadalë, dhe se vende si Algjeria shpesh kanë ngurruar të bien dakord me termat e diktuara nga Evropa. Për shembull në shtator të vitit 2007, Algjeria revokoi një kontratë gazi me kompanitë Spanjolle e cila vlente gati 7 miliardë USD (5 miliardë Euro).⁵²

Potenciali për rritje në strategjinë Evropës për diversifikimin e energjisë në lidhje me Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut është i rëndësishëm. Megjithatë, konkurrenca e evropiane me Azinë dhe Amerikën e Veriut dhe paqëndrueshmëria politike afatgjatë nëpër rajon do të ulë me shumë gjasa shkallën me të cilin Evropa do të përpiqet për të rritur besimin tek rajoni në fjalë. Pavarësisht kësaj, ashtu si me rajonin e Kaspikut, nëse BE-ja e ka seriozisht përpjekjen për të ulur varësinë ndaj vetëm një burimi, ajo duhet të kthehet gjithnjë e më shumë drejt Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Si parantezë, duhet thënë se interesi në rritje i Evropës për burimet energjitike në Afrikën e Veriut nuk ka kaluar pa u vërejtur prej Gazpromit dhe Ruisisë. Ashtu si në rajonin e Kaspikut, Rusia duket se po shton përpjekjet e saj për të ndikuar mbi planet energjitike të Evropës. Në mars 2006, Presidenti Putin së bashku me zyrtarët e Gazpromit ka udhëtuar në Algjeri për të diskutuar përfshirjen e ardhshme të Ruisisë në projektet e ardhshme të Algjerisë për gazin dhe naftën, duke përfshirë dhe tregjet saj të eksportit të GNL-së. Disa theksojnë se duke qenë se Rusia synon që të kthejë Evropën në një treg kryesor për GNL-në e prodhuar në fushat e saj të gazit në Shtockman në Detin Barents, ajo po kërkon që të pozicionojë veten në mënyrë që të influencojë rolin e ardhshëm të Algjerisë si një furnizues kryesor me energji në Evropë.

Norvegjia. Norvegjia, e cila nuk është anëtare e BE-së, është eksportuesja e dytë e gazit natyror në BE, pas Ruisisë. Eksportet norvegjeze përfaqësonin 17% të konsumit evropian të gazit në vitin 2004. Gjermania (25%), Franca (30%) dhe Mbretëria e Bashkuar (30%) janë konsumatorët më të mëdhenj

⁵² Shih Richard Youngs cituar më sipër.

të eksportit të gazit norvegjez.⁵³ Që prej janarit të vitit 2005, Norvegjia kishte 73.6 trilionë fut kub (Tcf) rezervash gazi natyror të identifikuar. Deti i Veriut mban shumicën prej këtyre rezervave, por ekzistojnë dhe sasi të konsiderueshme në Detin e Norvegjisë dhe në atë Barents. Norvegjia është vendi i 8-të më i madh prodhues i gazit natyror në botë me një prodhim prej 2.59 Tcf në vitin 2003.⁵⁴ Studimi Gjeologjik i ShBA-së ka vlerësuar se gati 25% e rezervave të pa zbuluara ende në botë janë të vendosura në rajonin e Arktikut. Fusha e gazit e Norvegjisë e hapur së fundi në Snohvit së bashku me fushat Ruse në Shtockman do ta bëjnë Detin Barents një rajon të ri evropian të energjisë.

Sipas vlerësimeve të industrisë, Norvegjia ka 8.5 miliardë barela nafte të identifikuar deri në janar të vitit 2005, më të mëdhatë në Evropën Perëndimore. Shumica e prodhimit të naftës së Norvegjisë ndodh në Detin e Veriut si edhe në sasi më të vogla në Detin e Norvegjisë. Gjatë vitit 2005 prodhimi i naftës i Norvegjisë ishte mesatarisht 2.95 milionë fuçi në ditë. Me vazhdimin e maturimit të fushave të naftës në Detin e Veriut, prodhimi i naftës norvegjez do të mbetet me shumë gjasa i qëndrueshëm për disa vite radhazi dhe pastaj do fillojë të bjerë. Ka disa shpresa që zhvillimet e reja në Detin Barents do të zbehin efektet e kësaj rënieje. Përfituesi më i madh dhe i vetëm i eksporteve të naftës norvegjeze është Mbretëria e Bashkuar, e cila importon rreth 814,000 fuçi në ditë nga Norvegjia ose 34% të totalit të eksporteve norvegjeze. Destinacione të tjera të dukshme përfshijnë Holandën dhe Gjermaninë.

Futja e Norvegjisë në tregun e eksportit të GNL-së hap një mundësi të re për BE-në për të punuar me fqinjët e saj veriorë mbi çështjet e sigurisë energjitike. Gjiganti i energjisë së Norvegjisë, Statoil, ka planifikuar që të ndërtojë terminalin e parë të madh të eksportit të GNL-së në Evropë me lidhje me projektin e Snohvitit. Megjithëse prodhimit fillestar i GNL-së nga projekti i Snohvitit ka qenë për Shtetet e Bashkuara, prodhimi në vazhdim dhe fushat e ardhshme në Detin Barents mund të transportohen me pajisje në Evropë. BE-ja është në dijeni të rëndësisë në rritje të Norvegjisë në debatin e Evropës për sigurinë energjitike dhe ka shprehur interes për të "lehtësuar përpjekjet e Norvegjisë për të zhvilluar burimet në veriun e largët të Evropës."⁵⁵ Vende

⁵³ Jonas Store, Ministër i Punëve të Jashtme i Norvegjisë, "The High North-Top of the Agenda," Fjalim mbajtur në CSIS, Ëashington, D.C., korrik 2006; "EU Energy Policy Data," cituar më sipër.

⁵⁴ Administrata e Informacionit për Energjinë.

⁵⁵ Green Paper e Komisionit Evropian cituar më sipër

individuale evropiane kanë njohur gjithashtu rolin e ardhshëm potencial të Norvegjisë për sigurimin e energjisë. Polonia së bashku me vendet e Balltikut ka filluar tashmë të diskutojë me industrinë, ndërtimin e një terminali të GNL-së në bregdetin polak për të marrë GNL nga Norvegjia për transport në pjesë të tjera të Evropës.


Konkluzione të Strategjisë së Jashtme. Vendosja e një rrjeti të shumëllojshëm dhe të sigurt furnizuesish të energjisë është bërë një nga sfidat më të mëdha me të cilën po përballen vendet e Evropës dhe Bashkimit të saj. Në një farë mënyre Evropa është me fat që ka burime aq të mëdha të disponueshme energjie në një hapësirë aq të vogël gjeografike. Megjithatë, si edhe vendet e tjera, Evropa po përballlet me faktin që për të ardhmen e parashikueshme, vendet prodhuese të energjisë paraqesin nivele të ndryshme rreziku që variojnë nga paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike në çështje më të qenësishme të besueshmërisë politike dhe të qëllimeve afatgjata.

BE-ja mund të vazhdojë të përdorë qëllimet e Politikës së saj të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) dhe politikat e përbashkëta të tregtisë për të promovuar stabilitetin politik dhe sigurinë në vendet që përbëjnë bërthamën e furnizimit me energji të Evropës. Megjithatë, perspektivat e politikës së sigurisë energjitike ndryshojnë ndërmjet vetë 27 vendeve anëtare dhe ndërmjet shteteve dhe Komisionit Evropian. Marrëveshjet afatgjata bilaterale energjitike si marrëveshja për tubacionin e Balltikut ndërmjet Rusisë dhe Gjermanisë, kontratat e gazsjellësit Rryma e Jugut ndërmjet Italisë dhe Bullgarisë dhe Gazpromit, dhe kontratat për GNL të firmosura ndërmjet Spanjës dhe Francës dhe Algjerisë tregojnë që vendet anëtare vazhdojnë të shikojnë sigurinë energjitike kryesisht si një çështje politike kombëtare. Marrëveshje të tilla bilaterale mundet të marrin ose jo në konsideratë sigurinë e përbashkët të Bashkimit. Megjithatë, ato mund të bëhen më të zakonshme përjashtojnë rastin kur vendet anëtare bien dakord se një ngurrim i vazhdueshëm për t'u koordinuar mund të kërcënojë sigurinë afatgjatë energjitike të Bashkimit, sidomos nëse shtetet varen nga një furnizues i vetëm. Për shumë, thirrja e Komisionit Evropian për një politikë të përbashkët evropiane të energjisë, ka kuptim. Pavarësisht kësaj, progresi drejt një strategjie të përbashkët të jashtme të energjisë të lidhur me PPJS-në e BE-së duket se kërkon më shumë koordinim se ai që është treguar deri tani.

Sfida e 2-të: Nxitja e furnizimit të brendshëm me energji

Ndërsa përpjekjet për të zhvilluar një politikë koherente të jashtme të energjisë mbeten një çështje kryesore për Bashkimin Evropian dhe anëtarët e tij, ekziston një akord i gjerë evropian që BE-ja duhet gjithashtu të shikojë brenda saj për të përcaktuar se si mund të ul varësinë e saj me anë të furnizimit energjistik të brendshëm. Veçanërisht, BE-ja ka ndërmarrë hapa për të shtuar në mbarë Evropën prodhimin dhe përdorimin e burimeve energjitike alternative dhe të rinovueshme si dhe për të investuar në teknologjinë e “qymyrit të pastër”. Këto përpjekje synojnë si shtimin e pavarësisë energjitike të Evropës ashtu edhe adresimin e shqetësimit në rritje të publikut dhe të politikës në lidhje me efektet që ka konsumimi i energjisë në ndryshimet klimaterike globale. Si rrjedhojë, iniciativat aktuale janë përqendruar në dy sektorë të cilët së bashku llogariten të përbëjnë shumicën dërrmuese të sasisë së dioksidit të karbonit të çliruar: prodhimi i energjisë dhe ngrohjes (35% të nxjerrjes totale të karbonit) dhe transporti (27%).⁵⁶ Konsumimi i energjisë në sektorin e transportit furnizohet më së shumti nga nafta e importuar. Rreth një e treta e energjisë së prodhuar në Evropë vjen prej centraleve me djegie qymyri, dhe një tjetër një e tretë e saj vjen prej centraleve bërthamore. Figura 2 tregon shpërndarjen e gjenerimit të energjisë sipas llojit të lëndës djegëse që përdoret.

Figure 2. EU Electricity Generation



Burimi: IEA

Përzierja e furnizimit me energji në vendet anëtare të BE-së vazhdon të përcaktohet në shkallë të gjerë prej qeverive kombëtare

⁵⁶ “Energjia dhe Transporti i Komisionit Evropian Figura“, cituar më sipër.

ose prej kompanive të energjetikës. Si rrjedhojë llojet e energjisë variojnë gjerësisht nëpër BE, të influencuara nga një numër faktorësh që variojnë nga kostoja dhe disponibiliteti i burimeve deri tek faktorët politikë si për shembull legjislacioni që rregullon prodhimin e energjisë. Në Francë, për shembull, energjia bërthamore zë mbi 70% të të gjithë gjenerimit të elektricitetit, ndërsa Gjermania dhe Spanja kanë nxjerrë ligje për nxjerrjen jashtë përdorimit të energjisë bërthamore; në Poloni dhe Republikën Çeke qymyri është lënda djegëse kryesore.

Pavarësisht kësaj, vendimet që i përkasin përzjerjes energjitike kombëtare ndikohen gjithnjë e më shumë nga marrëveshjet e BE dhe ato ndërkombëtare për uljen e gazrave serë dhe të nxjerrjes së karbonit. Sipas Protokollit të Kjosës të vitit 1997 BE-ja detyrohet që të ulë nxjerrjet e saj të karbonit me 8% krahasuar me nivelet e vitit 1990, deri në vitin 2012. Për të arritur këtë objektiv kolektiv, vendet anëtare kanë rënë dakord për Plane Veprimi Kombëtare individuale. Vendet anëtare që janë më të varura nga qymyri dhe më pak të zhvilluara ekonomikisht si Polonia kanë objektiva më pak të rrepta sesa vendet që kanë një portfolio të energjisë së rinovueshme më të zhvilluar. Vendet anëtare pritet që të marrin një qasje të ngjashme për realizimin e qëllimeve më të fundit të BE-së për reduktimin me 20% të niveleve të vitit 1990 deri në vitin 2020.

Mundësia e BE-së për reduktimin e varësisë së saj ndaj importeve ndërsa ul efektet negative për mjedisin varet gjerësisht nga vendimet individuale të vendeve anëtare sa i përket përzjerjes energjitike. Përpjekjet evropiane pritet që të fokusohen tek nxitja e energjisë së rinovueshme dhe e lëndëve djegëse më të pastra, zhvillimin e teknologjisë së "qymyrit të pastër", rritjes së efikasitetit energjitike dhe uljes së konsumit të përgjithshëm. Duke qenë se çlirimi i energjisë bërthamore nuk prodhon drejtpërdrejt çlirim të karbonit, disa ekspertë dhe zyrtarë qeverish kombëtare janë për ngritjen dhe avancimin e gjenerimit të energjisë me anë të energjisë bërthamore. Të tjerë, nga ana tjetër, citojnë shqetësimet për sigurinë dhe përhapjen e shpejtë si penguese të rritjes së gjenerimit të energjisë bërthamore.

Qymyri. Pak më shumë se një e treta e totalit të elektricitetit të prodhuar në Evropë vjen nga djegia e qymyrit. Ashtu si edhe me burimet e tjera të energjisë, përdorimi dhe prodhimi i qymyrit varion ndërmjet vendeve anëtare. Djegia e qymyrit përbën shumicën e prodhimit të energjisë në shtete të tilla si Polonia (92%), Çekia (65%), Greqia (62%) dhe Gjermania (pak më shumë se 50%), por ajo thuhet se është shuar tërësisht në vende

si Franca, e cila mbështetet më së shumti në energjinë bërthamore. Pavarësisht faktit se djegia e qymyrit zë rreth 25% të totalit të dioksidit të karbonit të nxjerrë në BE, sasia e madhe e tij, (Evropa ka rezerva të identifikuar prej rreth 40 miliardë ton), bën që shumica e analistëve të mendojnë se qymyri do të vazhdojë të luaj një rol domethënës në strukturën e energjisë së BE-së.⁵⁷ Duke patur parasysh varësinë e vazhdueshme nga qymyri dhe duke njohur “përfitimet e mëdha të mundshme të një përdorimi të vazhdueshëm të [qymyrit]”, BE-ja ka filluar të investojë në teknologji të tilla si ajo për kapjen dhe sekuestrimin e karbonit (CCS) të cilat do të mundësojnë të ashtuquajturën djegie të pastër të qymyrit. Teknologjia aktuale mendohet se do të mundësojë efikasitetin e më shumë se 60%, por shumica e centraleve evropiane të vjetër ose të ndërtuar së fundmi kanë efikasitete që variojnë nga 30% në 40%.⁵⁸

Vendet anëtare të BE-së kanë përqafuar përpjekjet e Komisionit për të forcuar avancimet teknologjike në fushën e djegies së pastër të qymyrit dhe për të sjellë 12 centrale me djegie fosile në nivelin e duhur deri në vitin 2015. Pavarësisht kësaj, disponueshmëria afatgjatë e vendeve anëtare që të arrijnë objektivat e tyre për uljen e nxjerrjes së karbonit, potenciali për përdorimin e energjisë së rinovueshme, çmimi i gazit natyror, dhe kostoja e instalimit të teknologjive të djegies së pastër të qymyrit do të diktojnë me shumë gjasa nëse qymyri do të mbetet një burim alternativ energjie për Evropën.

Energjia bërthamore. Edhe pse energjia bërthamore llogaritet për rreth një të tretën e prodhimit total të elektricitetit, ndryshime të theksuara në politikat kombëtare për energjinë bërthamore kanë ndalur BE-në nga zhvillimi i një politike bërthamore të përbashkët. Gati 175 reaktorë bërthamorë janë në përdorim sot në Evropë. Megjithatë, ndërsa vende si Franca, Finlanda dhe Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar mbështeten gjerësisht në energjinë bërthamore, të tjerë e kundërshtojnë atë me argumentin se është e rrezikshme dhe se krijon probleme për depozitimin e mbetjeve. Gjermania dhe Spanja për shembull janë zotuar të mbyllin të gjithë reaktorët bërthamorë të tyre gjatë viteve në vazhdim dhe ti zëvendësojnë ato me pajisje që funksionojnë me gaz. Presioni politik për të ri-menduar këto vendime ose të paktën për të shtuar kohën deri në mbylljen e

⁵⁷ Komisioni Evropian, “Sustainable Power Generation from Fossil Fuels: Aiming for Near-Zero Emissions from Coal after 2020”, COM(2206)843 Final; Komisioni Evropian, Coal Market Outlook, 2005; “Coal: a Clean Source for the Future?” Euractiv.com, korrik 2006.

⁵⁸ Ibidum.

tyre po rritet vazhdimisht në të dy vendet dhe Mbretëria e Bashkuar, Finlanda dhe Lituania kanë rënë të gjithë dakord që të shtojnë reaktorë të rinj. Pavarësisht kësaj, duke patur parasysh kostot e mëdha për vendosjen e reaktorëve nuklearë sipas standardeve dhe çështjen kundërshtuese rreth mbetjeve bërthamore, duket se ka shumë pak gjasa që Evropa do të shohë një rilindje të reaktorëve të rinj bërthamorë në vendet ku fuqia bërthamore nuk luan ende një rol. Në rastin më të mirë, ato vende që përdorin tashmë energjinë bërthamore mund të pritet që të përmirësojnë ose zëvendësojnë reaktorët e tyre ekzistues. Nga ana tjetër mbrojtësit e gjenerimit të energjisë nëpërmjet energjisë bërthamore duke se po fitojnë fuqi në Evropë duke patur parasysh se gjenerimi i energjisë përmes energjisë bërthamore faktikisht nuk çliron gazra serrë.

Një alternativë premtuese mund të gjendet në programin e Reaktorit Ndërkombëtar Termonuklear Eksperimental (RNTE). BE-ja ka bashkuar ShBA-në dhe një sërë vendesh të tjera në një përpjekje për të prodhuar energji elektrike nga fuzioni nuklear i cili ndryshe nga energjia aktuale bërthamore nuk gjeneron mbetje të rrezikshme. Pajisja e parë do të ndërtohet në Francë por rezultatet e para nuk priten për të paktën 15-20 vjet.

Energjia e Rinovueshme. Energjia hidrike, diellore dhe e bio-masës zënë aktualisht rreth 7% të konsumit total të energjisë së Evropës dhe 15% të gjenerimit të saj të elektricitetit. Në mars të vitit 2007 vendet anëtarë të BE-së ranë dakord për një objektiv të detyrueshëm ligjor i cili theksonte se 20% e konsumit total të energjisë mund të furnizohej nga burimet e rinovueshme të energjisë deri në vitin 2020. Në janar të vitit 2008, Komisioni Evropian propozoi objektiva individuale kombëtare të energjisë së rinovueshme të cilat synonin që të realizonin qëllimin e gjerë të BE-së. Me propozim të Komisionit, vendet me sektorë të avancuar të energjisë së rinovueshme si Austria, Suedia dhe Danimarka pritet që të arrijnë objektiva shumë më ambiciozë sesa anëtarët e rinj të Evropës Qendrore dhe Lindore. Vendet anëtare do të kenë gjithashtu mundësinë që të investojnë në projekte të energjisë së rinovueshme në vende të tjera të BE-së. Udhëheqës të shteteve individuale pritet të konsiderojnë objektivat e propozuara kombëtare në samitin e verës së vitit 2008.

Pavarësisht se mbështetja e gjerë e BE-së për energjinë e rinovueshme është e fortë, portfoliot e energjisë së rinovueshme variojnë sipas shteteve anëtare. Për shembull, Austria dhe Letonia nxitin energjinë hidrike, ndërsa Republika Çeke dhe Portugalia kanë vënë në dispozicion resurset e tyre financiare

për pajisje të mëdha të energjisë diellore. Gjermania, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar janë shtëpia e një sërë fermash ere në brigjet e tyre. Programe të bio-masës dhe lëndëve djegëse bio po bëhen gjithnjë e më tërheqës. Duke patur parasysh se sektori i varur nga nafta i transportit në Evropë zë përafërsisht çerekun e nxjerrjes totale të karbonit të BE-së, BE-ja ka mandatuar se lëndët djegëse bio përbëjnë 10% të totalit të saj të lëndëve djegëse të transportit deri në vitin 2020.

Nëse BE-ja do të përmbushë objektivat e saj për energjinë e rinovueshme do të varet me shumë gjasa nga kostoja e prodhimit dhe niveli deri në të cilin vendet anëtare do të duan të subvencionojnë zhvillimin e tyre në shkallë të gjerë. Siç u theksua dhe më parë, një raport i marsit 2007 i McKinsey and Company vlerëson se vendet anëtare të BE-së duhet të investojnë afërsisht për 1.5 trilionë USD (1.1 trilionë Euro) në teknologji të reja gjatë 14 viteve të ardhshëm për të arritur objektivat e tyre lidhur me nxjerrjen e karbonit dhe objektivat që lidhen me të, për energji të rinovueshme dhe për efikasitet të energjisë. Duket se Komisioni, Banka Evropiane e Investimeve dhe vendet anëtare individuale janë të destinuara të ngrenë në mënyrë të konsiderueshme investimet e tyre në këto sektorë edhe pse është vështirë të parashikohen shuma të sakta. Disa vende anëtare kanë prezantuar programe për subvencionimin dhe dhënien e kredive me interes të ulët për financimin e studimeve dhe zhvillimit të energjive të rinovueshme me vende si Gjermania, duke shpresuar se do të krijojnë kapacitetin industrial për të furnizuar atë që zyrtarët Gjermanë e quajnë një treg botëror gjithnjë e më tërheqës për energjinë e rinovueshme.⁵⁹

Sfida e 3-të: Pajisja me Siguri Energjitike nëpërmjet një Tregu të Brendshëm Energjistik

Komisioni Evropian ka argumentuar prej një periudhe të gjatë se vendet anëtare mund të ngrinin në mënyrë të dukshme nivelin e sigurisë së furnizimit me energji si dhe rrjetin dhe efikasitetin e kostos duke integruar tregjet kombëtare të gazit dhe elektricitetit në Tregun Unik Evropian të BE-së.⁶⁰ Megjithatë, pavarësisht reformave për liberalizimin e tregjeve në disa vende anëtare,

⁵⁹ Intervista të zyrtarëve gjermanë, janar-mars 2007.

⁶⁰ Akti Unik Evropian i cili hyri në fuqi në vitin 1987 vendosi atë që quhet Tregun Unik Evropian duke lejuar lëvizjen e lirë brenda BE-së për mallrat, njerëzit, shërbimet dhe kapitalin ndërmjet BE-së.

tregjet kombëtare të energjisë mbeten gjerësisht nën kontrollin e shtetit. Duke qenë se shqetësimet për sigurinë energjitike janë ngjitur në majat e agjendës së BE-së, është shtuar gjithashtu edhe debati mbi liberalizimin e tregut të energjisë. Komisioni dhe disa vende anëtare theksojnë se liberalizimi dhe integrimi i tregut do të shtonin sigurinë energjitike me anë të forcimit të lidhjeve në rrjet dhe të ndërveprimit të gjerë në nivel BE-je si edhe të diversifikimit të burimeve të furnizimit, ndërsa të tjerë argumentojnë se mbrojtja kombëtare e vazhdueshme është e rëndësishme për të garantuar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt dhe për të mbrojtur konsumatorët ndaj ndryshimeve të vazhdueshme të një tregu të lirë dhe të pa parashikueshëm.⁶¹ Propozimi i Komisionit për zhvillimin e një tregu të brendshëm mbarë Evropian për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit dhe energjisë vazhdon të shkaktojë debat dhe analistët nuk presin që vendet anëtare të ndërmarrin ndonjë veprim konkret në këtë fushë përpara mesit të vitit 2008.

Komisioni ka iniciuar fillimisht përpjekjet e tij për krijimin e një tregu konkurrues evropian për gazin dhe elektricitetin që nga mesi deri në fundin e vitit 1990, duke nxjerrë një sërë Direktivash që përqendrohen në katër objektiva kryesorë: 1) implementimi i një tregu unik për energjinë duke nxitur konkurrueshmërinë dhe efikasitetin në prodhimin dhe shpërndarjen e elektricitetit dhe gazit, 2) uljen e çmimeve dhe për t'u dhënë të gjithë konsumatorëve të BE-së mundësinë që të zgjedhin furnizuesin e tyre me energji deri në vitin 2007, 3) të ndihmojë për përmirësimin e mjedisit, dhe 4) të shtojë sigurinë energjitike. Megjithatë shumë vende anëtare duket se e shohin politikën energjitike si shumë të rëndësishme brenda mjedisit të tyre ekonomik që ata të heqin dorë nga kontrollet kombëtare, duke argumentuar se në Evropë industritë e nacionalizuara kanë siguruar, në shumicën e rasteve, stabilitet në tregun e energjisë. Në fakt, pozicionet dominante të kompanive të energjisë në disa vende kanë bërë që qeveritë e tyre të marrin masa për mbrojtjen e industrive edhe pse ato po i nënshtrohen gjithnjë e më shumë teorisë së konkurrencës së tregut të hapur.⁶²

Gjatë viteve të shkuara, Komisioni ka rritur përpjekjet për promovimin e udhëzimeve të BE-së për përcaktimin e pronësisë

⁶¹ Katinka Barsch, Simon Tilford dhe Aurore Wanlin, "The Lisbon Scorecard VII – Will Globalization Leave Europe Stranded?" Centre for European Reform, mars 2007.

⁶² Për më shumë informacion shih CRS Report RS22468, "Europa: Shtimi i Nacionalizmit Ekonomik?" nga Raymond J. Ahearn.

dhe aksesit në rrjetin elektrik, tubacionet, dhe në pajisjet e ruajtjes së energjisë në rastet e emergjencës. Propozimi më i fundit dhe më kontradiktor i Komisionit do të ulë fuqinë e kompanive me pronësi shtetërore të energjisë duke i detyruar ato të ndajnë pronësinë e rrjeteve të gjenerimit dhe shpërndarjes. Komisioni thekson se pronësia e dyfishtë bllokoi konkurrencën dhe lejon manipulimin e çmimit. Megjithatë, kundërshtitë për këtë ndarje nga Gjermania, Franca dhe Spanja kanë çuar Komisionin në kërkimin për negociim të propozimeve alternative. Këto vende pritet që të prezantojnë propozime të tilla deri në fillim të vitit 2008.⁶³

Ndërlidhja e rrjetit. Ndërsa progresi drejt një tregu të liberalizuar evropian të energjisë vazhdon, diskutimi mbi sigurinë e energjisë pritet të përqendrohet në aftësinë e tregut të brendshëm për të transferuar siguri energjitike nëpërmjet tubacioneve ndërlidhëse dhe rrjeteve elektrike si dhe për të siguruar sigurinë infrastrukturore dhe furnizimin në rast emergjence.

Rrjeti evropian i transmetimit të energjisë elektrike, ndahet në disa “grumbuj” rajonale të cilët sipas Komisionit janë të lidhur në mënyrë të dobët ndërmjet tyre. Shkëmbimet ndërkufitare të energjisë janë shtuar së fundmi. Për shembull, në korrik 2006, sektori francez i elektricitetit bleu fuqi shtesë nga Gjermania për të kënaqur kërkesat në rritje në Francë si pasojë e një vale të nxehti. Megjithatë, në vitin 2005, vetëm rreth 10% e kapacitetit aktual të instaluar të gjenerimit të energjisë në Evropë mund të kalohej përtej kufijve kombëtarë. Edhe pse ekzistojnë shembuj të mirë të bashkëpunimit ndërkufitar, sidomos në rajone të tilla si Pellgu Nordik, shumë theksojnë se një sërë ndërprerjesh gjatë viteve 2005 dhe 2006 u shkaktuan nga lidhjet e dobëta ndërmjet tregjeve kombëtare dhe rajonale të elektricitetit dhe nga kapacitetet e pamjaftueshme për gjenerim. Si rrjedhojë, BE-ja ka shtuar përpjekjet për inkurajimin e investimeve në ndërtimin e rrjeteve të ndërlidhjes ndërkufitare të elektricitetit dhe për shtimin e këtij aktiviteti edhe në sistemet shpërndarëse të gazit, naftës dhe GNL-së.

Vlerësim

Shumica e vendeve anëtare të BE-së kanë mbajtur prej shumë kohësh pikëpamjen se politika energjitike duhet të mbetet përgjegjësia kryesore e vetë shteteve. Megjithatë, vendet

⁶³ Shih “*Rruga e tretë për konkurrencën energjitike.*” *EuropeanVoice.com*, 24 janar, 2008.

evropiane, kanë filluar të ri-mendojnë energjinë jo vetëm si një element të sigurisë kombëtare individuale por edhe si një element të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (PPJS). Për më tepër shqetësimi publik dhe politik në rritje i Evropës përsa i përket ndryshimeve klimaterike globale duket se ka nxitur veprimin evropian për uljen e vartësisë së saj energjitike duke kërkuar që të rritë efikasitetin dhe të ulë çlirimin në ajër të karbonit brenda Evropës. Pra, nga tre pikat kryesore të politikës së sigurisë energjitike të BE-së (marrëdhëniet e jashtme, furnizimi i brendshëm me energji, dhe tregu i përbashkët i energjisë) përpjekjet për promovimin e një sektori të brendshëm më të pastër dhe më efikas të energjisë kanë marrë mbështetjen nga shumica e vendeve anëtare.

Disa skeptikë dyshojnë tek aftësia e vendeve anëtarë të BE-së për të finalizuar një marrëveshje mbi një sërë çështjesh që lidhen me energjinë, sidomos për sa i përket menaxhimit të marrëdhënieve të jashtme dhe krijimit të një tregu të brendshëm. Vazhdon të ketë mosmarrëveshje të vazhdueshme lidhur me mënyrën se si duhet vepruar me Rusinë dhe mbi strategjitë e duhura të diversifikimit, dhe shumica e vendimeve që i përkasin burimeve të jashtme të furnizimit dhe termave të kontratave ka shumë mundësi të mbeten në duart e vendeve anëtare individuale dhe të sektorëve të tyre të energjisë. Tregjet e hapura dhe konkurruese energjitike janë të dëshiruara, por mbrojtja e industrive kombëtare energjitike është ende mbizotëruese në disa shtete kryesore, duke përfshirë Gjermaninë, Francën dhe Spanjën. Disa vende duken jo entuziaste për sa i përket lënies së vendimeve rregullatorë në dorë të burokratëve të Brukselit.

Nga ana tjetër, BE-ja po rrit rolin e saj në koordinimin dhe financimin e zhvillimit të energjisë së rinovueshme dhe për magazinimin dhe përdorimin e energjisë për rastet emergjente të furnizimit. Edhe pse vendet anëtare dhe industritë e tyre energjitike duket se kanë gjasa që të mbajnë autoritetin absolut në përcaktimin se cili miks energjitik ka më tepër kuptim për vendet individuale, BE-ja ka vendosur objektiva të detyrueshëm në mbarë Evropën për disa sektorë dhe mund të vazhdojë me këtë tendencë. BE-ja gjithashtu po këmbëngul që ajo të luajë një rol më të madh në përcaktimin e marrëveshjeve të ndërlydhjeve të sistemit energjitik dhe të niveleve të investimit në infrastrukturën energjitike. Lidhur me politikën e jashtme, po ndërmerren përpjekje për përparimin e dialogut me Rusinë dhe me rajone të tjera prodhuese dhe transite të energjisë në një mënyrë më të hapur dhe më koordinuese ndërmjet Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme

dhe të Sigurisë së BE-së dhe shteteve anëtare individuale, dhe Komisioni ka nënvizuar qëllimet specifike të politikës së jashtme lidhur me traktatet shumëpalëshe dhe me zgjerimin e Politikës Evropiane të Fqinjësisë (PEF). Pavarësisht kësaj, politika e jashtme vazhdon të jetë e përcaktuar, fillimisht dhe kryesisht, prej qeverive kombëtare.

Siguria Energjitike në Kontekstin Transatlantik

Gjatë 55 vjetëve të shkuara, marrëdhëniet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe BE-së janë zgjeruar dhe thelluar në mënyrë të qëndrueshme sa që të dy këta aktorë janë të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me njëri-tjetrin. Nuk ka sektor tjetër ku integrimi transatlantik të jetë shfaqur më shumë sesa në atë ekonomik. Partneriteti ekonomik ShBA-BE është përshkruar prej shumëkujt si influenca më e madhe dhe më e rëndësishme në rritjen ekonomike, prosperitetin dhe tregtinë globale.⁶⁴ Në kuadër të zgjerimit të marrëdhënieve ekonomike transatlantike, politika e sigurisë energjitike po bëhet një prioritet gjithnjë e më i madh për Shtetet e Bashkuara dhe për BE-në. Të marrë së bashku, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian përfaqësojnë tregun më të madh energjistik botëror. Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja prodhojnë përafërsisht 23% të energjisë botërore por ndërthuren për rreth 40% të konsumit botëror të energjisë.⁶⁵ Së bashku Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja zënë thajse 40% të çlirimit total botëror të karbonit.⁶⁶

Gjatë samiteve BE-ShBA të vitit 2006 dhe 2007, partnerët ranë dakord që të shtonin bashkëpunimin mbi sigurinë energjitike, ndryshimet klimaterike dhe çështjet e një mjedisi të qëndrueshëm. Tre mekanizma institucionalë u vendosën për lehtësimin e këtij bashkëpunimi: një rishikim strategjik vjetor i bashkëpunimit energjistik BE-ShBA, një Dialog i Nivelit të Lartë mbi Ndryshimin Klimaterik BE-ShBA, Energjinë e Pastër dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe një forum BE-ShBA për nxjerrjen

⁶⁴ Për një shpjegim më të detajuar të marrëdhënieve ekonomike shih Hamilton dhe Quinlan, "Integrimi i Thellë: Si tregjet Transatlantike po udhëheqin Globalizimin," Johns Hopkins University School of Advanced International Studies, 2004

si një trashëgimi strukturore e dobishme nga pikëpamja mjedisore dhe ekonomike të trashëguara nga komunizmi. Një sërë autorësh vënë në dukje se sisteme të tilla kanë potencialin për të ofruar shërbime energjie efikase, të drejta dhe ekologjiksht të qëndrueshme, nëse ato menaxhohen siç duhet (Kazakevicius et al, 1998;. Brendow, 2003;. Velody et al, 2003).

Duket se shumë prej këtyre dhe mundësive të tjera për 'avancimin' drejt operacioneve më efikase të energjisë - duke përfshirë përfitimet e vendosjes së planifikimit të integruar dhe normave tradicionalisht të ulëta të konsumit individual në nivelin e familjeve - kanë qenë të humbura në shumë shtete të EQL si rezultat i aplikimit të shpejtë të politikave në njëdrejtimëshe të reformës neoliberale. Në veçanti, ekziston rreziku që vendet post-socialiste nuk do të jenë në gjendje të shfrytëzojnë përfitimet mjedisore dhe të konsumit të energjisë të rrjeteve të transportit publik të mirë zhvilluara në mjediset kompakte urbane si rezultat i tendencave të gjera të suburbanizimit (shpesh të mbështetura tërthorazi apo drejtpërdrejt nga shteti), si dhe lëvizja në drejtim të zotërimit dhe përdorimit të makinës. Üрге-Vorsatz et al. (2006) thekson se 'ekonomitë që po transformohen ngadalë' në ish-BS mund të pozicionohen më mirë për të përfituar nga mundësi të tilla, në qoftë se hartuesit e politikave në shkallë të ndryshme - duke përfshirë jo vetëm nivelin lokal, por edhe institucionet financiare multilaterale – të jenë në një pozitë që të pranojnë dhe të zbatojnë trajektoret alternative të ristrukturimit të energjisë dhe ndryshimit ekonomik, të ndjeshëm ndaj shumëllojshmërisë së rezultateve të politikës dhe të rrethanave lokale. Ata gjithashtu theksojnë se procesi i lënë shpesh pas dore i ndryshimeve kulturore dhe të sjelljes në post-socializëm ka të ngjarë të ngadalësojë rënien e intensiteteve të energjisë edhe në qoftë se 'politika, reforma legjislative dhe institucionale më radikale' të zbatoheshin njëherazi në EQL dhe ish-B.S.

Destabilizimi i hierarkive kombëtare, sektoriale dhe skalare: shfaqja e topologjive të reja të pushtetit

Përveç ndryshimit të mbështetjes ekonomike dhe infrastrukturore të operacioneve të sektorit të energjisë në EQL dhe ish-B.S, transformimi post-socialist ka futur edhe një varg të tërë interesash të reja gjeopolitike dhe marrëdhëniesh të pushtetit në këtë fushë, në sajë të, ndërmjet zhvillimeve të tjera, hapjes së tregjeve të energjisë në Rusi dhe në Azinë Qendrore ndaj investimeve të huaja dhe tregtisë ndërkombëtare, dhe kërkesës në rritje për gaz natyror në Evropën Perëndimore. Vendndodhjet

territoriale të prodhimit të energjisë dhe nxjerrjes së objekteve, rrjetet transit dhe qendrat e konsumit kanë fituar më shumë rëndësi se kurrë më parë, ndërsa interesat konkurrues janë përpjekur të drejtojnë dhe formësojnë rrjedhjet e energjisë sipas interesit të tyre. Një dinamikë specifike e pushtetit është shfaqur në kufirin mes ish-BS dhe Bashkimit Evropian, kryesisht në sajë të ekzistencës së një marrëdhënie prodhues - konsumator të energjisë që i lejon burimet dhe shërbimet e energjisë të rrjedhin në mes të dy sferave. EQL, si një hapësirë transiti me një nevojë të konsiderueshme për zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës (siç argumentohet nga Klaassen et al., 2001), është bërë një arenë territoriale kyçe për artikulumin dhe ndërmjetësimin e forcës gjeopolitike nëpërmjet rrjeteve të energjisë.

Gazsjellësit dhe rrjetet elektrike në veçanti mishërojnë përzierjen territoriale të marrëdhënieve ndërkombëtare të pushtetit, pasi çështja që ata mbartin nuk mund të transferohet nga prodhuesi te konsumatori, pa një lidhje të drejtpërdrejtë fizike të caktuar në hapësirë. Përveç kësaj, 'energji është një e mirë në thelb e paqartë sepse ajo mund të konsiderohet njëherazi një mall i vërtetë i tregtueshëm mbi bazën e konsideratave tërësisht tregtare, si një shërbim (për shembull, transportimi), dhe si një e mirë strategjike për t'u përdorur si një mjet i politikës së jashtme (për shembull, gjatë krizës së naftës 1973-1974) '(Westphal, 2006: 58). Një nga shembujt më të mirë të këtyre rrethanave është dhënë nga gazsjellësi Nord Stream, një ndërmarrje e përbashkët midis shoqërisë Ruse Gazprom, me 51 për qind të pronësisë, Wintershall i Gjermanisë dhe E. ON, secila me 20 për qind të aksioneve, dhe Gazunie Hollandez, me 9 përlindë të aksioneve (Një shqyrtim i hollësishëm i zhvillimit të sektorit të Gazit dhe Naftës në Europë, 2007 (Emerging Europe Oil and Gas Insight, 2007). Gazsjellësi është projektuar për të kaluar për 1.200 km përgjatë nivelit të detit Baltik drejtpërdrejtë mes dy vendeve, fillimisht duke mbartur deri në 27,5 bcm/vit (PEEE, 2007).

Propozimi i Nord Stream ka shfaqur aftësi njëkohësisht për të formësuar, dhe që të formësohet nga, zhvillimet politike dhe ekonomike në rajonin e detit Baltik dhe EQL më në përgjithësi (Bouzarovski dhe Konieczny, në pritje). Që nga shpallja zyrtare në vitin 2005, projekti është përballur me kritika të ashpra nga zyrtarët publik në vendet fqinje, kryesisht për shkak të shqetësimeve se 'është e vështirë për të thënë se ku mbaron Gazprom dhe ku fillon shteti Rus' (Rutland, 1997: 8). Debatet politike lidhur me projektin kanë nxitur shpesh çështje të interesave të sigurisë kombëtare dhe të identitetit etnik (Browning, 2003: 45). Vlerësimet që kostoja e parashikuar e gazsjellësit do të 'kalojë trefish koston e ndërtimit të një gazsjellësi në rrugë tokësore me të njëjtin kapacitet' (Belton dhe Dombey, 2007) i ka shtuar më

tejt këto frikëra, së bashku me deklaratat zyrtare ruse të tilla si ajo e Presidentit Putin, në të cilën ai theksoi se “Rusia duhet të zvogëlojë varësinë nga vendet e tranzitit, të tilla si fqinjët Bjellorusia dhe Ukraina, për të ndihmuar në garantimin e sigurisë së furnizimit me energji të Evropës” (Buckley dhe Parker, 2007).

Në të vërtetë, është pohuar shpesh që Rusia është duke përdorur tashmë ‘forcën e muskujve’ të saj për qëllime politike dhe ekonomike duke mbyllur, për shembull, një naftësjellës në Lituani, pas shitjes së një rafinerie kyçe në vend një shoqërie Polake në vend të një shoqërie Ruse (PEEE, 2007) ose ndërprerja e eksporteve të naftës për në Estoni pas krizës së fundit politike të lidhur me zhvendosjen e varrezave Sovjetike, apo në grupin e lartpërmendur të mosmarrëveshjeve të energjisë transite me Ukrainën (dhe Bjellorusinë, në 2007 - shih BBC News, 2007a). Por disa ekspertë theksojnë se, ‘në epokën post-Sovjetike, është mjaft më e vështirë për të hartuar një skenar në të cilin Rusia do të zgjedhë të kërcënojë vendet Evropiane - individualisht ose kolektivisht, nga ana tregtare ose politikisht - duke kërcënuar me ndërprerjen e furnizimit me gaz’ (Stern, 2002: 18), ndërsa duke vënë në dukje që situata mund të ndryshojë rrënjësisht pasi Rusia të përmirësojë lidhjet me rrugë tokësore të gazit të eksportuar në Kinë dhe tregjet e tjera të mëdha aziatike. Ende, dhe pa marrë parasysh vendimin përfundimtar për këtë çështje, është e qartë se tubacionet e naftës dhe të gazit janë instrumentalizuar për qëllimet e projekteve dhe marrëdhëniet e pushtetit midis shteteve të ndryshme në fushën post-sovjetike. Nord Stream jo vetëm kanalizon pushtetin dhe ndikimin përgjatë një ‘vije materiale të fluturimit’ një (për të përdorur gjuhën e Deleuze dhe Guattari, 1988), por ka dhënë gjithashtu arenën për luftërat gjeopolitike dhe konfliktet e interesave më gjerë.

Politikat post-socialiste të tubacioneve kanë qenë thellësisht të implikuar edhe në modelet e rritjes ekonomike dhe të zhvillimit kombëtar. Kjo është për shkak se vendet e ndryshme në EQL kanë ndërmarrë hapa individualë për të diversifikuar burimet e furnizimit të tyre me energji, në mungesë të një kuadri të qartë ndërkombëtar për rregullimin e interesave të përbashkëta të politikës energjetike. Polonia po ndërton një terminali gazi me azot të lëngshëm prej 459.000.000 \$ SHBA me një kapacitet fillestar prej 2,5 bcm /vit (PEEE, 2007). Në Letoni, ministri i ekonomisë ka sugjeruar që gazsjellësi Nord Stream mund të përfshijë një nxitje të depos nëntokësore për pajisjet e planifikuara nga vendi i tij (Laurila, 2003: 39; Një shqyrtim i hollësishëm i zhvillimit të sektorit të Gazit dhe Naftës në Europë, 2007). Republika Çeke gjithashtu synon të lidhet me Nord Stream

nëpërmjet një gazsjellësi në drejtim verior nga kufiri i saj për në detin Baltik, që do të ndërtohet nga shoqëria Gjermane e energjisë RWE (Një shqyrtim i hollësishëm i zhvillimit të sektorit të Gazit dhe Naftës në Europë, 2007, Hulpachová, 2007) . Kjo i ngjan - të paktën në aspektin territorial - një projekti të mëparshëm të implementuar nga ana e Çekisë, që përfshin ndërtimin e një naftësjellësi nga Norvegjia, në mënyrë që të reduktojë varësinë e saj nga nafta Ruse. Në Evropën Juglindore, Bashkimi Evropian po i jep një mbështetje të madhe gazsjellësit të Nabucco-s, që do ta transportojë gazin e Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme nga Turqia në Austri përmes Ballkanit (*Radio Free Europe / Radio Liberty*, 2009, Eubusiness.com, 2009) . Rivali kryesor i këtij projekti është gazsjellësi South Stream, një iniciativë e mbështetur nga Gazprom- që do të sjellë gazin Rus gjithashtu në kufijtë Austriakë dhe Italianë nëpërmjet një rruge mbi tokësore të Ballkanit (*Radio Free Europe / Radio Liberty*, 2009).

Në përgjithësi, gjeopolitika e marrëdhënieve të energjisë gjatë transformimit post-socialist i ka zhvendosur shumicën e shteteve të EQL nga një regjim politik reaktiv - në të cilën organet përkatëse qeverisëse ishin vëzhgues pasiv të, në vend të agjentëve aktivë në, strukturën e re të rrjeteve socio-teknike që zhvillohen në rajon - në një proaktiv, ku ata kanë ndërmarrë hapa të qëllimshëm për të krijuar një strukturë të re të marrëdhënieve të pushtetit dhe ndërvarësive të energjisë. Përveç të qenit i ndikuar nga një grup i veçantë të rrëfimeve të identitetit, diskutet politike dhe strategjitë e politikës së jashtme (eksplorimi i të cilave, megjithatë, do të shtrihej përtej qëllimeve të këtij shkrimi), vlen të përmendet se faza e dytë ka krijuar rrjete të reja të pushtetit gjithashtu në të gjithë hapësirën post-socialiste. Kjo do të thotë që topologjitë, më tepër se sa topografit e infrastrukturave të energjisë kanë pasur rëndësi në artikulumin e interesave të pushtetit në shkallë të ndryshme. Kjo tregohet nga fakti se, për shembull, propozimet e Nabucco-s dhe South Stream shprehin marrëdhënie politike reciprokisht konfliktuale, pavarësisht se përshkojnë një grup të ngjashëm vendesh dhe rajonesh (*UPI.com*, 2009). Një situatë e ngjashme mund të gjendet në rastin e Nord Stream dhe propozimit të gazsjellësit rival të tij - Amber - i cili mbështetet nga shtetet Baltike dhe Polonia. Kështu, gazsjellësit janë pjesë e grupimeve të ndryshme që funksionojnë nëpërmjet një sërë topologjish heterogjene të pushtetit, pavarësisht se janë të vendosur në hapësirë reale, topografike.

Këto kushte tregojnë për një tjetër grup pasojash të procesit të transformimit post-socialist të energjisë: destabilizimin e marrëveshjeve të vendosura më parë të kufijve kombëtarë dhe hierarkive skalare. Futja e një strukture të re teknologjike në

sektorin e energjisë në rajon ka krijuar një grup në zhvillim të ndërvarësive hapësinore, politike, ekonomike dhe infrastrukture ndërmjet fushave të ndryshme territoriale, duke transformuar me shpejtësi rëndësinë dhe funksionin e kufijve kombëtarë ndërmjet tyre. Zhvillimet e kohëve të fundit në rajonin e Ballkanit sigurojnë një nga ilustrimet më të fuqishme të kësaj dinamike: pavarësisht dekadave të konfliktit politik dhe mosmarrëveshjes, shtetet në rajon kanë punuar kohët e fundit së bashku për të krijuar kuadrin e bashkëpunimit rajonal të energjisë, veçanërisht në lidhje me hapjen e tregjeve të energjisë dhe ndërtimit të pajisjeve të gjeneratës së re (shih *RedOrbit.com*, 2005, *BBC News*, 2007b; Traktati i Komunitetit të Energjisë, 2009). Në kulmin e krizës së gazit në 2009, Serbia i ofroi Bosnjës një pjesë të rezervave të saj të kufizuara të gazit falas, pavarësisht historisë së kohëve të fundit të luftës dhe konfliktit midis dy vendeve (*BalkanInsight.com*, 2009). Në të vërtetë, vendet e Ballkanit të prekura nga kriza e gazit mund të mbështeten vetëm në zgjidhjet e negociuara ndërkombëtare për të zgjidhur efektet e saj, pavarësisht nëse kjo lidhej me bashkëpunimin me vendet fqinje ose pjesëmarrjen në përpjekjet më të gjera për të zgjidhur mosmarrëveshjen Ukrainë-Rusi.

Në tërësinë e tyre, këto tendenca tregojnë që kuptimet e përkohshme të sigurisë së energjisë në EQL dhe ish-BS, dhe më gjerësisht në Evropë, nuk mund të përfshihen konceptualisht vetëm nën një kornizë të bazuar në shtetin-komb, siç ka qenë rasti i deritanishëm (për shembull, shih Yergin, 2006, Klare, 2008). Jo vetëm në këto dy dekadat e fundit shihet një lëvizje e marrëdhënieve të sigurisë së energjisë drejt institucioneve ndërkombëtare dhe globale, por edhe shkalla e ekonomisë shtëpiake ka fituar rëndësi të re. Shfaqja e varfërisë energjitike post-socialiste, një gjendje në të cilën familjet nuk mund të ngrohnin shtëpitë e tyre në nivelin e duhur, ka dhënë një nxitje të fortë në këtë drejtim. Kryesisht, varfëria energjitike në këtë pjesë të botës është produkti i ribalancimit të shpejtë të çmimeve të energjisë dhe strehimit joefikas dhe mund të prekë miliona familje në shtetet më të varfra në tranzicion (Lampietti dhe Meyer, 2002; Kovaëeviaë, 2004; Fankhauser dhe Tepic, 2005; shih gjithashtu Round dhe Williams, 2010). Si një problem që shtrihet në ndërfaqen e sektorëve të energjisë, strehimit, shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale, ajo lind shpesh si rezultat i koordinimit të dobët të organizatave të ndryshme publike dhe private që veprojnë në këto fusha (Buzar, 2007). Si e tillë, ajo ilustron nevojën për bashkëpunim dhe koordinim ndër-sektoriale: energjia nuk është më një çështje që mund të konsiderohet vetëm në aspektin teknik ose ekonomik, dhe në izolimin nga pjesa tjetër e ekonomisë dhe shoqërisë.

Pavarësisht pasojave të gjera shoqërore dhe shëndetësore të mungesës së energjisë së brendshme, zgjerimi skalar dhe sektoriale i sigurisë së energjisë është ndjerë kryesisht në nivel ndërkombëtar, i cili ka parë krijimin e mekanizmave dhe strategjive të reja politike në përgjigje të rritjes së kompleksitetit të rrjeteve të energjisë në rajon. Ashpërsia e luftërave gjeopolitike mbi furnizimin me energji dhe transitin ka pasur nevojë për formulimin e një politike të energjisë së BE-së që mund të ndihmojë në koordinimin e negociatave të planeve kontradiktore të zhvillimit të energjisë në EQL. Megjithatë, një kuadër i tillë është ende inekzistent, përveç rritjes së presionit politik dhe faktit që disa elemente të një qasjeje të gjerë joformale të BE-së ekzistojnë tashmë: për shembull, një dialog për energjinë BE-Rusi me qëllim krijimin e një partneriteti afatgjatë të energjisë ka ekzistuar që nga viti 2000. Sipas Belyi (2003), ky proces nënvizon mbështetjen e BE-së për projektet e infrastrukturës së energjisë Ruse të nevojshme për furnizimin me naftë dhe gaz, duke krijuar 'një model të qëndrueshëm për bashkëpunim' dhe inkurajimi i 'Rusisë për të marrë pjesë aktive në kornizat e mëdha ndërkombëtare shumëpalëshe' (Belyi 2003: 352)

Një nga të paktat korniza institucionale funksionale për bashkëpunimin ndër-qeveritar në lidhje me rajonin EQL është Traktati i Kartës së Energjisë (ECT), një marrëveshje ndërkombëtare që synon forcimin 'e sundimit të ligjit mbi çështjet e energjisë, duke krijuar një mjedis me të njëjtat rregulla që duhet të vëzhgohen nga të gjitha qeveritë pjesëmarrëse, duke zbutur rreziqet që shoqërohen nga investimet e lidhura me energjinë dhe tregtinë' (Karta e Energjisë, 2007). Megjithatë, fakti që Rusia ka refuzuar të marrë pjesë në këtë proces, i shoqëruar me vështirësitë gjeopolitike e krijuar nga zhvillimet e gazsjellësit si Nord Stream, ka dëmtuar aftësinë e Traktatit për të ofruar një bazë të qëndrueshme për ndërmjetësimin e konfliktit në fushën e konflikteve ndërkombëtare të energjisë.

Përfundim

Kur Grabher dhe Stark (1998) botuan veprën e tyre kryesore mbi 'trashëgimitë, lidhjet dhe lokalitetet' më shumë se një dekadë më parë, kam dyshim që ata i nxorën idetë e tyre teorike nga procesi i ndryshimit evolucionar në sektorin e energjisë post-socialist; për shkak se, nuk kishte përvojë të mjaftueshme të reformës që mund të ushqente me informacion një ekstrapolim të tillë teorik në atë moment. Sot, megjithatë, me pothuajse dy

dekada të lëna pas të ristrukturimit post-socialist të energjisë, është e vështirë të gjesh një tjetër triadë konceptesh teorike që të ofrojë një përfshirje më të përshtatshme të strukturës komplekse, të larmishme dhe dinamike të zhvillimeve në këtë fushë të transformimit post-socialist. Operacionet e energjisë në të gjithë EQL dhe ish-BS kanë kaluar një ndryshim të jashtëzakonshëm në strukturën teknologjike që i ka drejtuar ata, duke përfshirë ndryshime të thella në kornizat ligjore, strukturat e institucioneve dhe praktikat e vendim-marrjes. Vazhdimësia e trashëgimive të epokës komuniste, të ngulltura në lokalitete të veçanta, ka kufizuar fleksibilitetin shpjegues dhe rritjen e vullit teknologjik të kësaj strukture në lidhje me zbatimin e formulave të standardizuara të ristrukturimit neoliberal, duke prodhuar drejtime zhvillimi dhe trajektore reformash të ndryshme.

Çdo diskutim i rezultateve strukturore të 20 viteve të reformave të energjisë në post-socializëm do të ishte i paplotë pa marrë parasysh çështjet e gjera gjeopolitike në lidhje me përfshirjen e infrastrukturave të energjisë në prodhimin e territorit. Teorizimi i objekteve të tilla si grupe në rrjet mund të sugjerojë që aftësia e tyre vepruese gjeopolitike është e përcaktuar më qartë dhe duket të jetë e dhënë, siç do të argumentojë Weber (1968), në vetë ekzistencën e tyre materiale. Megjithatë, edhe pse është në fakt tepër tërheqëse për ta aplikuar këtë, ose analogjinë e rrjeteve si 'kanale' materiale dhe qarqeve për transmetimin e energjisë Castell (2002), në interpretimet e aftësisë vepruese politike dhe ekonomike të infrastrukturave të rrjetëzuara të energjisë, është e rëndësishme të merret në konsideratë që sisteme të tilla janë gjithashtu shprehjet e marrëdhënieve më të gjera shoqërore dhe të papriturave politike (si në teorinë e Allen, 2003). Kështu, në EQL dhe ish-BS po ashtu, vendimet mbi vendndodhjen dhe madhësinë e infrastrukturave të energjisë janë përfshirë thellësisht në modelet lokale dhe rajonale të zhvillimit ekonomik, në krijimin simbolik dhe përfytyrimin e vendeve, në artikullimin e nocioneve të identitetit kombëtar dhe interesat e sigurisë, dhe zhvillimet gjeopolitike në rajon e më gjerë. Në shumë mënyra, ky konceptualizim i ndikimit politik të grupeve infrastrukturore në sektorin e energjisë është më afër me interpretimin relational të 'përzierjeve' të pushtetit' të dhënë nga, *inter alia*, Sharp et al. (2000).

Si një e tërë, pra, transformimi post-socialist ka destabilizuar marrëdhëniet politike dhe ekonomike ndërkombëtare në rajonin e EQL dhe ish-BS, duke krijuar rrjete të reja të pushtetit përtej kufijve kombëtarë. Duke kanalizuar lidhje të tilla në mënyra të ndryshme materialisht, infrastrukturat e rrjetëzuara të energjisë kanë dhënë një pikë kthese institucionale për negociimin e

marrëdhëniet e gjeopolitike. Nëpërmjet tyre, procesi i reformës në sektorin e energjisë në post-socializëm, përveç krijimit nga dhe përforsimit të pasigurive të vendit, është i implikuar thellësisht në prodhimin politik, ekonomik dhe diskursiv të territorit. Shfaqja e topologjive të reja të pushtetit ka kontribuar në destabilizimin hierarkive skalare dhe kufijve sektoriale, duke ekspozuar pamundësinë e ndarjeve të qarta të shkallëve të proceseve (Latour, 1997, Lemke, 2000) për të kapur kompleksitetin e grupeve hibride në fushën e operacioneve të energjisë. Si të tillë dhe në sajë të dështimeve të rënda infrastrukturore në masë si kriza energjitike e diskutuar në fillim të këtij shkrimi, ajo ka treguar se siguria e energjisë nuk është dhe nuk duhet të jetë një çështje e rregulluar kryesisht nga qeveritë kombëtare. Fuqizimi i një game më të gjerë të institucioneve vendim-marrëse, nga organizatat tek familjet, është e domosdoshme për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme të energjisë.

Falënderime

Stefan Bouzarovski është i njohur edhe si Stefan Buzar. Një pjesë e sfondit të hulumtimit për këtë shkrim është mbështetur nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve të Republikës Çeke (projekti nr. MSM0021620831: 'Sistemet Gjeografike dhe Proceset e Riskut në Kontekstin e Ndryshimit Global dhe Integritimit Evropian'). Një punë shtesë u ndërmor në vazhden e pozicionit të profesorit të jashtëm pranë Institutit të Gjeografisë, Universiteti i Gdansk, Pilsudskiego 46, Gdynia, Poloni. Të gjitha gabimet dhe lëshimet duhet t'i atribuohen vetëm autorit.

Stefan Bouzarovski, Lektor në Gjeografinë Humane, Shkolla e Gjeografisë, Tokës dhe Shkencave Mjedisore, Universiteti i Birminghamit, Edgbaston, Birmingham B15 2TT, MB; Profesor me orare të pjesshme, Departamenti i Gjeografisë Sociale dhe Zhvillimit Rajonal, Fakulteti i Shkencës, Charles University, Albertov 6, 128 43 Prague 2, Republika Çeke

Email: buzars@adf.bham.ac.uk

Referenca

- AEA [Austrian Energy Agency] (2009) 'Energy in Central and Eastern Europe'. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [<http://www.eva.ac.at/enercee/>].
- Allen, J. (2003) *Lost Geographies of Power*. Oxford: Blackwell.

- Anex, R.P. (2002) 'Restructuring and Privatizing Electricity Industries in the Commonwealth of Independent States'. *Energy Policy* 30: 397–408.
- Åslund, A. (2006) 'Russia's Energy Policy: a Framing Comment', *Eurasian Geography and Economics* 47: 321–8.
- Avgerou, C. (2002) *Information Systems and Global Diversity*. Oxford: Oxford University Press.
- *BalkanInsight.com* (2009) 'Serbia Gas Offer Warms Bosnia Homes, Hearts', 12 January. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [balkaninsight.com/en/main/news/15923].
- Barry, A. (2001) *Political Machines: Governing a Technological Society*. London and New York: Athlone Press.
- *BBC News* (2007a) 'Russia Oil Row Hits Europe Supply', 8 January. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [http://news.bbc.co.uk/1/hi/business/6240473.stm].
- *BBC News* (2007b) 'EU Rejects Balkans Nuclear Plea', 13 March. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 at: [http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/6445795.stm].
- *BBC News* (2009) 'Europe Homes Freeze Amid Gas Row', 9 January. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 at: [http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/7819429.stm].
- Belton, C. and Dombey, D. (2007) 'Pipeline Set to Tighten Russian Grip on Energy'. *Financial Times*, 22 May.
- Belyi, A. (2003) 'New Dimensions of Energy Security of the Enlarging EU and Their Impact on Relations with Russia'. *European Integration* 25: 351–69.
- Bennett, J. (2005) 'The Agency of Assemblages and the North American Blackout'. *Public Culture* 17: 445–65.
- Berkhout, F., Smith, A. and Stirling, A. (2004) 'Socio-technological Regimes and Transition Contexts'. In B. Elzen, F.W. Geels and K. Green (eds), *System Innovation and the Transition to Sustainability: Theory, Evidence and Policy* (pp. 48–75). Cheltenham: Edward Elgar.
- Bijker, W. (1993) 'Do Not Despair: There Is Life after Constructivism'. *Science, Technology and Human Values* 18: 113–38.
- Bouzarovski, S. (2009a) 'East-Central Europe's Changing Energy Landscapes: a Place for Geography'. *Area* 41 (4): 452–63. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [http://www3.interscience.wiley.com/journal/122314102/abstract].
- Bouzarovski, S. (2009b) 'Building Events in Inner-city Gdansk, Poland: Exploring the Socio-spatial Construction of Agency in Built Form'. *Environment and Planning D: Society and Space* 27: 840–58.

- Bouzarovski, S. and Konieczny, M. (forthcoming) 'Landscapes of Paradox: Public Discourses and State Policies in Poland's Relationship with the Nord Stream Pipeline'. *Geopolitics*.
- Brendow, K. (2001) 'Privatising and Regulating the Electricity and Gas Industries in Central and Eastern Europe: Models, Status, Issues'. Parë për herë të fundit 10 Qershor 2007 në: [<http://www.worldenergy.org/wec-geis/global/downloads/skopjemanu.pdf>].
- Brendow, K. (2003) 'Restructuring DH/CHP in Central and Eastern Europe: Analysis and Action'. In World Energy Council (ed.), *Towards Local Energy Systems: Revitalising District Heating and Co-Generation in Central and Eastern Europe* (pp. 63–91). London: World Energy Council.
- Brey, P. (2003) 'Theorizing Technology and Modernity'. In T. Misa, P. Brey and P. Feenberg (eds), *Modernity and Technology*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Browning, C.S. (2003) 'The Region-building Approach Revisited: the Continued Othering of Russia in Discourses of Region building in the European North'. *Geopolitics* 8: 45–71.
- Buck, T. and Shahrim, A. (2005) 'The Translation of Corporate Governance Changes across National Cultures: the Case of Germany'. *Journal of International Business Studies* 36: 42–61.
- Buckley, N. and Parker, G. (2007) 'Russia to Cut Use of Energy Transit Countries'. *Financial Times*, 21 January.
- Bulkeley, H. and Betsill, M. (2003) *Cities and Climate Change: Urban Sustainability and Global Environmental Governance*. London and New York: Routledge.
- Buzar, S. (2007) *Energy Poverty in Eastern Europe: Hidden Geographies of Deprivation*. Aldershot: Ashgate.
- Cadili, S. and Whitley, E.A. (2005) 'On the Interpretative Flexibility of Hosted ERP Systems'. *Journal of Strategic Information Systems* 14: 167–95.
- Callon, M. (1986) 'The Sociology of an Actor-network: the Case of the Electric Vehicle'. In - - M. Callon, J. Law and A. Rip (eds), *Mapping the Dynamics of Science and Technology: Sociology of Science in the Real World* (pp. 19–34). London: Macmillan.
- Callon, M. (1992) 'The Dynamics of Techno-economic Networks'. In R. Coombs, P. Saviotti and V. Walsh (eds), *Technological Change and Company Strategy: Economic and Social Perspectives* (pp. 72–102). London and San Diego: Harcourt Brace Jovanovitch.
- Castells, M. (2002) *The Rise of the Network Society. The Information Age: Economy, Society and Culture*. Oxford: Blackwell.

- Castree, N. (2002) 'False Antitheses? Marxism, Nature and Actor-networks'. *Antipode* 34: 111–46.
- Chandler, W. (2000) *Energy and Environment in the Transition Economies: Between Cold War and Global Warming*. Oxford and Boulder, CO: Westview Press.
- Cornillie, J. and Frankhauser, S. (2002) *The Energy Intensity of Transition Countries*. London: European Bank for Reconstruction and Development.
- Crnobrtnja, M. (1991) 'Yugoslavia's Energy Choices and the Economic Dimension'. In J. DeBardleben (ed.), *To Breathe Free: Eastern Europe's Environmental Crisis* (pp. 169–89). Washington, DC, Baltimore, MD, London: Woodrow Wilson Center Press and Johns Hopkins University Press.
- Deleuze, G. and Guattari, F. (1988) *A Thousand Plateaus: Capitalism and Schizophrenia*. London: Athlone Press.
- Dienes, L. and Shabad, T. (1979) *The Soviet Energy System*. New York: V. H. Winston & Sons, Halsted Press.
- Dienes, L., Dobozi, I. and Radetzki, M. (1994) *Energy and Economic Reform in the Former Soviet Union*. London: St. Martin's Press.
- EBRD [European Bank for Reconstruction and Development] (1999) *Energy Operations Policy*. London: EBRD.
- Emerging Europe Oil and Gas Insight (2007) 'Nord Stream Troubles', July.
- Energy Charter (2007) 'About the Charter'. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [<http://www.encharter.org/index.php?id=7>].
- Energy Community Treaty (2009) Energy Community. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY].
- *Eubusiness.com* (2009) 'Nabucco and South Stream: Two Rival Gas Pipelines for Europe', 25 April. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [<http://www.eubusiness.com/news-eu/1240676222.0>].
- *Euractiv.com* (2009) 'Gas Crisis Gives Slovakia Excuse to Restart Nuclear Unit', 12 January. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [<http://www.euractiv.com/en/energy/gas-crisis-gives-slovakia-excuse-restart-nuclear-unit/article-178429>].
- Frankhauser, S. and Tepic, S. (2005) *Can Poor Consumers Pay for Energy and Water?* London: European Bank for Reconstruction and Development.
- Filippini, M., Hrovatin, N. and Zoriè, J. (2004) 'Efficiency and Regulation of the Slovenian Electricity Distribution Companies', *Energy Policy* 32: 335–44.

- Grabher, G. and Stark, D. (1998) 'Organising Diversity: Evolutionary Theory, Network Analysis and Post-socialism'. In J. Pickles and A. Smith (eds), *Theorising Transition: The Political Economy of Post-Communist Transformations* (pp. 54–75). London and New York: Routledge.
- Graham, S. and Marvin, S. (2001) *Splintering Urbanism: Networked Infrastructures, Technological Mobilities, and the Urban Condition*. London and New York: Routledge.
- Gray, D. (1995) *Reforming the Energy Sector in Transition Economies: Selected Experience and Lessons*. Washington, DC: World Bank.
- Hetherington, K. and Law, J. (2000) 'Theme Issue: After Networks'. *Environment and Planning D: Society and Space* 18: 127–32.
- Hughes, G. (1991) 'The Energy Sector and Problems of Energy Policy in Eastern Europe'. *Oxford Review of Economic Policy* 7: 77–98.
- Hughes, T.P. (1993) *Networks of Power: Electrification in Western Society, 1880–1930*. Baltimore, MD: Johns Hopkins University Press.
- Hulpachová, M. (2007) 'RWE Plans New Pipeline: "Gazela" to Import Russian Gas from Line beneath Baltic Sea'. *The Prague Post*, 23 May.
- IEA [International Energy Agency] (2005) *Energy Policies of IEA Countries: The Czech Republic*. Paris: OECD/IEA.
- Jørgensen, P. (2002) 'Challenging Times for the Balkans'. In M. Burdett (ed.), *Central and Eastern Europe and FSU Electricity Prospects for 2002* (pp. 15–16). London: Platts.
- Kazakevicius, E., Schipper, L. and Meyers, S. (1998) 'The Residential Space Heating Problem in Lithuania'. *Energy Policy* 26: 859–72.
- Kennedy, D. (2002) 'Regulatory Reform and Market Development in Power Sectors of Transition Economies: the Case of Kazakhstan'. *Energy Policy* 30: 219–333.
- Klaassen, G., McDonald, A. and Zhao, J. (2001) 'The Future of Gas Infrastructures in Eurasia'. *Energy Policy* 29: 399–413.
- Klare, M.T. (2008) *Rising Powers, Shrinking Planet*. New York: Metropolitan Books.
- Koèenda, E. and Cábeka, S. (1999) 'Liberalization in the Energy Sector in the CEE-Countries: Transition and Growth'. *Osteuropa-Wirtschaft* 44: 104–16.
- Kopaèka, L. (2000) 'Transformation of the Czech Society and Economy and Energy Industry'. *Acta Universitatis Carolinae – Geographica* 29: 39–59.

- Kornai, J. (1986) 'The Soft Budget Constraint', *Kyklos* 39: 3–30.
- Kovaèeviaè, A. (2004) *Stuck in the Past: Energy, Environment and Poverty in Serbia and Montenegro*. Belgrade: United Nations Development Programme.
- Lackó, M. (1997) *Do Power Consumption Data Tell the Story? Electricity Intensity and the Hidden Economy in Post-Socialist Countries*. Luxembourg: International Institute for Applied Systems Analysis.
- Lampiotti, J. and Meyer, A. (2002) *When Heat Is a Luxury: Helping the Urban Poor of Europe and Central Asia Cope with the Cold*. Washington, DC: World Bank.
- Latour, B. (1997) 'On Actor Network Theory: a Few Clarifications'. *Soziale Welt* 47 (4): 367, 369–381.
- Latour, B. (1999) 'On Recalling ANT'. In J. Law and J. Hassard (eds), *Actor Network Theory and After* (pp. 15–25). Oxford: Blackwell.
- Latour, B. (2005) *Reassembling the Social: an Introduction to Actor-Network-Theory*. Oxford: Oxford University Press.
- Laurila, J. (2003) 'Transit Transport between the European Union and Russia in Light of Russian Geopolitics and Economics'. *Emerging Markets Finance and Trade* 39: 27–57.
- Law, J. and Bijker, W.E. (1992) 'Postscript: Technology, Stability, and Social Theory'. In J. - - Law and W.E. Bijker (eds), *Shaping Technology/Building Society: Studies in Sociotechnical Change* (pp. 291–308). Cambridge, MA: MIT Press.
- Lemke, J.L. (2000) 'Material Sign Processes and Emergent Ecosocial Organisation'. In P.B. -Andersen, C. Emmeche, N.O. Finnemann and P.V. Christiansen (eds), *Downward Causation* (pp. 181–213). Aarhus: Aarhus University Press.
- Lewis, R. (1979) *Science and Industrialization in the USSR*. New York: Macmillan.
- McFarlane, C. and Rutherford, J. (2008) 'Political Infrastructures: Governing and Experiencing the Fabric of the City'. *International Journal of Urban and Regional Research* 32: 363–74.
- Mitchell, T. (2008) 'Rethinking Economy'. *Geoforum* 39: 1116–21.
- Monstadt, J. (2007) 'Urban Governance and the Transition of Energy Systems: Institutional Change and Shifting Energy and Climate Policies in Berlin'. *International Journal of Urban and Regional Research* 31: 326–43.
- Murdoch, J. (1998) 'The Spaces of Actor-network Theory'. *Geoforum* 29: 357–74.

- O'Lear, S. (2004) 'Resources and Conflict in the Caspian Sea'. *Geopolitics* 9: 161–86.
- Orlikowski, W.J. (1992) 'The Duality of Technology: Rethinking the Concept of Technology in Organizations'. *Organizational Science* 3: 398–427.
- Pallot, J. and Shaw, D. (1982) *Planning in the Soviet Union*. London: Croom Helm.
- Pavlínek, P. and Pickles, J. (2000) *Environmental Transitions: Transformation and Ecological Defence in Central and Eastern Europe*. London and New York: Routledge.
- PEEE [Platts Energy in East Europe] (2007) 'Jockeying for Position and Power in 2007', 5 January.
- Pickles, J. (2010) 'The Spirit of Post-socialism: Common Spaces and the Production of Diversity'. *European Urban and Regional Studies* 17 (2): 127–40.
- *Radio Free Europe/Radio Liberty* (2009) 'Devil Is in Detail of EU Energy Strategy', 23 April. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në:
[\[http://www.rferl.org/content/EU_Energy_Goals_Appear_Stuck_In_The_Pipeline/1614423.html\]](http://www.rferl.org/content/EU_Energy_Goals_Appear_Stuck_In_The_Pipeline/1614423.html).
- *RedOrbit.com* (2005) 'President Confirms Macedonia's Interest in Bulgarian Nuclear Power Project', 19 December. Parë për herë të fundit 17 Nëntor 2009 në: [\[http://www.redorbit.com/news/science/334519/president_confirms_macedonias_interest_in_bulgarian_nuclear_power_project/\]](http://www.redorbit.com/news/science/334519/president_confirms_macedonias_interest_in_bulgarian_nuclear_power_project/).
- Round, J. and Williams, C. (2010) 'Coping with the Social Costs of "Transition": Everyday Life in Post-Soviet Russia and Ukraine'. *European Urban and Regional Studies* 17 (2): 183–96.
- Routledge, P. (2008) 'Acting in the Network: ANT and the Politics of Generating Associations'. *Environment and Planning D: Society and Space* 26: 119–217.
- Rutland, P. (1997) *Lost Opportunities: Energy and Politics in Russia*. Washington, DC: The National Bureau of Asian Research.
- Sarker, S., Saonee, S. and Sidorova, A. (2006) 'Understanding Business Process Change: an Actor-network Perspective'. *Journal of Management Information Systems* 23: 51–86.
- Sharp, J.P., Routledge, P., Philo, C. and Paddison, R. (2000) 'Entanglements of Power: Geographies of Domination/Resistance'. In J.P. Sharp, P. Routledge, C. Philo and R. -Paddison (eds), *Entanglements of Power: Geographies of Domination/Resistance* (pp. 1–42). London and New York: Routledge.
- Star, S.L. (1999) 'The Ethnography of Infrastructure'. *American Behavioral Scientist* 43: 377–91.

- Stern, J. (2002) *Security of European Natural Gas Supplies: The Impact of Import Dependence and Liberalization*. London: Royal Institute of International Affairs.
- Stern, J. and Davis, J.R. (1998) 'Economic Reform of the Electricity Industries of Central and Eastern Europe'. *Economics of Transition* 6: 427–60.
- Stern, J.P. (1980) *Soviet Natural Gas Development to 1990: the Implications for the CMEA and the West*. Lexington, MA: Lexington Books.
- *UPI.com* (2009) 'Nabucco vs. South Stream', 30 April. Parë për herë të fundit 18 Nëntor 2009 në: [http://www.upi.com/Energy_Resources/2009/04/30/Nabucco-vs-South-Stream/UPI-97671241097194/].
- Üрге-Vorsatz, D., Miladinova, G. and Paizs, L. (2006) 'Energy in Transition: From the Iron Curtain to the European Union'. *Energy Policy* 34: 2279–97.
- Velody, M., Cain, M.J.G. and Philips, M. (2003) *A Regional Review of Social Safety Net Approaches in Support of Energy Sector Reform*. Washington, DC: US Agency for International Development.
- Von Hirschhausen, C. and Wälde, T.W. (2001) 'The End of Transition: an Institutional Interpretation of Energy Sector Reform in Eastern Europe and the CIS'. *MOCT-MOST: Economic Policy in Transitional Economies* 11: 93–110.
- Waller, M. (1998) 'Geopolitics and the Environment in Eastern Europe'. *Environmental Politics* 7: 29–52.
- Weber, M. (1968) *Economy and Society: an Outline of Interpretive Sociology*. New York: Bedminster Press.
- Westphal, K. (2006) 'Energy Policy between Multilateral Governance and Geopolitics: Whither Europe?' *International Politics and Society* 2006: 44–62.
- World Bank (1999) *Privatization of the Power and Natural Gas Industries in Hungary and Kazakhstan*. Washington, DC: World Bank.
- Yergin, D. (2006) 'Ensuring Energy Security'. *Foreign Affairs* 85: 69–82.

CSIS-EKEM - Raporti i Politikës¹**RILIDHJA E BALLKANIT PERËNDIMOR:
DIMENSIONI I ENERGIJISË***Shtator 2010*

Rajoni i Ballkanit Perëndimor përbëhet nga Shqipëria dhe ish shtetet e Jugosllavisë (Bosnja-Hercegovina, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova). Kosova shpalli pavarësinë nga Jugosllavia në shkurt të 2008. Që nga ajo kohë, është njohur nga 70 shtete, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pesë shtete anëtare të Bashkimit European, nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Luftërat e njëpasnjëshme të Jugosllavisë që dominuan zhvillimin ekonomik dhe politik të Europës Juglindore gjatë dekadës së parë të pas-Luftës së Ftohtë, kanë ndikuar negativisht mbi industrinë e energjitike dhe infrastrukturën e shumë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Vetëm pas vendosjes së Traktatit të Komunitetit të Energjisë në vitin 2005, u krijua një kuadër rregullator i fuqishëm për të trajektuar ekonominë e rajonit sipas normave të transparencës dhe liberalizimit të Bashkimit European në mënyrë që rajoni i Ballkanit Perëndimor të përgatitej për një hyrje masive të Investimeve Direkte të Huaja, të cilat do të mund të ringjallnin infrastrukturën energjitike dhe të përdornin në mënyrë më të efektshme burimet energjitike të çdo shteti.

Ndonëse Bashkimi European dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida të njëjta: si ajo e rritjes së efikasitetit të energjisë, reduktimi i varësisë nga importi dhe rritja e burimeve të rinovueshme energjitike (BRE), gjendja aktuale e marrëdhënieve

¹ Ky raport politik i Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) dhe Qendres Greke për Studimet Europiane (EKEM) është projektuar për të dhënë rekomandime konkrete dhe të fokusuara për një qasje të rëndësishme politike të SHBA-Greqisë në drejtim të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Me këtë qëllim, CSIS dhe EKEM themeluan një Task Forcë të përbashkët në nëntor 2009, e përbërë nga dy grupe pune, një me bazë në Ëashington, DC, dhe tjetra në Athinë. Task Forca mbledh ekspertët e politikës së të dy vendeve që do të ndihmojnë në formulimin e rekomandimeve të politikave të bazuara në çështje të rëndësishme me të cilat përballet rajoni i Ballkanit Perëndimor.

në rajon është e papërshtatshme ose nën-standarde, me përjashtimin të Kroacisë, e cila ka avancuar në mënyrë të dukshme me harmonizimin e legjislacionit dhe politikave të saj me *acquis communautaire*. Shtetet e Ballkanit Perëndimor ndodhen në pozita të ndryshme në rrugën e gjatë të integritit në Bashkimin Europian dhe secila prej tyre ka qëllime dhe standarde të ndryshme mjedisore dhe energjitike. Ecuria e përshtatjes brenda për brenda rajonit, me praktikën dhe legjislacionin e BE-së, sidomos në nivelin e liberalizimit dhe ndërlikohet së tregut të gazit dhe energjisë elektrike dhe transformimet rregullatore të tregut, lë shumë për të dëshiruar.

Sfidat

Ka ndryshime të theksuara midis shtatë shteteve dhe entiteteve shtetërore që përbëjnë Ballkanin Perëndimor në lidhje me përzjerjen e tyre energjitike, modeleve të konsumimit dhe nivelin e potencialit të burimeve. Në të njëjtën kohë, zona në tërësi përballlet me shumë sfida të përbashkëta energjitike. Këto përfshijnë një mbi-varësi të përdorimit të naftës dhe qymyrgurit në gjenerimin e energjisë elektrike, e cila ka gjithashtu një impakt negativ mjedisor; varësi të lartë nga importi i naftës dhe gazit të cilat duhet të plotësojnë nevojat e brendshme; një mungesë e theksuar e efikasitetit energjistik; nën-zhvillimi i sektorit të energjisë së rinovueshme; mungesë e integritit të tregut; dhe mungesë e interkonjektorëve përmes rajonit.

Mbi –varësi në Konsumimin e Naftës.

Ndryshe nga modeli të BE-së të konsumit mesatar të energjisë, që tregon një reduktim të qëndrueshëm të përdorimit të naftës dhe të qymyrit në kurriz të gazit natyror, energjisë nukleare dhe rinovuese, Ballkani Perëndimor po shkon në një drejtim krejt të kundërt. Që prej vitit 2000, konsumimi i naftës dhe produkteve të saj është rritur me një diferencë prej 7% në pothuajse 8 vite, duke u llogaritur në 35.5% të Furnizimit Primar Total të Energjisë (FPTE) në 2007, krahasuar me 28.4 % në vitin 2000. Në mënyrë të ngjashme përdorimi i cilësisë së ulët të qymyrit të ngurtë dhe linjtit që dominon gjenerimin e përzjer të energjisë elektrike të rajonit, gjithashtu dhe sektorë të tjerë kërkues të energjisë (si p.sh konsumi industrial dhe shtëpiak), vazhdon të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së BE-së, prej 17%. Burimet e qymyrit/linjtit, të cilat janë kryesisht indigjene, mbulojnë rreth 38% të FPTE në vitin 2007 (nga 42 % në 2000).

Ballkani Perëndimor së bashku me Poloninë, Bullgarinë, Estoninë dhe Republikën Çeke, është i vetmi rajon evropian ku qymyri zë një masë më të lartë të FPTE se nafta, një situatë e cila ka ndryshuar pothuajse për këdo në Europë që në fund të viteve 1950 dhe në fillim të viteve 1960, kur importet masive të naftës së Lindjes së Mesme i dhanë fund varësisë së ekonomive europiane nga nafta vendase. Rajoni duhet të bëjë akoma kalimin në një ekonomi jo të bazuar në linjite duke i zëvendësuar ato me gaz natyror dhe burime të rinovueshme.

Askund nuk është efekti negativ i mbi-përdorimit të qymyrit më i dukshëm se në sektorin energjisë elektrike. Në Serbi, qymyri zë rreth 40% të kërkesës rajonale dhe qymyr/linjiti zë mbi 60% të prodhimit, ndërsa qymyri dominonte pothuajse plotësisht prodhimin mikës të energjisë elektrike në Kosovë (100%) dhe në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (80%). Qymyri zë gjithashtu 20% të furnizimit me energji elektrike në Kroaci dhe Mal të Zi dhe pothuajse 60% të prodhimit të energjisë elektrike në Bosnjë. Vetëm Shqipëria nuk përdor qymyrin, duke prodhuar të gjithë energjinë elektrike me anë të tre impianteve të mëdha hidroelektrike që u ndërtuan gjatë viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1980 (të cilat kanë shumë nevojë për mirëmbajtje).

Varësia e importit të Gazit Natyror: Rasti është i ndryshëm, kur është fjala për importin e gazit, ku rajoni është pothuajse tërësisht i varur nga eksportet ruse të cilat dërgohen në Kroaci, Serbi, dhe Bosnjë-Hercegovinë me anë të një tubacioni gazsjellës të epokës sovjetike nëpërmjet Hungarisë. Gazi natyror zë një pjesë të vogël por shumë të rëndësishëm të konsumit energjistik final të rajonit, që do të duhet të rritet në mënyrë treguese për të kufizuar mbi-shfrytëzimin e qymyrit në prodhimin e energjisë elektrike dhe përdorimeve industriale. Për fat të keq, përveç Kroacisë, e cila prodhon 60% të nevojave të saj të gazit, vetëm Serbia ka një sasi të kufizuar të rezervave vendase që ende llogariten të përbëjnë më pak se 7 % të konsumit. Bosnjë-Hercegovina dhe FYROM konsumojnë vetëm gazin rus që kalohet transit nëpërmjet Serbisë, kurse Kosova dhe Mali i Zi nuk përdorin asnjë gaz natyror. Shqipëria konsumon sasi të papërfillshme të gazit natyror (më pak se 0.6 për qind të FPTE) që ajo prodhon vetë. Nga i gjithë rajoni vetëm Serbia dhe Kroacia kanë një treg të mirëfilltë të gazit natyror dhe një kornizë relativisht të qëndrueshme rregullative. Kroacia është konsumatorja më e lartë e gazit në rajon, e ndjekur nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.

Rreziqet e mbi-varësisë nga një burim të vetëm furnizimi u theksua në rajon gjatë krizës më të madhe që Europa ka kaluar

që nga embargo arabe e naftës dhe Revolucioni Iranian i viteve 1970; kriza Ukrainase-Ruse e gazit në janar të 2009. Më 6 janar të 2009, vetëm 10% e eksporteve normale të gazit dërgoheshin, me atë të pikave kryesore të hyrjes së tubacionit, në Sllovaki, të cilat më pas do të dërgoheshin nëpërmjet Hungarisë perëndimore dhe Sllovenisë për në Kroaci. Hungaria lindore, pika transite për në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë, mori vetëm 20% të volumeve normale.

Më 7 janar të 2009, të gjitha eksportet tregtare të gazit u rënduan, duke i lënë konsumatorët e Ballkanit Perëndimor pa importe gazi. Nga shtetet e prekura, vetëm Kroacia ishte në gjendje të përballej me pasojat e krizës duke rritur menjëherë prodhimin e saj, gjithashtu duke ndërhyrë në disa eksporte nga pajisjet strategjike gjermane të akumulimit të gazit, të cilat transportoheshin për në Kroaci nga Sllovenia. Serbia gjithashtu iu drejtua kapacitetit të saj të limituar të gazit, por kjo pati një efekt të papërfillshëm në aftësinë e shtetit për tu përballur me krizën.

Vetëm pas 16 janarit të 2009 erdhi një lloj lehtësimi nga rezervat strategjike të Hungarisë, të cilat arritën vetëm Sarajevën dhe pjesët lindore të Republikës Srpska. Më në fund, Serbia iu drejtua përdorimit masiv të ligniteve dhe të naftës për të kompensuar pjesën më të madhe të pamjaftueshmërisë.

Varësia e lartë e importit të naftës dhe diversifikimi i kufizuar i burimeve dhe rrugëve të importit: Një kufizim tjetër i madh negativ i zhvillimit energjitik të rajonit është varësia shumë e madhe e rritjes të importit të hidrokarbureve. Potenciali i burimeve të naftës dhe gazit në rajon është shumë i kufizuar. Vetëm Kroacia dhe Serbia prodhojnë sasi të mëdha të naftës- aq sa për të mbuluar rreth 20% të konsumimit të tyre. Edhe pse Shqipëria nuk importon naftë të papërpunuar, prodhimi i saj mbulon vetëm 24% të nevojave të saj përfundimtare të lëndëve djegëse.

Serbia dhe Kroacia mbahen edhe për instalimet më të mëdha të rafinerisë në rajon, që eksportojnë sasi të konsiderueshme të produkteve të naftës në Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi, ndërsa Shqipëria furnizon Kosovën, dhe Greqia - nëpërmjet naftës-jellësit të produkteve të naftës HELPE (Hellenic Petroleum), në pronësi të Selanik-Shkup- mbulon shumicën e nevojave të FYROM, si dhe një pjesë në rritje të tregut Serbisë jugore (duke përfshirë edhe pjesë të Kosovës). Bosnjë-Hercegovina merr 100% të importeve të saj të naftës së papërpunuar nga Rusia. Rusia furnizon pothuajse dy të tretat e totalit të importeve në Serbi, Kroaci, dhe Maqedoni. Kosova dhe Mali i Zi nuk kanë prodhim nafte dhe janë krejtësisht të varura nga produktet e lëndës djegëse të naftës nga Serbia, Shqipëria dhe Greqia. Në

përgjithësi rajoni gëzon një nivel të mjaftueshëm të shumëllojshmërisë importuese duke qenë se furnizohet me naftë të papërpunuar nga Libia, Algjeria, Egjipti dhe Gjiri Persik.

Efikasiteti i Energjisë: Sfida e katërt e madhe e përbashkët për integrimin e ardhshëm të rajonit në çështjen e energjisë është mangësia e madhe në modelet e konsumit të energjisë. Rajoni mban të dhëna me normat e efikasitetit më të këqija të Evropës në lidhje me shfrytëzimin e energjisë dhe të konsumit që janë 2,5 herë më të ulëta se mesatarja e OECD-së (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik). Efikasiteti i sistemeve të prodhimit dhe konsumit të energjisë varion nga aq ulët sa 50 % në Kosovë në 80 % në Kroaci. Kroacia është një nga vendet me më pak të meta në shtetet rajonale, por ende mund të kursente deri në 25 % të konsumit total të energjisë. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë vë në dukje në raportin e saj të vitit 2008 *'Energjia në Ballkanin Perëndimor': Rruga drejt reformës dhe rindërtimit'* se duke ekstrapoluar nivele te tilla në të gjithë rajonin do të kurseheshin rreth 5 Milion Ton të Ekuivalentit të Naftës (MTEN), e cila është ekuivalente me importet vjetore të naftës dhe gazit bashkë të Serbisë. Reduktimi i humbjeve në rrjetet e larta (rreth 22 për qind e konsumit përfundimtar të energjisë elektrike) është një tjetër burim i rëndësishëm i kursimit të energjisë. Rajon mund të ruajë një shtesë prej 5 trilion Watt orë në vit duke i sjellë këto humbje në nivelet e Kroacisë (performuesja më e mirë në rajon), e cila ka një humbje prej 14 për qind të konsumit total final.

Burimet Energjitike të Ripërtërishme: Sfida e pestë kryesore me të cilën po përballet rajoni është nën-investimi dhe nën-shfrytëzimi i Potencialit të Energjisë së Ripërtërishme të zonës. Progres-Raportet e fundit për aderim, të Komisionit European për secilin prej shteteve të Ballkanit Perëndimor nuk lënë shumë vend për optimizëm. Nuk ka pasur progres të spikatur në fushën e promovimit të aplikimeve efikase energjitike në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, apo Serbi, ndërkaq vetëm hapa të kufizuara janë bërë në rastin e Malit të Zi dhe FYROM. Vetëm në Kroaci, e cila ka përfunduar në mënyrë efektive procesin e pranimit të saj, ka pasur ndryshime të madh pozitive. FYROM dhe Shqipëria kanë prezantuar legjisllacionin që mbështet masa efikase energjitike, por shumë pak është bërë në këtë drejtim. Komuniteti i Energjisë duhet të marre iniciativën dhe të bëjë thirrje që të vendosen dhe të ndiqen objektiva vullnetare nga çdo shtet, të shoqëruara me krijimin e një kuadri financiar për Burimet Energjitike të Ripërtërishme në rajon (që do të mbështetet nga institucionet financiare të BE-së në kuadrin e fondeve të para-

aderimit). Vetëm në Shqipëri dhe FYROM ekziston një promovim i koordinuar i investimeve të BER. Në përgjithësi, gjithsesi, potenciali BER i rajonit mbetet kryesisht i pashfrytëzuar.

Tregu i Integritimit: Në përgjithësi, që nga shpërbërja e Jugosllavisë ka pasur një integrim shumë të pakët të tregut në rajon. Në lidhje me volumet e shkëmbyera, niveli i tregtisë ka rënë në mënyrë të konsiderueshme, pavarësisht nga privatizimi i pjesshëm i INA (Kompania Kombëtare Kroate e Naftës) nga kompania e naftës dhe gazit Hungarez MOL dhe kontrollit tregtar të infrastrukturës së naftës të FYROM nga Petroleumi Grek (Hellenic Petroleum). Sistemi i naftësjetllësit Adria, që është në bashkë-pronësi të kroatëve (JANAF) dhe operatorëve serb të tubacionit të naftës (Nafta), është arteria e vetme e importit të naftës së papërpunuar në rajon që furnizon me naftë bruto çdo instalim rafinerie që operon në rajon, me përjashtim të FYROM dhe Shqipërisë. Tregu Serb i naftës nuk mund të mbijetojë pa linjën JANAF, dhe pikërisht për këtë arsye Serbia heziton ta ndryshojë drejtimin e naftësjetllësit nga Perëndim-në-Lindje para se komponentët rumuno-serb të Naftësjetllësit Pan-European Konstanca-Trieste (EOP) të jenë në veprim të plotë.

Sistemi Adria, që nuk shtrihet në Slloveni, ka një kapacitet teknik operativ prej 680.000 fuçi në ditë (f/d), por kurrë nuk e ka kaluar një normë shfrytëzimi prej 400.000 bpd. Ka plane për të zgjeruar linjën në Slloveni si pjesë e projektit Konstanca-Trieste PEOP, por nuk ka pasur progres, dhe nuk ka gjasa se do të ketë ndonjë lëvizje në këtë drejtim, pavarësisht sistemit PEOP. Një degë e rëndësishme e naftësjetllësit lidh Kroacinë me Hungarinë. Në vitet 1990 pjesa hungareze e Adria ishte propozuar si rrugë anësore tjetër e Bosforit, por për shkak të kapacitetit të limituar të xhiros prej 150.00 në 300.00 f/d dhe shpenzimit të lartë të ndërtimit dhe modernizimit (400 milion €), kjo ide ishte e jopopullore (veçanërisht në anën kroate) dhe nuk avancoi. Tubacioni u dëmtua gjatë luftërave të viteve 1991-1995 dhe u çmontua në vitin 2000 kur filloi të veprojë me 1/3 e kapacitetit të saj. Nga viti 2005 eksportonte vetëm 80.000 f/d në Kroaci dhe 60.00 f/d në Serbi.

I vetmi projekt tjetër naftësjetllës i madh është naftësjetllësi i produkteve të naftës së Selanik-Shkup që u autorizua në 2001. Naftësjetllësi i cili është në pronësi të Hellenic Petroleum, lidh Selanikun me rafinerinë OKTA të epokës sovjetike, pranë Shkupit. Naftësjetllësi ka një kapacitet teknik eksportues prej 50.000 f/d por aktualisht eksporton vetëm 16.000 f/d. Për këtë arsye në vitin 2007, Hellenic Petroleum filloi ndërtimin e një zgjatimi prej 60 km të naftësjetllësit të Shkupit me qëllim për të rritur eksportimet e lëndëve djegëse dhe të naftës në Prishtinë dhe në Nish.

Që në vitet 1970, niveli i integritit të tregut, në terma relativë dhe absolutë, ka rënë ndjeshëm, sidomos pas ri-autorizimit të Adrias në vitin 2000. Me përjashtim të produkteve të naftës të Hellenic Petroleum, të cilat lëvizin nëpërmjet naftës-jellësit që lidh Selanikun me Shkupin, nuk ka pasur investime të mëdha të naftës në rajon, që nga shpërbërja e Jugosllavisë. Naftës-jellësit e Adriatikut dhe të Selanik-Shkupit funksionojnë me rreth 1/3 e kapaciteteve të tyre operacionale, ndërsa pjesa më e madhe e rafinerive, pas shume viteve pa investime, punojnë me rreth 43,5 % të prodhimit të tyre teknik.

Ndërlidhjet e Gazit: Mungesa e ndërlidhjeve të gazit është e dëmshme për qëllimet e integritit të tregut dhe diversifikimit të importit. Në rast të një krizë në të ardhmen, Serbia nuk mund të përfitojë nga rritja e prodhimit të gazit kroat apo rritja e importeve të gazit natyror nga Austria ose terminali i ardhshëm LNG në Krk (në ndërtim e sipër), vetëm nëse ka një interkonektor të gazit kroat-serb që mund të shtrihet në Bosnjë-Hercegovinë. Nuk ka pasur investime në infrastrukturën e gazit natyror në rajon për mbi 30 vjet. I vetmi tubacion i ri (në proces përfundimi) është një interkonektor nga Kroacia për në Hungari që mund të lidhet në të ardhmen me pajisjen LNG Krk, qëllimi kryesor i të cilit do të ishte rritja e diversifikimit të importit Hungarez vis-a-vis Ruisë. Për më tepër, gjendet një kapacitet i kufizuar i magazinimit të gazit në Serbi dhe në Kroaci.

Për arsye se nuk ka ndërlidhje mes dy konsumatorëve kryesorë të gazit të rajonit dhe për shkak se nuk ka plane për të lidhur të dyja projektet e Nabucco dhe Ndërlidhësin Turqi-Greqi-Itali (ITGI) me ndonjë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, Serbia ka vendosur të bashkohet me projektin italiano-rus të South Stream (Rrymës Jugore). Beogradi ka në plan të siguroj importet e gazit në të ardhmen, duke rindërtuar dhe zgjeruar pajisjet strategjike të akumulimit të gazit në Banatski Dvor. Kjo aleancë serbo-ruse është ilustruar nga një shumicë (51% të aksioneve) blerjeje në 2008 të Kompanisë shtetërore Serbe të naftës së dhe gazit N.I.S. nga Gazprom, i cili ishte shumë i ndikuar nga izolimi diplomatik i Serbisë nga Perëndimi lidhur me çështjen e Kosovës.

Meqenëse nuk ka plane aktuale për të lidhur direkt naftës-jellësin Nabucco me vendet e Ballkanit Perëndimor, disa ekspertë besojnë se projekti Rryma e Jugut është një sipërmarrje e mundshme që mund të ndikojë pozitivisht në barazimin e sigurisë energjitike në rajon, në krahasim me projekte të naftës-jellësve të tjerë rajonal, të tilla si naftës-jellësi Trans-Adriatik / Jon-Adriatik (TAP / IAP) dhe i ashtuquajtur i naftës-jellësi i Gazit Natyror të Ballkani Perëndimor. Unaza e Gazit Natyror të Ballkanit Perëndimor, një ide e nxitur fillimisht nga Bota e Turqisë dhe

DEPA e Greqisë në 2003, është braktisur për shkak të pjesëmarrjes greke dhe turke në projektet Nabucco dhe / apo ITGI. TAP është një projekt që synon kryesisht eksportimin e gazit në Itali, dhe jo në Ballkanin Perëndimor. Projektet e konsorciumit për një stacion L.N.G. në Vlorë janë lënë mënjanë, pasi Kroacia vendosi përpara projektin e saj Krk dhe pasi Edison autorizoi kapacitetin e saj 8 bcm/y njësi LNG në Rovigo, i cila ndodhet në jug të Venecias.

Vizioni shtesë i TAP për tu zgjeruar drejt tregjeve të Ballkanit Perëndimor, si projekti i IAP gjithashtu humbi rrjedhë duke ndjekur pas planet e Kroacisë për LNG Krk. Sidoqoftë, IAP nuk do të ishte zbatuar para 2015 para se kapaciteti 10 BCM/ i linjës TAP do të kalonte transitin iranian dhe azerian në Itali, pasi kalimit më parë në Turqi, Greqi, dhe Shqipëri. Realizimi i TAP është edhe më i dyshimtë në krahasim me Nabucco dhe ITGI duke qenë se: 1) kontrata e saj e vetme e sigurimit të furnizimit me gaz vjen nga Kompania Kombëtare e Eksportit të Gazit Iranian (NIGEC) përmes një kontrate furnizimi e nënshkruar nga EGL në vitin 2008, 2) nuk ka marrëveshje rregullatore të tranzitit në fuqi as me Turqinë e as me Greqinë; 3) është drejtpërdrejt në kundërshtim me projektet e Nabucco dhe ITGI për aksesin në rezervat e Azerbajxhanit, burimi i vetëm afatmesëm i gazit jo-rus për tregjet e BE-së, dhe 4) BE-ja vendosi sanksione ndaj Iranit në korrik 2010, të cilat e bëjnë më të vështirë transitin e gazit iranian.

Të gjitha këto sfida të përbashkëta e përkeqësojnë problemin e varfërisë energjitike, e cila prek 16 % të popullatës së rajonit. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, në raportin e saj të vitit 2008 *Energjia në Ballkanin Perëndimor / Rruga drejt Reformës dhe Rindërtimit* e përkufizon mungesën e energjisë si “gjendjen ku shumë breza popullsie të një vendi kanë akses të pamjaftueshëm në furnizimin me energji, duke vuajtur në veçanti nga një akses i paqëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm i elektricitetit, i cili nuk do ti lejonte ato të kryenin nevojat e tyre bazë shtëpiake”. Kjo gjendje sjell gjithashtu përdorim të paefektshëm të energjisë. Gjithsesi, pavarësisht një dekade lufte e cila dëmtoi pjesën më të madhe të infrastrukturës energjitike të rajonit, vetëm 16% e popullsisë përballlet me mungesën e furnizimit që mund të klasifikohet nën kategorinë e varfërisë energjitike. Është e rëndësishme të theksohet se varfëria energjitike është më e ulët se përqindja e popullsisë që jeton poshtë vijës së varfërisë (18.21%). Pragu i vijës së varfërisë varion sipas vendeve, me Kosovën e cila ka pjesën më të madhe {37% e popullsisë që fiton me pak se 40 euro në muaj} dhe Serbinë dhe Kroacinë me përqindjen më të ulët {11%}.

Mundësi: Integrimi European

Perspektiva e Integritit European ka ofruar një masë të stabilitetit politik, i cili u rrit më pas nga prezenca e policisë Europiane dhe forcave të sigurisë në Bosnjë dhe Kosovë. Sektori i energjisë: shtylla e zhvillimit ekonomik dhe integritit politik në të gjithë rajonin- është simbolikë e tranzicionit nga një lojë me shumë-zero në një mentalitet fitues-fitues. Ndikimi institucional i BE-së e ka transformuar gjeopolitikën energjitike në një faktor kontribuues në stabilitetin politik dhe integrimin ekonomik.

Qëllimi përfundimtar i Traktatit të Komunitetit të Energjisë është që të arrijë për të gjithë tregjet europiane të energjisë, një nivel të caktuar pjekurie rregullatore, investimi dhe liberalizimi që të “përbëjnë politikën e energjisë së BE-së, Politika e Energjisë e Evropës”. Sipas Komisionit Evropian, kjo mund të arrihet, duke nxitur, nëpërmjet zbatimit të Acquis për Energjisë, tre objektivat prioritare paralele: 1) krijimin e një hapësire rregullative dhe një kornize tregu të vetme dhe të qëndrueshme; 2) zhvillimin e konkurrencës së tregut të energjisë në një shkallë më të gjerë gjeografike, dhe 3) rritjen e sigurisë së furnizimit brenda kësaj hapësirë të vetme rregullatore. Për më tepër, zbatimi i këtyre projekteve është në përputhje me qëllimet e Strategjisë së Korridorit të Gazit Jugor të BE-së për sigurinë e furnizimeve të saj me gaz.

Integrimi i energjisë dhe tregut të energjisë kanë luajtur tashmë një rol të rëndësishëm në afrimin e rajonit më pranë Europës. Nuk është e rastësishme që ideja e një Komuniteti të Energjisë i parapriu vendimit të Këshillit të Selanikut për Ballkanin Perëndimor në qershor 2003. Në 2005 Procesi i Athinës u përmirësua në Organizatën Komunitetit të Energjisë (ECTO) me sekretariatit e tij me qendër në Vjenë. ECTO është i përbërë nga gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor, të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si dhe Kosova. Organizata ka luajtur një rol të madh në lehtësimin e pranimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në BE, si dhe në shpejtësinë për negociatat e anëtarësimit të Kroacisë. Në këtë drejtim ECTO ka vepruar si pararendës por edhe lehtësues për integrimin në BE, edhe pse funksioni primar, sipas Planit të Veprimit të Sigurimit Energjitik dhe Solidaritetit i BE-së i vitit 2008, është të ndërtojë “një treg të integruar në Evropën Juglindore i ankoruar me BE-në” duke përfshirë “tregun e brendshëm dhe legjisllacionin për sigurinë e furnizimit me elektricitet dhe gaz.”

Në mars të vitit 2007, Bashkimi Evropian miratoi një strategji të re energjitike -Iniciativa-20-20-20- për të reduktuar emetimet e CO2 nëpërmjet programeve të efikasitetit të energjisë dhe për të rritur futjen e burimeve energjitike të rinovueshme në përzierjet

energjitike europiane. Kjo iniciativë është e fokusuar në “reduktimin e emisioneve të gazit me 20%, duke rritur pjesën e burimeve ripërtëritëse në konsumin e energjisë në 20% krahasuar me 8,5% e sotshëm dhe përmirësimin e efikasitetit energjistik me 20%, të gjitha deri në vitin 2020.”

Megjithatë, edhe në qoftë se ky plan afat-gjatë është zbatuar në letër, varësia Europiane nga importi neto do të rritet me shpejtësi. Sipas Studimit Botëror të Energjisë mbi trendet aktuale, varësia e BE-së nga energjia e importuar do të rritet nga 54% në vitin 2008 në pothuajse 70% në vitin 2030. Varësia nga importi i naftës pritet të rritet nga 76% në vitin 2007, në 94% deri në vitin 2030. Në rastin e gazit natyror dinamikat e parashikuara janë edhe më kërcënuese. Importet janë llogaritur të vlejë më shumë se 80% e kërkesës së parashikuar për 2030 krahasuar me rreth 60% në vitin 2007.

Politika/nisma legjislative e dytë e madhe e BE-së filloi në nëntor 2008 me anë të publikimit të *Rishikimit Strategjik të Dytë të Energjisë: Një Plan Veprimi i BE-së për Sigurinë Energjitike dhe Solidaritetin*. Ky dokument i rëndësishëm i politikës, i cili u miratua nga Këshilli i Europës më 10 dhjetor 2008, fokusohet në masat që duhet të miratohen në mënyrë për tu përballur me zgjerimin e varësisë afatgjatë së importit të BE-së. Plani paraqet gjashtë prioritetet kryesore: 1) rritja e ndërlidhjes së naftës, gazit dhe energjisë elektrike të BE-së; 2) zgjerimin e diversifikimit të burimeve dhe rrugëve të saj të furnizimit; 3) koordinim më i mirë dhe rritja e efektivitetit të naftës strategjike dhe rezervave të gazit; 4) zbatimi i një plani strategjik për rritjen e efikasitetit të energjisë 5) përqendrimi më i madh në çështjet e energjisë në Politikën e Jashtme të Përbashkët që po shfaqet në BE, veçanërisht brenda kuadrit të shteteve eksportuese (Rusia, OPEC) dhe transitore (Ukraina), dhe 6) të maksimizoj përdorimin e qymyrit vendas, naftës, gazit dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë të Europës.

Në mënyrë që të përshpejtojë zbatimin e këtyre qëllimeve, në mars 2009, Këshilli Evropian miratoi një vendim për të financuar një sërë projektesh që kryesisht u përqendruan në arritjen e dy qëllimeve të BE-së dhe të Planit të Veprimit të Sigurisë Energjitike dhe Solidaritetit. I ashtuquajtur Programi Evropian i Energjisë për Rimëkëmbje (EERP) ka shënuar 4 miliardë • që do të mbulojnë deri në një të tretën e shpenzimeve totale të investimeve për ndërtimin e projekteve për inovacione energjitike dhe infrastrukturore në tri fusha të mëdha të energjisë: 1) inter-konektorë të gazit dhe energjisë elektrike, duke përfshirë grumbullimin e gazit, 2) zhvillimi i energjisë së detit/erës dhe 3) vendosja komerciale e teknologjive të Kapjes dhe Ruajtjes së Karbonit (CCS). Kriza ruso-ukrainase e gazit e janarit 2009

Ilogaritet me faktin që pothuajse një e treta e të gjithë buxhetit është destinuar për projekte lidhur me gazin natyror. Në përgjithësi, projektet për interkoneksionin arritën në 52.5 % të fondeve.

Siguria energjitike për shtetet e Ballkanit Perëndimor, dhe Evropën Juglindore në tërësi, është e prekur nga dy konsiderata kryesore: 1) se sigurimi i furnizimit me energji është arritur kryesisht nëpërmjet strategjive të diversifikimit të importit të naftës dhe gazit siç është përfuruar nga zhvillimi deri tani i vakët i burimeve vendase të hidrokarbureve, dhe 2) përdorimi gjeopolitik i pjesëmarrjes së secilit vend në projektet e mëdha të naftës dhe të infrastrukturës së gazit që lidh disa lojtarë rajonalë. Projektet energjitike mega-infrastrukturore mund të veprojnë si katalizator për pajtimin politik dhe afrimin midis Lindjes dhe pjesëve perëndimore të Ballkanit duke krijuar lidhje të fuqishme me interes të përbashkët. Këto projekte krijojnë marrëdhënie ekonomike dhe politike të bashkë-varësisë që përshpejtojnë integrimin rajonal dhe liberalizimin e tregjeve energjitike -një objektiv kryesor i BE-së –jo, vetëm midis shteteve rajonale, por edhe midis vet shteteve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian.

Rekomandimet e Politikave

- Zbatimi i plotë i Direktivës së dytë BE-së të Tregut të Gazit dhe Elektricitetit që bën thirrje për ndarjen e plotë të prodhuesve nga operatorët e sistemit dhe rolin e fuqishëm të Autoritetit Rregullator të Energjisë në mbikëqyrjen e hapjen e tregut.

- Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të zbatojnë rregullat transparente për investime dhe tregti brenda sektorit të energjisë

Nafta

- Promovimi i mbështetjes për përpjekjet e Hellenic Petroleum që të shtrij produktet e naftës-jellësit të naftës Selanik-Shkup në Prishtinë dhe Nish, nga institucionet e përshtatshme të BE-së dhe Komunitetit të Energjisë, duke e njohur atë si një projekt prioritar për integrimin e tregut të naftës në rajon.

- Mbështetja e financimit të një studimi fizibiliteti duke bërë thirrje për ndërtimin e një tubacioni naftë serbo-kroate që do të operoj në mënyrë të pavarur nga sistemi Adria pavarësisht nga projekti Konstanca-Trieste.

- Dhënie e graveve financiare për ndërtimin e linjës së produkteve të lëndëve djegëse shqiptaro-kosovare që mund të

zgjerohet deri në Malin e Zi, duke i ofruar ekonomive më të dobëta të rajonit diversifikim shtesë të importit. Përqendrim në rehabilitimin gradual të rafinerive të naftës.

Gazit natyror

- Ndërtimi i një rrjedhë të kundërt të ndërlidhësit kroato-serb të gazit.
- Mbështetja e përfundimit në kohë të interkoneksionit të rrjedhës së kundërt bullgaro-serbe që të dy vendet vendosën për të promovuar në mars 2010.
- Lehtësimi i financimit të studimeve të fizibilitetit për ndërlidhjen e mundshme të sistemeve të tubacionit serb dhe kroat me projektin Nabucco në mënyrë që të rritet diversifikimin i importit për këto vende.
- Lehtësimi i përfundimit të studimit të fizibilitetit për ndërtimin potencial të një interkoneksioni të gazit serbo-rumune që do të ndihmojë Serbinë (dhe, pas zgjerimit, Bosnjë-Hercegovinën) në rast të një tjetër krizë të madhe të furnizimit pavarësisht nga perspektiva e zbatimit të projektit të naftës-jellësit Nabucco .
- Lehtësimi i financimit të një studimi fizibiliteti për një interkonektor të rrjedhjes së gazit midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe Greqisë dhe të IRJM-së.
- Themelimi i një Plani Rajonal për Reagimin Emergjent për Gazin në kuadër të negociatave të vazhdueshme mbi propozimet e Komisionit Evropian në lidhje me rishikimin e Direktivës për Sigurinë e Furnizimit me Gaz, e vitit 2004.

Energjia elektrike

- Lehtësimi dhe prioritizimi i përmirësimit të linjave të transmisionit të energjisë elektrike që duhet të zgjerojnë kapacitetin e tyre në mënyrë që të mbështesin zgjerimin e ardhshëm me energji elektrike të prodhuar nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë.
- Lehtësimi i financimit për ndërtimin e linjave të energjisë elektrike me tension të lartë midis Shqipërisë, Greqisë, dhe FYROM, si dhe midis Shqipërisë dhe Italisë (ose, përndryshe, Malit të Zi dhe Italisë, duke pasur parasysh blerjen e fundit të kompanisë kombëtare malazeze të energjisë elektrike nga A2A e Italisë.

Efikasiteti Energjitik dhe Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

- Nxitja e krijimit të niveleve të synuara vullnetare për Zvogëlimin e Emisioneve të CO2 për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe BE-ja dhe në përputhje me vendimin e marrë në Konferencën e Ndryshimeve Klimatike në Kopenhagen.

- Vendosja e një mekanizmi të gjerë të financave që do të përqendrohet ekskluzivisht në promovimin e projekteve të BRE dhe zbatimin e praktikave dhe teknologjive më të mira në bashkëpunim me IEA dhe me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë së Ripërtërishme të sapo themeluar.

- Zgjerimi i projekteve për efikasitet energjitik në të gjithë sektorët e energjisë, duke filluar me ndërtesat dhe materialet e ndërtimit dhe inkurajimi i mbështetjes për projekte të tilla nga institucionet financiare dhe donatorët ndërkombëtare.

- Nxitja e një rritjeje të konsiderueshme në ndihmën e propozuar për investime prej 25 milion • për Fondin e Efikasitetit Energjitik të Ballkanit Perëndimor të Bankës Europiane të Investimeve.

Viktoriya Khasson¹

DEBATE DHE INTERESA NË MARRDHËNIET ENERGJITIKE MIDIS BE-RUSI

Hyrje

Që prej mosmarrëveshjes së parë midis Ruisë dhe Ukrainës në janar të 2006, e cila përfundoi në ndërprerjen e shpërndarjes së gazit në Europë, marrëdhëniet energjitike me Rusinë kanë qenë primare në agjendën e BE-së. Incidenti i ndërprerjes së furnizimit u cilësua si “thirrja për tu zgjuar” drejtuar BE-së, për ti ndjekur më me kujdes politikat për sigurinë energjitike dhe marrëdhëniet saj të jashtme energjitike. Në të njëjtën kohë Rusia po perceptohej si partner energjistik i dyshimtë. Politika e jashtme energjitike e Ruisë shikohej si një mjet i presionit politik mbi fqinjët e saj energjitikisht të varur si dhe si një kërcënim për sigurinë energjitike të BE-së.² Në këto rrethana, u shfaq një debat i spikatur për reduktimin e varësisë së BE-së nga Rusia.

Në të njëjtën kohë, një numër vëzhguesish deklaruan se zgjidhja e problemit nuk duhej të gjendej në pakësimin e varësisë nga gazi rus, por në krijimin “e një ndërvarësie të menaxhuar në mënyrë të kujdesshme dhe bashkëpunuese midis Ruisë dhe BE-së.”³ Faktikisht, ndërprerjet e furnizimit nuk kishin të bënin realisht me një kërcënim real të sigurisë energjitike, por provokuan pasiguri në lidhje me faktin nëse BE-ja duhej “të partnerizohej me këtë lloj Rusie”. Në këtë kontekst, siç u bë e ditur edhe në raportin Pasqyra Analitike Ruse, reagimet e ashpra ndaj krizës ishin pasojë e një koordinimi mjaft të keq të saj kur “konteksti i përgjithshëm politik kundrejt Ruisë ishte i ngarkuar,

¹ Mbajtëse e grantit Chair InBev-Baillet Latour BE-Rusi në K.U.Leuven 2008-2009

² Shiko për shembull Observatorin e Tregut Europian të Energjisë 2007, publikuar nga Capgemini, <<http://www.capgemini.com/energy>>.

³ Cambridge Energy Research Associates, “Kriza e Konfidencës hidhëron Marrëdhënien Ruso-Europiane për Gazin”, Report Special, Shtator 2007 <<http://www.cera.com/aspx/cda/public1/news/pressReleases/pressReleaseDetails.aspx?CID=8970>> (hyr në 18.01.2009)

duke e cilësuar atë si gjithnjë e më shumë jodemokratike dhe autoritare” (Perovic and Orttung, 2007:2)

Qëllimi i këtij shkrimi është të vlerësoj impaktin e këtyre debateve mbi marrëdhëniet energjitike midis Rusi-së dhe BE-së. Veçanërisht, unë do të fokusohem se si debatet lidhur me formulimin e politikës energjitike të BE-së kthehen në politika praktike në fushën e marrëdhënieve energjitike.

Sipas qasjes diskursive (debatuese) në studimet e BE-së, duke qenë se debatet përfshijnë ose përjashtojnë disa mënyra veprimi të veçanta, mbizotërimi i një debati të veçantë, mund të nxjerri në pah marrëdhëniet e fuqisë që ekzistojnë mbrapa procesit të formulimit të politikave. (Larsen, 2004:62) Në lidhje me marrëdhëniet e jashtme energjitike të BE-së, kjo do të thotë që praktikat diskursive, të cilat dominojnë proceset e formulimit të politikave reflektojnë gjithashtu tendencat në praktikat politike.

Këtu do të argumentohet që debati mbi sigurimin që u shfaq direkt mbas krizës së ndërprerjes së furnizimit, ka dominuar dhe vështirësuar praktikat integruese në marrëdhëniet energjitike të BE-së me Rusinë.

Studimi fillon me një vështrim të marrëdhënieve energjitike BE-Rusi në kontekstin e një sigurie në rritje të politikës energjitike të Ruisë. Më tej, pjesa e dytë do të analizoj procesin vazhdues të formulimit të politikës energjitike të BE-së. Dy praktika diskursive të ndryshme do të identifikohen: një e integritit (e bazuar në promovimin e liberalizimit në lidhje me tregun energjistik të BE-së) dhe një e sigurimit dhe diversifikimit (bazuar në supozimin se nevojat e sigurisë energjitike duhet të adresohen si një çështje e politikës së jashtme të BE-së). Së fundmi, në pjesën e tretë, bashkëveprimi i këtyre praktikave diskursive do të vlerësohet në kontekstin e marrëdhënieve energjitike BE-Rusi, në veçanti, rreth çështjeve të furnizimit transit të BE-së dhe aksesit në burimet energjitike të Kaspikut. Si përfundim, do të bëhen disa vëzhgime mbi perspektivat e bashkëpunimit energjistik midis Ruisë dhe BE-së.

Rritja e Sigurisë së Politikës Ruse të Energjisë dhe Marrëdhëniet Energjitike BE-Rusi

Prioritetet e Politikës Energjitike të Ruisë.

Energjia përbën një çështje kryesore për politikën e jashtme dhe të brendshme të Ruisë. Gjate viteve ‘90, privatizimi i pjesës më të madhe të trashëgimisë nga industria e energjisë ruse u

bë një nga proceset më të diskutueshme të shpërndarjes së pasurisë në Rusi, që rezultoi në shfaqjen e oligarkëve të energjisë dhe u shoqërua me padrejtësi të mëdha shoqërore. Pas më se një dekade thjesht shfrytëzimi të pozicionit të tyre monopolistik mbi burimet energjitike, duke u udhëhequr më tepër nga interesa “qiradhënëse sesa ‘përfitim kërkuese’ (me fjalë të tjera, duke përdorur asetet deri në shkatërrimin e infrastrukturës), oligarkët e energjisë më në fund filluan të konkurronin dhe të investonin në prodhim. Siç vihet re dhe në artikullin e BBC-së, “Filozofia e baronëve Rus të naftës ka ndryshuar: ata dikur thjesht akumulonin fonde dhe i përdornin ato për qëllimet e tyre private ose dhe i vidhnin ato. Tani ata po investojnë shuma në teknologji, gjë që disa vite më parë mund vetëm ta ëndërronim dhe janë duke u bërë një konkurrencë e rrezikshme për kompanitë ndërkombëtare të naftës.”⁴

Si rrjedhim, nga fillimi i 2000 kompanitë private zotëronin më shumë se gjysmën e prodhimit në sektorin e naftës. Në vazhden e çmimeve të larta të naftës në botë, energjia u bë një nga burimet kryesore të rilindjes ekonomike të vendit dhe pavarësisë së buxhetit federal nga ndihma ndërkombëtare dhe rrjedhimisht të forcimit të pozicionit të Ruisë në arenën ndërkombëtare. Nisur nga kjo pikëpamje, objektivi kryesor i menaxhimit shtetëror të burimeve energjitike të Ruisë ka pasur të bëjë me sigurimin që performanca e sektorit të energjisë të mbështes interesat kombëtare (Grace, 2005: 217) gjë e cila rezultoi në konsolidimin e kontrollit shtetëror mbi këtë industri. Ky kontroll ushtrohet përgjithësisht nga prezenca e zyrtarëve në kompanitë energjitike dhe anasjelltas, ndërsa ri-shtetëzimi ndodhi në një shkallë më të vogël (kryesisht pas procedimeve ligjore të Yukos në 2003). (Perovic and Orttung 2007: 3) Sektori i gazit- pothuajse gjithë prodhimi vendas vjen nga Gazpromi shtetëror (me 52% të aksioneve) - përbën një komponent të rëndësishëm strategjik të ekonomisë madje edhe të sovranitetit Rus.

Rritja e sigurisë së politikës ruse të energjisë u demonstrua qartësisht kur “interesat e industrisë ruse u ngritën mbi çarjet diplomatike me fqinjët e saj”.⁵ Rasti i parë ndodhi në shtator të

⁴Sipas një analisti të naftës në Troika Dialog Bank në Moskë, e cituar në James Schofield, *‘Rilindja e Naftës Ruse’*, BBC, 24 qershor 2002, <<http://news.bbc.co.uk/1/hi/business/2058214.stm> > (hyr në 18.01.2009).

⁵ Andrew E. Kramer, “Analiza e Lajmeve: Pezullimi naftës ruse shkakton protesta.” International Herald Tribune, Shtator 20, 2006. <<http://www.iht.com/articles/2006/09/19/business/sakhalin.php> > (hyr në 18.01.2009).

2006 kur rregullatorët rus tërhoqën një leje mjedisore nga një projekt zhvillimor nafte dhe gazi natyral prej \$20 bilion Sakhalin-II, i menaxhuar nga Royal Dutch Shell (si operator i parë dhe 55% pronar, dhe dy kompanitë japoneze më të mëdha tregtuese dhe projektuese si pronare të vogla). Vendimi mjedisor u konsiderua nga komuniteti ndërkombëtar si një “fshehje e hollë e presionit mbi anëtarët e konsorciumit Sakhalin-II” (që hyri në tregun rus dhe negocioi koncesionet në vitet 90 kur çmimet e naftës ishin të ulëta) duke vënë në rrezik “klimën e sigurt dhe të parashikueshme të investimit”. Siç u cilësua dhe nga *International Herald Tribune*, mbajtja e aksesit mbi fushat e reja të shfrytëzimit të kompanive kombëtare konsiderohet aq e rëndësishme sa dhe maksimizimi i përfitimeve nga burimet energjitime të vendit.⁶ Vërtet, në vazhdim të procesit ligjor Marrëveshja e Ndarjes së Partnerëve me kompanitë e huaja u rinegociua dhe pjesa e shfrytëzimit të Sakhalin -II u ble nga Gazprom. I njëjti skenar u përsërit në 2007 me zhvillimin e fushës Kovytko, projekti më i pasur në Siberinë Lindore, që operohej nga TNK-BP (një sipërmarrje e përbashkët 50 me 50 e British Petroleum dhe kompanisë ruse Renova Group). Planet për të eksportuar gaz nga Kovytko në tregjet kineze dhe Koreano Jugore, duke përfshirë dhe ndërtimin e një naftësjellësi, ishin bllokuar derisa Gazprom bleu aksionet e projektit TNK-BP.⁷

Ka pasur edhe një ndryshim thelbësor të politikës ruse të energjisë kundrejt vendeve ‘near abroad’ (afër jashtë vendit). Në fakt, që prej 2004 Rusia filloi të rris çmimin e energjisë për këto vende në nivelet e çmimeve të tregut. Që nga shpërbërja e BS ish republikat vazhduan të gëzojnë furnizim me energji nga Rusia me çmime subvencionuese (shpesh afër tarifave të brendshme ruse të energjisë) në këmbim të besnikërisë së supozuar politike brenda proceseve integruese të Komonulethit të Shteteve të Pavarura. Për më tepër, vendet transit që shpërndanin energjinë ruse në Europë (si Bjellorusia dhe Ukraina) mund të përdornin pozicionin transit për të rritur kapacitetin e tyre për të marr furnizime energjie nga Rusia. Kështu që, politika e rritjes së çmimeve përfaqësonte një ndryshim të madh gjeopolitik në hapësirën post-sovjetike, ku logjika ekonomike fillon të dominojë atë politike.

Rritja e parë e çmimit u bë për Bjellorusinë dhe pastaj politika vazhdoi gradualisht për të gjitha vendet e tjera ‘near abroad’

⁶ ibid

⁷ Miriam Elder, “Gazprom e gjen Fushën Kovytko të Gazit të lirë”, *St.Petersburg Times*, Issue No.1283 (49), qershor 26, 2007, <http://www.sptimes.ru/index.php?action_id=2&story_id=22128>.

dhe çoi në konfliktin e çmimit me Ukrainën në 2006, gjë e cila u përsërit edhe në 2007 dhe 2008. Duke mos qenë të afta për ti bërë ballë rritjes së mprehtë të çmimit, një numër vendesh 'near abroad' hoqën dorë nga infrastruktura energjitike si pagesë ndaj vazhdimet të furnizimeve (si p.sh Armenia, Bjellorusia dhe Moldavia). Të tjerët mundën ta përballonin presionin: Gjeorgjia si një rrugë transite për transportin e Azerbajxhanit në Perëndim, mund të përfitonte nga furnizimet me kushte të favorshme, ndërsa Ukraina mundi ti siguronte furnizimet me energji duke hyrë në marrëveshje të ndryshme mbi kushtet për transitin e energjisë ruse dhe dërgimet nga Turkmenistani (siç është firma ndërmjetëse RosUkrEnergjo që u krijua mbas krizës së ndërprerjes në dimër të 2005-2006).

Në të njëjtën kohë, gjithsesi, kjo politikë mund të shikohet si mbështetëse e strategjive ekspansioniste të kompanive ruse të energjisë, përfshirë edhe Gazprom, i cili filloi të bëjë investime thelbësore në asete të reja jashtë vendit, veçanërisht, në sistemet e shpërndarjes dhe infrastrukturën transite. (Woehrel, 2008:6) Në fakt, në valën e çmimeve të larta të energjisë në botë kompanitë ruse të energjisë kishin akumuluar burime të mjaftueshme financiare dhe synonin të ktheheshin nga furnizuese me shumicë në vendosjen e rrjeteve për të siguruar shërbime drejt konsumatorit. Në këtë drejtim, tregjet e vendeve 'near abroad' dhe të ish bllokut socialist përbënin mundësi më tërheqëse për strategji të tilla, meqenëse tarifat e hyrjes janë shumë më të ulëta se në tregjet perëndimore.⁸

Përkundrejt këtij background-i, objektivi kryesor i politikës ruse të energjisë: sigurimi i eksporteve energjitike drejt BE-së, nuk pësoi ndryshime.⁹ Stabiliteti i eksporteve është shumë i rëndësishëm për sektorin energjistik të Ruisë. Në veçanti për Gazprom, i cili po kompenzon mungesën e përfitimeve nga shitjet e brendshme me një çmim të ulët me të ardhurat nga eksportet europiane që sjellin dy të tretat e përfitimeve totale të kompanisë (ndërkohë që përbën vetëm një të tretën e prodhimit total të kompanisë). Që prej viteve

⁸ Këto lloj politikash ishin tipike jo vetëm për sektorët strategjik të burimeve natyrore por edhe të telekomunikacionit dhe industritë përpunuese. Në veçanti në Bjellorusi, kapitali rus lakmonte të blente asete fitimprurëse para se oligarkia vendase të shfaqej dhe të vinin blerësit e huaj. (Vahtra, 2005: 8)

⁹ "Elementet kryesor të Strategjisë Ruse të Energjisë" "Основные элементы Энергетической стратегии России", 18 июня 2007. Доклад заместителя Министра промышленности и энергетики РФ Андрея Деметиева на 11-ой ежегодной конференции инвесторов "Ренессанс Каледн" <<http://www.minprom.gov.ru/appearance/report/4/>>.

90, qeveria ruse filloi të kërkoj mënyra për të ndryshuar rrugët e eksportit në mënyrë që të zvogëlonte varësinë nga shtetet transite fqinje. Për sa i përket eksporteve të naftës problemi ishte mungesa e infrastrukturës së porteve detare duke qenë se që prej kohës së Bashkimit Sovjetik ngarkesat kalonin nga porti Ventspils i Letonisë dhe Butinge i Lituanisë.¹⁰ Kështu që, një porti i ri detar Balltik u ndërtua në Promorsk. I hapur në 2003, ai lejoi pasjen e një rruge eksporti direkte nga zonat e naftës në Uralet dhe Siberinë Perëndimore përmes Sistemit Naftësjellës Balltik (BPS).¹¹

Në mënyrë që të rriste eksportin e gazit, në 1993 Rusia filloi ndërtimin e naftësjellësit *Yamal-Europe* që kalonte përmes Bjellorusisë dhe Polonisë për në Gjermani.¹² Me kapacitetin vjetor prej 33 bsm ai i shton rrugëve ekzistuese të eksportit nëpërmjet sistemit të naftësjellësit *Brotherhood* që kalon përmes Ukrainës. Në 2005 një tjetër naftësjellës i shumëllojshëm i quajtur *Blue Stream (Rryma Blu)* filloi të operoj në shtratin e Detit të Zi, duke lidhur stacionin rus Beregovaja direkt me qytetin verior të Turqisë, Samsun.¹³

Të njëjtin vit Gazprom kishte nënshkruar një kontratë me gjermanin BASF AG dhe E.ON AG për ndërtimin e naftësjellësit që kalonte nga Deti Balltik dhe lidhte Vuborg-un rus direkt me rajonin Greifswald të Gjermanisë duke shkuar më tej në MB.¹⁴ Së fundmi, në qershor të 2007, projekti naftësjellës *South Stream (Rryma Jugore)* u shpall për të shpërndarë gaz nëpërmjet shtratit të Detit të Zi direkt në Bullgari dhe më pas në Itali dhe Austri. Projekti po zhvillohet në bashkëpunim me Eni SpA italiane,

¹⁰ Kompania Ruse Transneft ndaloi furnizimet nëpërmjet Ventspils në 2002, ndërkohë që vazhdon furnizimet nga Lituania ku Yukos ka pjesën më të madhe të aksioneve në port nga aksionet e Mazeiklu Nafta.

¹¹ Projekti filloi në 1997 dhe ndërtimi përfundoi në dhjetor 2001. Në prill 2006, Sistemi Naftësjellës Balltik arriti kapacitetin e plotë prej 1.3 milion barrela naftë në ditë. Për më tepër, në 2007, projekti i Sistemit Naftësjellës Balltik -2 (BPS-2) u aprovua për lidhjen e nyjes Unecha të naftësjellësit Druzhba pranë kufirit ndërmjet Rusisë-Bjellorusisë me terminalin Primorsk të naftës.

Shiko http://www.sptimes.ru/index.php?action_id=2&story_id=17280

¹² web site Gazprom Export, <http://www.gazexport.ru/?pkey1=000040000400001>

¹³ Naftësjellësi pritet të arrijë kapacitetin e tij të plotë naftësjellës (prej 16 bcm gaz në vit) në 2010. Kjo mund të shërbej për të furnizuar me gaz jo vetëm Turqinë por edhe Europën Juglindore, duke e bërë naftësjellësin një element të rëndësishëm të strategjisë eksportuese të Gazprom-it.

¹⁴ Kompanitë e përfshira kanë ngritur Kompaninë e Naftësjellësit të Gazit të Europës Veriore, si një shoqëri e përbashkët Gjermano-Ruse, ku Gazprom mban 51% dhe BASF dhe E.ON, 24.5 % secila. (më vonë e quajtur si Nord Stream {Rryma Veriore}).

partneri që mori pjesë gjithashtu në ndërtimin e naftës-jellësit Blue Stream dhe punimet për ndërtim janë planifikuar për 2011.

Gjithsesi, dilema e transiti mbetet në qendër të politikës ruse të eksportit të energjisë. Siç u demonstrua edhe në mosmarrëveshjen e re për gazin me Ukrainën në janar të 2009, problemet e pazgjidhura vazhdojnë të provokojnë situata të reja krizash dhe çështja e tranzitit mbetet thellësisht e politizuar. Ndërsa Ukraina po shfrytëzon pozitën e saj monopolistike si korridor për furnizimet ruse për në BE (me një kapacitet naftës-jellës prej 143 bcm që llogaritet të përbëjë rreth 80% e gjithë eksportit rus drejt BE-së), mjeti i Rusisë duke ndërprerë furnizimet limitohet deri diku nga detyrimet kundrejt partnerëve European. Megjithatë, Rusia e tregoi veten që nuk ishte më gati për dorëzimin e furnizimeve, edhe pse kjo do të thoshte që stabiliteti i eksporteve transit drejt BE-së, do të vuante.

Sfidë për Sigurinë Energjitike të BE-së?

Qasja kryesore e BE-së përkundrejt marrëdhënieve energjitike me Rusinë ka të bëjë me nënshkrimin e kësaj të fundit nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale. Instrumenti kryesor ka qenë Traktati i Kartës së Energjisë, i nënshkruar në 1994 për të promovuar një regjim energjistik ndërkombëtar në hapësirën post sovjetike. BE-ja po kërkonte krijimin e një tregu energjistik pan-europian nëpërmjet procesit të përqasjes së legjislacionit (me legjislacionin europian). Aspiratat ishin që nëpërmjet vendosjes së një strukture të përgjithshme bashkëpunimi marrëdhëniet energjitike do të depolitizoheshin dhe do të "...bazoheshin, jo vetëm në interesa të përbashkëta, por edhe në vlera të përbashkëta". (José Manuel Barroso Samiti Informal i BE-së në Lahti, tetor 2006) Megjithatë, ideja e adoptimit të rregullave që ekzistojnë në BE për tregtinë e energjisë, investimet dhe transitin u konsiderua si e papranueshme nga Moska. Në veçanti, Rusia kurrë nuk mund të pranonte Protokollin e Tranzitit që i bashkëngjitej Kartës. Ky protokoll kishte si qëllim që të hapte tubacionet e brendshme ruse të gazit dhe naftës për transitin e hidrokarbureve, duke përfshirë ato që vijnë nga Azia Qendrore, duke e njohur BE-në në vetvete si një subjekt përjashtues në kuadër të artikujve të organizatave rajonale.¹⁵ Si pasojë, Rusia u tërhoq nga procesi i ratifikimit dhe e konsideron Kartën e Energjisë si të vjetruar.

¹⁵ Siç u vu re nga Belyi, që prej përfundimit të Kartës, integrimi energjistik i vet BE-së u bë gjithashtu kontradiktor me Protokollin e Tranzitit që komplikonte negociatat. Shiko Belyi, 2008:213.

Në një mënyrë të ngjashme, progresi i bërë në kuadër të Dialogut BE-Rusi për Energjinë i lançuar në tetor të 2000, është penguar nga këndvështrime të ndryshme mbi prioritetet që kanë të dy partnerët. Në fillim të Dialogut Rusia po udhëhiqej kryesisht nga prioritete afatshkurtra, si ruajtja e pozicionit të saj në tregun europian duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e rregullave të tregut të saj energjistik dhe kontrollin shtetëror mbi investimet. Sipas Romanovës, vetëm vitet e fundit Rusia filloi të zhvillonte një vizion më strategjik të marrëdhënieve të saj energjitike me BE-në. (Romanova, 2008: 220) Qasja ruse favorizon parimin e reciprocitetit që kuptohet si një poçes ku interesat e secilit partner trajtohen në mënyrë të barabartë. Nisur nga kjo, Rusia theksoi që ka prioritetet e veta për ndërtimin e një marrëdhënie reciproke me BE-në. Siç u konstatua dhe nga presidenti Putin gjatë një konference për shtyp para Samitit BE-Rusi në Sochi, “Pse duhet të përpiqemi për të vendosur çështjet që i interesojnë partnerëve tanë sot dhe të harrojmë interesat tona?”¹⁶

Pra, ndërsa në BE parimi i reciprocitetit nënkupton një riafrim të përgjithshëm në fushën e bashkëpunimit, p.sh: “reciprociteti në tregje, infrastrukture dhe investime”¹⁷, Rusia po kërkonte më tepër rregullime rast pas rasti. Për shembull, kompanitë europiane mund të merrnin pjesë në fusha eksplorimi në Rusi (e kufizuar kryesisht nga zona “e vështirë” e Arktikut) nëse si këmbim kompanitë ruse do të merrnin akses për shpërndarjen e rrjeteve në Europë. (Romanova, 2008: 221-222) Në veçanti, Rusia mbajti një pozicion të fortë në lidhje me paaplikueshmërinë e modelit të BE-së në modelin e vet të energjisë. Duke komentuar mbi qasjen e BE-së përkundrejt liberalizimit të tregut të energjisë, Ministri rus i Energjisë Victor Krishtenko nënvizoi se “duke qenë se infrastruktura e gazit dhe energjisë elektrike funksionon në mënyra të ndryshme, ndarja e tyre nuk ka pse të ndodhi në të njëjtën mënyrë. Kështu, në Rusi ndarja aplikohet vetëm mbi tregun elektrik, ndërsa firmat e gazit, sidomos Gazprom, mbeten të integruara vertikalisht.”¹⁸

¹⁶ Putin ju referua procesit të arritjes së një marrëveshje për akses të lirë për materiale nukleare në tregjet europiane, e filluar disa vite më parë por gradualisht e ngrirë nga ana europiane. Për detaje shiko faqen zyrtare të Presidentit të Federatës Ruse <http://www.kremlin.ru/eng/speeches/2006/05/25/2359_type82915_106123.shtml>.

¹⁷ Artikull Gazete “Samiti BE-Rusi në Sochi në 25 Maj”, 24.05.2006<<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/06/678&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>>.

¹⁸ E cituar nga EURACTIV në “BE, Rusia të eksploroj “reciprocitetin” në tregtinë Energjitike” 17 tetor 2007, <<http://www.euractiv.com/en/energy/eu-russiaexplore-reciprocity-energy-trade/article-167662>>.

Për BE-në sfida kryesore në marrëdhëniet e saj energjitike me Rusinë ka të bëjë me produktivitetin e sektorit rus të energjisë.

Sipas Komisionit Europian:

“Me nivelet aktuale të investimit në prodhim, transport dhe shpërndarjen e produkteve energjitike, shqetësime janë shprehur në lidhje me faktin që Rusia mund të mos jetë e aftë për të kënaqur në mënyrë të përshtatshme kërkesën në rritje si për eksporte ashtu edhe në tregjet e brendshme. (Komisioni Europian, 2006a)

Faktikisht, fokusi i Ruisë në investime në naftësjellës dhe blerjeve në këtë drejtim në vend të teknologjisë së re dhe punës zhvilluese¹⁹ vë në pikëpyetje disponueshmërinë e furnizimeve që i nevojiten BE-së për të përballuar nevojat e saj të importit të gazit. Kështu që, politika ruse e energjisë është parë si sfiduese ndaj sigurisë energjitike të BE-së, ndërsa kthesa për shfaqjen e retorikës mbi pasigurinë ndaj Ruisë u bë konflikti Rusi-Ukrainë në 2006 që çoi për herë të parë në ndërprerjen e furnizimeve me gaz për Europën. Në këtë pikëpamje, refuzimi i Ruisë për të nënshkruar Kartën e Energjisë u kritikua në mënyrë të veçantë derisa Karta (nëse ratifikohet) konsiderohej si mekanizëm më i përshtatshëm për të shmangur konfliktet mbi transitin e energjisë. Këto perceptime do të analizohen në pjesën në vijim, në kuadër të formulimeve të politikës së jashtme energjitike të BE-së.

Diskurse Integrimi dhe Diversifikimi në Formulimet e Politikës së Jashtme Energjitike të BE-së

Pavarësisht nga rritja e varësisë së BE-së nga importet energjitike²⁰, mungon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj marrëdhënieve të jashtme energjitike. Në fakt, BE-ja filloi të prezantoj aspekte të jashtme në politikën energjitike që prej vitit 2000, përgjatë shqetësimeve që po shfaqeshin për sigurinë e furnizimit me energji²¹ si dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm. Gjithsesi, përpjekja

¹⁹ Për më shumë informacion mbi politikën e investimit të Gazprom shiko: “Уровневые инвестиции. Актуальные вопросы и ответы по инвестиционной программе на 2007 год”, 27.06.2007, <<http://www.gazprom.ru/articles/article25882.shtml>>.

²⁰ Rritja e nevojave të BE-së për furnizimet me energji erdhi si pasojë e uljes së prodhimit në Detin e Veriut si dhe nga rritja e nevojave për energji të ekonomive europiane.

²¹ Sfidat në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji ishin rezultat i rritjes së destabilitetit gjeopolitik në botë, sulmeve terroriste në rajonet që prodhonin energji, aksioneve politike në Irak etj (Shiko Narbutiene 2007:79)

e parë për të koordinuar aspektet e brendshme dhe të jashtme të politikës së saj energjitike u ndërmor nga Letra Jeshile (Green Paper) i Komisionit “Strategjia Europiane për Energji të Qëndrueshme, Konkurruese dhe të Sigurt” e nxjerr në 2006, ku u tha qartësisht që objektivat e politikës energjitike të BE-së (që janë zhvillimi i një mjedisi të qëndrueshëm, efektiviteti ekonomik dhe siguria e furnizimit) mund të sigurohen vetëm nëpërmjet një sërë masash komplekse të një natyre të brendshme dhe të jashtme. Kjo qasje e integruar u bë një karakteristikë e të gjithë procesit të formulimit të politikës energjitike të BE-së. Në rast se më parë çështjet e rëndësishme për tregun e brendshëm energjistik dhe sigurinë e furnizimit energjistik do të trajtoheshin nga organe legjislative të tjera, tani do të ishin pjesë një dokumenti të vetëm politikash.

Strategjia e adoptuar nga BE përfshin promovimin e një tregu energjistik të integruar²² dhe solidaritetit ndërmjet shteteve anëtare nga njëra anë, dhe diversifikimit të burimeve energjitike dhe origjinave gjeografike dhe rrugëve transite nga ana tjetër.²³ Pra, Komisioni vazhdoi përpjekjet e tij për të liberalizuar më tej tregun e brendshëm energjistik dhe të vendos ndërlidhje energjitike për integrimin e tregjeve energjitike kombëtare duke nxitur ndërkohë përdorimin e energjisë së ripërtërishme si dhe të teknologjive që kursejnë energji. Në të njëjtën kohë, ai filloi “të vendos instrumentet e jashtme në shërbim të një energjie më të sigurt dhe më konkurruese”. (Waldner, 2006) Ndër këto instrumente Komisioni 2006 liston marrëdhëniet me prodhuesit kryesor të BE-së dhe partnerët transit të Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme, si dhe të gjithë rrjetin e marrëveshjeve bilaterale, multilaterale dhe rajonale dhe skema specifike bashkëpunimi.

Në fakt, çështjet e sigurisë janë përfshirë në marrëdhëniet e jashtme të BE-së që prej 1997 kur forumi Mesdhetar i Energjisë u ngrit në kuadër të strukturës së Barcelonës. Objektivi i forumit

²² Siç u përcaktua në Letrën e Bardhë mbi Politikën Energjitike të Komisionit në 1995, një treg i brendshëm i përbashkët energjistik duhet të bazohet prodhim e ndarë të gazit dhe elektricitetit, rrjeteve të transmisionit dhe të shpërndarjes. Kjo qasje ndjek gjerësisht modelin e prezantuar në MB për vendosjen e tregjeve të liberalizuara të gazit dhe elektricitetit nëpërmjet krijimit të tregjeve energjitike ndërkufitare me akses të hapur mbi naftësjellësit dhe rrjetet, duke abandonuar praktikën e kontratave afatgjata për investimet në drejtim të kundërt. Shiko Helm, Dieter (2007) *Politika e Jashtme Energjitike e Europës: Dimensioni Rus*.

²³ Shiko për shembull Letrën e Komisionit /SG/HR për Këshillin e Europës, Një politike e jashtme për ti shërbyer interesave energjitike të Europës, qershor 2006

ishite të rregullonte praktikat e tregtisë energjitike dhe të ulte pasiguritë në marrëdhëniet me partnerët Mesdhetar Jugor duke liberalizuar marrëdhëniet, përfshirë dhe heqjen e “artikullit të destinacionit” (kontratat afatgjata me destinacion gjeografik të specifikuar të furnizimeve) në rast të liberalizimit reciprok të sektorit të energjisë me vendet partnere. Një përpjekje e ngjashme është ndërmarr në kuadër të iniciativës Dimensioni Verior i BE-së duke vendosur Bashkëpunimin Energjitik të Rajonit të Detit Balltik (BERDB) në 1999 i cili përfshiu rajonet Veri-Perëndimore të Rusisë.²⁴ Kjo qasje mund të përshkruhet si eksportimi i modelit të tregut energjitik të liberalizuar të BE-së (duke përfshirë vlerat bazë të politikës energjitike të BE-së si efektiviteti, qëndrueshmëria dhe siguria energjitike siç u nënvizuan në 2006 në Kartën Jeshile të KE) jashtë kufijve të Bashkimit dhe mund të quhet një strategji “integrimi”. Në fakt, objektivat e duhura u përfshin në Planet e Veprimit të Politikës Europiane të Fqinjësisë (e përfunduar me vendet fqinje të BE-së duke filluar nga 2005), si dhe në iniciativat rajonale të adoptuara në verë të 2007 ndaj rajonit të Detit të Zi dhe Azisë Qendrore. Për më tepër, Traktati Komunitetit të Energjisë, i nënshkruar në tetor të 2006, e shtriu të gjithë *acquis* e BE-së mbi energjinë në vendet e Ballkanit Perëndimor duke pasqyruar anëtarësi të mundshme për shtetet vëzhguese si Moldavia, Norvegjia, Ukraina dhe Turqia si dhe parashikoi vendosjen e Dhomave të Përbashkëta Euro-Mesdhetare –Deti i Zi dhe Kaspik.

Në kuadër të kësaj strategjie siguria e furnizimeve kuptohet fillimisht si “mjedisi ligjor për kompanitë që investojnë në prodhimin e energjisë, transportit dhe prodhimit”²⁵ dhe, rrjedhimisht, siguria energjitike duhet të arrihet nëpërmjet “efikasitetit, transparencës, dhe sigurisë që janë thelbësore për të ndihmuar në investimet afatgjata” në vendet partnere të BE-së. (Ferrero-Waldner, 2006) Me fjalë të tjera, logjika e përdorur në ndërtimin e politikës energjitike të brendshme filloi të zgjerohet

²⁴ BERDB mblodhi Ministrat e Energjisë të vendeve të Rajonit të Detit të Zi dhe Komisionit European në lidhje me integrimin e tregjeve elektrike dhe të gazit, promovimit të sigurisë së furnizimit, konkurrueshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Në veçanti, ai inkurajoi mbylljen e plantacioneve nukleare të pasigurta, promovimin e një kulture të sigurt nukleare dhe përmirësimit të menaxhimit të shfrytëzimit.

²⁵ José Manuel Durao Barroso, Presidenti i Komisionit European, Duke folur me një zë të përbashkët: Politika Energjitike në Shekullin e 21, Honorary degree ceremony, Georgetown University, 9 shkurt 2006, <http://ec.europa.eu/commission_barroso/president/pdf/speech_20060209_en.pdf>.

në fushën e marrëdhënieve të jashtme²⁶ dhe, nëpërmjet këtij procesi, parimet bazë dhe vlerat në lidhje me bisedimet e politikës energjitike të BE-së u përkthyen në praktikën e saj të politikës duke krijuar një model të ri për aktrimin e BE-së. Megjithatë, përgjatë këtij procesi të eksportimit të modelit të tregut të liberalizuar energjistik të BE-së jashtë kufijve të saj, u shfaq një diskutim paralel i cili u fokusua fillimisht në objektivin e diversifikimit të origjinës dhe të rrugëve të tranzitit për furnizimet me energji të BE-së (dhe i cili mund të quhet diskutimi i “diversifikimit”).

Kundra qasjes zyrtare të BE-së për të ruajtur sigurinë energjitike nëpërmjet një kompleksi masash të brendshme dhe të jashtme, ky diskutim fokusohet ekskluzivisht në aspekte të jashtme të politikës energjitike. Ai prezantohet nga një retorikë e vulnerabilitetit të Bashkimit në lidhje me nevojën për të rritur importet energjitike dhe thirrjet për të zvogëluar varësinë e BE-së nga furnizuesit më të mëdhenj me energji. Në kuadër të debatit, siguria energjitike kuptohet jo vetëm si një kërkesë për një mjedis ligjor të caktuar për operatorët e tregut energjistik, por si një objektiv në vetvete, që nënkupton që BE duhet të ketë një strategji për marrëdhëniet e jashtme energjitike.

Siç u tha nga Anëtarë i Parlamentit Europian polak dhe Kryetari i Komisionit të çështjeve të Jashtme Jacek Saryusz-Wolski gjatë debatit parlamentar pas konfliktit për gazin midis Rusisë dhe Ukrainës në 2006, siguria e furnizimit energjistik të BE-së është “një çështje me natyrë politike” e cila “duhet të diskutohet në kontekstin e politikës së jashtme dhe të sigurisë” dhe që “prandaj është absolutisht thelbësore që BE-ja të zgjerojë aksionet në fushën e energjisë dhe të marrë hapa që synojnë krijimin e një politike energjitike proaktive”²⁷. Në raportin e adoptuar nga Parlamenti Europian në Shtator të 2007, ai theksoi më tej se ‘BE duhet të ndalojë ta trajtoj energjinë thjesht si komoditet dhe duhet ta bëjë atë një pjesë plotësisht të nënshkruar të politikës së jashtme duke përfshirë masa të tilla si, për shembull, prezantimi i një Përfaqësuesi të Lartë të BE-së për energjinë.’²⁸ Raporti gjithashtu sugjeroi që

²⁶ Procesi është quajtur eksternalizim i qeverisjes. Shiko Lavenex, S. (2004) Qeverisja e Jashtme e BE-së në një Europë më të Gjerë., në *Journal of European Public Policy*, Vol. 11, No 4.

²⁷ BE kërkon rrugë të reja furnizimi menjëherë mbas konfliktit të gazit Rusi-Ukrainë”, e publikuar në Euractiv, 18 Janar 2006, <<http://www.euractiv.com/en/energy/euseeks-new-supply-routes-wake-russia-ukraine-gas-row/article-151692>>.

²⁸ Komiteti i Parlamentit Europian mbi Punët e Jashtme, Raport drejt një Politike të Jashtme të Përbashkët Europiane mbi Energjinë, 11 Shtator 2007, Rapporteur: Jacek Saryusz- Wolski (2007/2000(INI))

“së bashku, BE-ja duhet të marr përsipër të largohet nga Rusia, sidomos për gazin, drejt furnizuesve të energjisë të Detit Kaspik dhe Mesdhe” dhe bën thirrje për masa praktike siç janë lidhja e aderimit të Ruisë në OBT me ratifikimin e Traktatit të Kartës së Energjisë.²⁹

Retorika e diversifikimit u nënvizua më qartësisht në lidhje me projektin e naftës-jellësit Nabucco i cili ishte i dizenuar për sjelljen e furnizimeve të reja të energjisë direkt nga Kaspiku dhe Lindja e Mesme. Për shembull, në shtator të 2008 menjëherë mbas konfliktit ushtarak Gjeorgji-Rusi, komisioneri Piebalgs theksoi nevojën për të minimizuar varësinë e Bllokut nga gazi Rus dhe të përsërisë mbështetjen për Nabucco duke thënë se “Objektivi jonë i diversifikimit të burimeve dhe rrugëve tona është akoma më shumë i rëndësishëm pas ngjarjeve në Gjeorgji” dhe duke thirrur për “një angazhim politik më të madh për të hequr të gjitha pengesat në sjelljen e burimeve energjitike të Kaspikut në tregjet Europiane”.³⁰ Për më tepër, në janar të 2009 duke adresuar një samit të dedikuar projektit të Nabucco në Budapest, Kryeministri Cek Topolanek që mbante Presidencën e BE-së i përshkroi planet e Ruisë për të ndërtuar naftës-jellës për furnizim direkt në Europë si të qëllimshme për të ruajtur varësinë energjitike të Europës dhe projektin South Stream si “kërcënim direkt” për Nabucco-n.³¹

Megjithëse ky bisedim vështirë se mund të gjendet në ndonjë dokument zyrtar politikash të BE-së, është përkthyer shpesh në praktika diskursive në kuadër të marrëdhënieve energjitike BE-Rusi, duke iu kundërvënë diskursit të integritimit. Për shembull, lançimi i projektit të përbashkët ruso-gjerman Nord Stream (Rryma e Veriut) në 2005, është kritikuar ashpër nga vendet bregdetare të Detit Balltik si cenes i interesave të tyre si vende transit si dhe i sigurisë së tyre energjitike të furnizimit. Për më tepër, sipërmarrja e përbashkët ruso-italiane South Stream shikohej, përfshirë edhe nga disa zyrtarë europian, si konkurruese me projektin e promovuar nga BE të Nabucco për ndërtimin e naftës-jellësit nga Turqia, Greqia dhe Italia, si dhe

²⁹ “Thirrje për Politikë Energjitike “Politike” të BE-së, nga Honor Mahony, Vëzhgues i BE-së Shtator 2 2007, <<https://www.usrbc.org/memberarea/commercialissues/wto/2007/2016>>.

³⁰ Cituar në “*IEA këshillon BE-në për tu bashkuar në çështje të sigurisë*”, Shtator 05, 2008, <<http://eudemocrats.org/eud/news.php?uid=118>>.

³¹ “*Rusia kërcënon Nabucco, thotë presidenti i BE-së*”, EurActiv, 27 Janar 2009, <<http://www.euractiv.com/en/energy/russia-threatening-nabucco-eu-president/article-178886>>

Bullgaria, Rumania dhe Austria.³² Në përgjithësi, projektet e Ruisë për dërgim të drejtpërdrejtë në Europë nëpërmjet “naftës-jellësve tepricë” (që kalojnë kapacitetin rus të prodhimit të naftës dhe gazit për ti mbushur ato) është parë si “të lejosh Ruisë të shpërndaj prodhim të pakët vendeve transit “të favorizuara”, duke pakësuar mjetet e të tjerëve”.³³ (Woehrel, 2008:6)

Për më tepër, siç u vu re nga Pierre Noel, furnizimet ruse me energji kanë një “efekt deçiziv” që vjen për shkak të ndryshimeve të rëndësishme që ekzistojnë midis shteteve anëtare të BE-së në lidhje me varësinë e tyre nga furnizimet ruse. (Noel, 2008:9) Përgjithësisht, tregjet e reja të gazit të BE-së Lindore janë gjerësisht të varura nga furnizimet ruse dhe infrastruktura e tyre energjitike e trashëguar nga periudha socialiste është shumë e lidhur me rrjetet ruse. Në të njëjtën kohë, vendet e vjetra anëtare varen nga furnizimet ruse në një shkallë më të vogël (Gjermania 37%, Italia-25%, Franca-16%)³⁴. Ato përfitojnë nga një mori furnizimesh dhe tregje më të mëdhaja (si p.sh Gjermania dhe Italia të dyja llogariten si konsumatorët e gjysmës së gazit rus në të gjithë BE-në) dhe, pra, konsiderohen si partneret kryesorë të Gazprom. Në mungesë të një tregu energjistik të përbashkët ku furnizimet me energji, mund të shpërndaheshin përgjatë kufijve kombëtare nga rregullat e tregut, furnizimet me energji ngelen subjekt i marrëdhënieve bilaterale të secilit prej shteteve anëtare me shtetet furnizuese. Natyra tepër e politizuar e furnizimeve me energji mund të pakësohej vetëm kur kontrata ‘Europiane’ me Gazpromin të bëhej e mundur.³⁵

Impakti i këtyre dy praktikave diskursive mbi aktrimin e BE-së në fushën e marrëdhënieve energjitike do të shqyrtohet nëpërmjet analizës së dy situatave të pandara nga marrëdhëniet energjitike BE-Rusi: transiti i gazit rus në BE dhe aksesit i burimeve energjitike të Kaspikut.

³² Susanne Nies, “Nabucco në Rymën e Jugut –des gasoducs trops politisees ?” L’édito du programme Énergie - Mars 2008, available at <http://www.ifri.org/frontDispatcher/ifri/publications/actuelles_de_l_ifri_1197584475485/publi_P_actuelle_edito_dec___1204898510681?view=popupActuelle>.

³³ Në përgjigje të llogaritjeve të tilla zyrtari i Gazprom Medvedev deklaroi se mundësia që Rusia të dërgoj eksportet e energjisë në një drejtim të caktuar të preferencave (politike) është “thjesht jo realiste sepse Rusia nuk do të bënte këto investime gjigande vetëm për të mbajtur naftës-jellësit bosh.” Shiko Alexander Medvedev, “Është strategjia e Gazprom politike?” në Europe’s World, Korrik 2008.

³⁴ “Varësia Europiane nga Gazi Rus” në website SOT të Ruisë, Janar 13, 2009, <<http://www.russiatoday.com/news/news/35846>>.

³⁵ Ibid.

Praktikat Politike në kontekstin e Marrëdhënieve Energjitike BE-Rusi

Eksporti i hidrokarbonit rus drejt Europës ofron ilustrimin më të qartë të varësisë energjitike BE-Rusi. Siç u tha nga Presidenti i Komisionit European Barroso,

“Aq sa është në interesin e BE-së të ketë një furnizim të qëndrueshëm nga Rusia, ashtu është edhe në interesin e Ruisë të ketë një kërkesë të qëndrueshme nga një Europë e suksesshme në pragun e vet, dhe teknologji europiane dhe njohuri për të ndihmuar në nxjerrjen e gazit dhe të naftës” (Samiti BE-Rusi në Sochi, Maj 2006)

Është pra, jo surprizuese që në këtë kontekst mund të vëzhgohet prezenca e praktikave politike mbizotëruese “të integritimit”. Pra, reagimi zyrtar i BE-së ndaj rasteve të “prerjeve” që rezultuan në ndërprerjen e furnizimeve të BE-së ishte përpjekja për të depolitizuar çështjen e tranzitit të energjisë. Për shembull, pas krizës së parë midis Ruisë dhe Ukrainës në 2006, pavarësisht shqetësimeve të ngritura në media dhe opinionin publik në lidhje me pasigurinë e furnizimit energjistik nga Rusia, në një letër nga Presidenca e BE-së³⁶ u bë e ditur se Rusia, dhe Gazprom në veçanti, kanë qenë dhe mbeten një furnizues i besueshëm i BE-së.³⁷ Për më tepër, kur ndodhi një tjetër konflikt çmimi (këtë radhë me Bjellorusinë) në fillim të 2007 një zgjidhje konkrete u propozua nga Kancelaria gjermane Angela Merkel që shtroi idenë e një Mekanizmi Paralajmërimi të Parakohshëm³⁸ si një mjet për të përmirësuar komunikimin dhe, pra, për të shmangur irritimet dhe tensionet në të ardhmen (iniciativa përfshinte gjithashtu masa teknike si instalimin e gjeometrave për matjen e kalimit të gazit në kufijtë e vendeve transit).

Kjo qasje pragmatike ka koinçiduar me kthesën e përgjithshme në marrëdhëniet BE-Rusi, nga diskutimet mbi natyrën e partneritetit strategjik drejt rivendosjes së bashkëpunimit për

³⁶ Komisioneri i Energjisë Andres Piebalgs dhe Ministri federal austriak i Ekonomisë dhe Punës po vepronin në emër të Presidencës.

³⁷ “Komisioneri Piebalgs dhe Ministri Bartenstein qartësuan pikat kyçe të marrëdhënies tregtare të gazit midis Ruisë dhe BE-së në një letër drejtuar Qeverisë ruse”, 02.05.2006.

<http://www.eu2006.at/en/News/Press_Releases/May/0205bartenstein.html>.

³⁸ Negociatat mbi Mekanizmin e Paralajmërimin të Parakohshëm filluan në maj të 2007 në Samitin në Samara dhe përfunduan gjatë Samitit tjetër në Mafra në tetor të 2007.

-çështje konkrete. Sipas një analisteje të Qendrës BE-Rusi Elena Prokhorova, në mungesë të post Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit, ishte nevoja për të “përmbushur një dëshirë të përbashkët për të rivendosur një normalitet në marrëdhëniet BE-Rusi, e dëmtuar nga një numër tensionesh politike dhe ekonomike në rritje...”³⁹

Për më tepër, në dhjetor të 2006 gjatë Këshillit të dytë të Partneritetit të Përhershëm BE-Rusi (KPP) u adoptua Programi i Përbashkët BE-Rusi për Efiçencën Energjitike.⁴⁰ Kjo jep një mundësi të mirë për një bashkëpunimi teknik jo të limituar rast pas rasti, duke qenë se Rusia ka nevojë të modernizoj sektorin e vet energjitik dhe do ti mirëpriste investimet europiane dhe teknologjinë në fusha të tilla si, rinovimi i sistemit të transmisionit ose kursimi i djegies së gazit gjatë prodhimit të naftës. (Perovic and Orttung, 2007: 7)

Në lidhje me kuadrin e përgjithshëm për bashkëpunim, Rusia ka demonstruar një lloj vullneti për të aderuar në standardet dhe parimet e përbashkëta. Për shembull, gjatë Samitit jo zyrtar në Lahti, në Finland i organizuar nga udhëheqësit e BE-së në tetor 2006 për të diskutuar aspektet e jashtme të politikës energjitike, Presidenti i Ruisë Putin, tha se, ndërkohë që refuzoi të nënshkruante Protokollin e Energjisë Transite, Rusia ra dakord për aspektet e përgjithshme të Traktatit të Kartës së Energjisë (përfshirë, në fakt, në draftin e post Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit). Është gjithashtu shumë simbolike që Rusia reagoi në një mënyrë të matur ndaj kushtit të reciprocitetit të prezantuar nga paketa liberalizuese e Komisionit Europian e lëshuar në shtator të 2007. Edhe pse kushti ishte si një lloj sigurimi kundra kompanive të huaja që kontrollojnë tregun e brendshëm energjitik të BE-së (dhe i keq cilësuar nga media si “kushti i Gazprom”), u vlerësua si jo problematik nga zyrtarët A. Medvedev: ai specifikoi që “Gazprom ka aksione të disa kompanive energjitike europiane, që është një praktikë e zakonshme që shërben për përforcimin e ndërvarësisë dhe kështu, sigurisë energjitike, por në një shkallë më të vogël” dhe që kompania nuk ka si qëllim të marri një pjesë kontrolluese në

³⁹ Shiko artikujt e EURACTIVE “ BE, Rusia minimizon ambicinet në Samit” 26 Tetor 2007, <<http://www.euractiv.com/en/enlargement/eu-russia-playambitions-summit/article-167941>> dhe “Jo zbulime të reja në bisedimet BE-Rusi” 29 Tetor 2007.

⁴⁰ Shtypi “Rusia dhe BE-ja bien dakord të bashkojnë përpjekjet për të promovuar efiçencën energjitike” Bruksel, 8 Dhjetor 2006, <<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/06/1715&format=HTML&aged=0&language=EN>>.

ndonjë prej sistemeve distributore të energjisë europiane.⁴¹ Duhet të nënvizohet gjithashtu se bashkëpunimi vazhdoi sipas formateve ndërkombëtare si p.sh G8⁴² dhe Traktatit të Kyoto-s. Që prej 2005 Forumi Energjistik Rusi-BE, një platformë gjerësisht industriale, është duke u mbajtur për diskutimin e sfidave dhe perspektivave të bashkëpunimit energjistik brenda komunitetit të biznesit. Kohët e fundit, madje dhe ideja për një hapësirë të përbashkët energjitike me BE-në është përmendur nga Ministri rus i Punëve të Jashtme Alexander Grushko, si “nisja me një lidhje të sistemeve energjitike dhe elektrike si një hap i parë që do të çoj drejt zhvillimit të projekteve infrastrukturore të përbashkëta dhe bashkëpunimeve energjitike të përbashkëta.”⁴³

Pavarësisht përpjekjeve që janë bërë nga të dyja anët, mosmarrëveshjet e mbetura dhe diferencat nxisin praktikën e siguritizimit. Shembulli më i ndezur u bë refuzimi i Lituanisë në prill të 2008 për të rënë dakord për një mandat për KE për të nisur negociatat e post Marrëveshjes së Partneritetit dhe Bashkëpunimit me Rusinë⁴⁴, vetëm në rast se do të merrete garanci nga solidariteti BE-së në lidhje me sigurinë energjitike. Lituania po përballej me (si pasojë e kërkesës së BE për të mbyllur plantacionin nuklear Ingalina) perspektivën e importit të elektricitetit nga Rusia, i vetmi furnizues i mundshëm duke qenë se rrjetet elektrike të Lituanisë nuk janë akoma të lidhura me pjesën tjetër të BE-së. Pra, në fakt, problemi e pati origjinën nga tregu energjistik i pambaruar.

Në lidhje me problemin e tranzitit, BE-ja ka qenë disi e tërhequr për tu angazhuar në mosmarrëveshjet midis Ukrainës

⁴¹ Sipas ekspertës së lartpërmendur të Qendrës BE-Rusi, kushti i liberalizimit nuk e mbyll komplet opsionin për blerjet në tregun European për Rusinë. Mund të ndiqen një numër strategjish për të marr lehtësimë ndërkohë që punon me partnerët tradicional të energjisë; duke frenuar “unitetin” e BE-së.

⁴² Në 2006 me rastin e Presidencës së saj në G8 Rusia shtroi vizionin e vet të sigurisë energjitike i cili përfshinte jo vetëm garanci për konsumatorët por edhe për furnizuesit e energjisë. Për detaje shiko ‘Plani i Veprimit i Sigurisë Energjitike Globale’ në website-in zyrtar të Presidencës ruse të G8 <<http://en.g8russia.ru/docs/11.html>>.

⁴³ “*MID Rossii vistupaet za sozdanie edinogo energeticheskogo prostranstva Rossii i EC*”, 4Nëntor 2008, Vzglyad, delovaja gaseta, <<http://vz.ru/news/2008/11/4/225923.html>>.

⁴⁴ E bllokuar që prej tetorit 2006 si pasojë e vetos polake, e vendosur si përgjigje ndaj ndalimit që Rusia i bëri importeve të mishit nga Polonia.

⁴⁵ Siç u tha dhe nga Ivan Grachev, Vice Presidenti i Komitetit të Energjisë të Parlamentit rus gjatë Seancave të shqyrtimit të Parlamentit European “Siguria Energjitike e BE-së për Evropën.” më 19 Shkurt 2009.

dhe Ruisë. Vetëm gjatë krizës së fundit në 2009 u dërguan vëzhguesit e BE-së në Ukrainë (prezenca e tyre, në fakt, lehtësoi direkt rinisjen e furnizimeve ruse⁴⁵). Problemi kryesor për zhvillimin e një zgjidhje të qëndrueshme për problemin e tranzitit është mungesa e koordinimit midis politikës së BE kundrejt Ruisë nga njëra anë, dhe Ukrainës nga ana tjetër. Politika e BE-së për integrimin e vendeve fqinje transit në tregun e saj energjitik (e ushtruar brenda Politikës Europiane të Fqinjësisë dhe Komunitetit European të Energjisë⁴⁶) nuk e përfshin Rusinë. Kështu për shembull Rusia nuk është ftuar në konferencën për "Modernizimin e Sistemit Transit të Gazit të Ukrainës"⁴⁷.

Një praktikë e tillë e përjashtimit të Ruisë, gjithsesi, nuk të siguron as transitin e furnizimeve europiane as garantimin e sigurisë energjitike të vendeve transit. Politika e Ruisë e diversifikimit të rrugëve të eksportit duke ndërtuar naftësjellës nën det në Detin e Balltikut dhe Detin e Zi rrezikon jo vetëm përfitimet që merren prej tarifave transit, por gjithashtu edhe sigurinë e furnizimeve me energji në të njëjtën mënyrë siç ndodh me vendet anëtare. Kështu që, këto shtete janë duke e parë BE-në si siguroese të një strukture të përbashkët për rregullimin e marrëdhënieve energjitike në këtë zonë dhe, veçanërisht, për tu përballur me Rusinë.⁴⁸ Ukraina madje ka marr një pozicion aktiv duke vënë në tryezë projektin naftësjellësi South Stream⁴⁹ për të kaluar territorin rus duke transportuar energji nga Deti Kaspik përmes Krimeas ukrainase drejt BE-së, dhe duke shërbyer si alternativë e naftësjellësit të Ruisë, White Stream (Ryma e Bardhë). Aspirata të tilla janë prezente ndërmjet një numër shtetesh: për shembull presidentët e Ukrainës, Gjeorgjisë dhe Azerbajxhanit morën pjesë në Samitin e organizuar nga Polonia

⁴⁶Traktati Komuniteti European të Energjisë hyri në fuqi në 2006 duke vendosur një strukturë të vetme rregullatore për tregtimin e energjisë nëpër Europën Juglindore dhe në BE mbi rregulla të njëjta. Ukraina së bashku me Gjeorgjinë, Moldovën, Norvegjinë dhe Turqinë mban aktualisht një status vëzhguesi dhe kanë aplikuar për anëtarësi të plotë.

⁴⁷Konferenca e Investimeve Ndërkombëtare mbi Modernizimin e Sistemit Transit të Gazit të Ukrainës, Bruksel, 23 Mars 2009, Për detaje shiko <http://ec.europa.eu/external_relations/energy/eu_ukraine_en.htm>.

⁴⁸Është e rëndësishme të kihet parasysh se zhvillimi i sektorit të energjisë në vendet transit është në proces e sipër. Për shembull, në 2007 si pjesë e programit ekonomik Kryeministria e Ukrainës J. Timoshenko prezantoi plane për të përfunduar monopolin e furnizuesit të gazit për Ukrainën RosUkrEnergo dhe shoqërisë së përbashkët me Naftogazi-in Ukrainas.

⁴⁹E shtruar nga Kryeministria e Ukrainës Timoshenko gjatë vizitës së saj në Bruksel.

dhe Lituania në maj të 2007 në Krakov për të diskutuar rrugët energjitike që tejkalojnë Rusinë, në veçanti, Naftësjellësin Trans-Kaspik.⁵⁰

Praktikat Politike rreth Burimeve Energjitike të Kaspikut

Çështja e aksesit në burimet energjitike të Kaspikut ka qëndruar në qendër të bisedave të sigurizimit. Burimet e hidrokarbonit në Kaspik përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për rritjen e importeve energjitike të BE-së, kështu, ky rajon është konsideruar si një nga elementet më të mëdhenj të strategjisë së diversifikimit të furnizimit energjistik të BE-së. Sipas Komunikatave të 2003 të Komisionit Europian:

“Çështja kryesore do të jetë të thjeshtëzojnë transportimin e burimeve të Kaspikut drejt Europës, qoftë kjo në rrugë transite nga Rusia ose nga rrugë të tjera transporti. Sigurisht, që rrugët e sigurta dhe të mbrojtura për eksportin e naftës dhe gazit nga Kaspiku do të jenë të rëndësishme për sigurinë e furnizimit me gaz për BE-në si dhe do të jenë kyçe në zhvillimin (ekonomik, por gjithashtu politik dhe social) për rajonin e Kaspikut.”

Gjatë kohës Sovjetike, burimet e gazi dhe naftës në Detin Kaspik qëndruan të paprekura dhe me rënien e Bashkimit Sovjetik çështja e shfrytëzimit të tyre dhe ajo e transportimit tërhoqi vemëndjen e interesave të ndryshme konkurruese. Tubacionet e pakta ekzistuese shkonin drejt veriut, të territorit të Ruisë, përveç tubacioneve që shkonin nga Baku në Suspa, në bregdetin e Detit të Zi në Gjeorgji.⁵¹ Për më tepër, në 2001 Konsorciumi i Tubacioneve të Gazit në Kaspik (CPC), një sipërmarrje e përbashkët e Kazakistanit, Ruisë dhe Omanit, u hap për të sjellë naftë nga fusha e Tengiz në bregdetin e Kazakh të Kaspikut deri në Novorossiysky (prej nga nafta shpërndahej më tej në perëndim nga çisternat).⁵²

Rruga e parë e eksportit nga Kaspiku direkt për në perëndim, naftësjellësi Baku Tsibilis Ceyhan (BTC) u hap jo më parë se

⁵⁰Samiti u konsiderua si i dështuar për shpresat për të reduktuar varësinë e BE-së nga Rusia, si pasojë e marrveshjes së nënshkruar nga Rusia me Kazakistanin dhe Turkmenistanin për shpërndarjen e gazit të Azisë Qëndrore në Europë nëpërmjet naftësjellësit të Gazprom. Shiko *“Putin deal torpedoed Trans-Caspian gas pipeline plans: Kulpash Konyrova 17 May 2007 - Issue : 730, <http://www.neurope.eu/view_news.php?id=73862>.*

⁵¹ Megjithatë, kapacitetet relativisht të ulëta i bëjnë ato të parëndësishme.

⁵² Për detaje, shiko websitin e CPC në <http://www.cpc.ru/portal/alias!press/lang!enus/tabID!3357/DesktopDefault.aspx>

Korriku i 2006. Ky ishte një projekt i mbështetur nga SHBA i dizenuar për të shpërndarë naftë Azeri direkt në bregdetin e Mesdheut në Turqi. Në dhjetor 2006 i njëjti drejtim i eksportit u hap për shpërndarjen e gazit me gazsjellësin e Kaukazit të Jugut që shkonte paralel nga Baku në Tbilisi dhe më tej në brendësi të Turqisë, në Erzum.⁵³ Përfundimisht, me ndërlidhjet Greko-Turke të hapura në fund të 2007 (i cili do të zgjerohet më tej për në Itali) u bë e mundur shpërndarja e gazit në Europë nga Kaspiku.

Megjithatë, projekti kyç i nëndetësve gazsjellës të Trans-Kaspikut që lidhte Azerbajxhanin me Kazakistanin dhe Turkmenistanin, mbeti i papërbushur.⁵⁴ Kështu që, fushat e mëdha të gazit në Azinë Qëndrore mbetën jashtë zotërimit. Roli strategjik i lidhjes së gazsjellësit të Trans-Kaspikut është theksuar nga Komisioneri i energjisë së BE-së Andris Piebalgs, i cili tha se “Tubacionet nga Aktau dhe Turkmenbashi të lidhur me gazsjellësin e Kaukazit të Jugut do të përbënin korridorin e katërt të transportit të gazit në Europë”.⁵⁵ TCP është gjithashtu i lidhur me gazsjellësin Nabucco të promovuar nga BE. I dizenuar për të lidhur tregjet Europiane me burimet energjitike në Kaspik dhe në Lindjen e Mesme, projekti u përball me probleme të mëdha nëse do të kishte mjaftueshëm gaz për të mbushur tubacionet. Dukeqënë se opsioni Iranian nuk do të qëndronte realist për shkak të sanksioneve ndërkombëtare dhe fushat e Azerit janë vlerësuar si të pamjaftueshme,⁵⁶ prespektiva e mbushjes së tubacioneve me gazin e Asisë Qëndrore do të zgjidhte problemet e Nabuccos.

Përkundrejt kësaj problematike, kundërshtimi i Rusisë ndaj TCP dukej si çënim i sigurisë energjitike të BE-së. Në fakt, duke

⁵³ Ky projekt i mbështetur nga SHBA u miratua në mbledhjen e OSCE në Stamboll në 1999 për të reduktuar varësinë e rajonit të Kaspikut nga Rusia në lidhje me eksportin e energjisë

⁵⁴ Fillimisht, projekti u bë pjesë e Gazsjellësit të Kaukazit të Jugut por plani u vu nënë në 2000 për shkak të një sërë arsyesh (duke përfshirë zbulimin e gazit në fushën e Shah Deniz në Azerbajxhan dhe mosmarrveshjeve ligjore me Turkmenistanin mbi zotërimin e fushës Kyapaz/Serdar, si dhe mosmarrveshjet mbi statusin e Kaspikut).

⁵⁵ Komisioneri European i Energjisë Andris Piebalgs gjatë vizitës së tij në Maj të 2006 në Kazakistan, konfirmoi mbështetjen e BE-së për ndërtimin e gazsjellësit Trans-Kaspikut

⁵⁶ Gjashtë kompani kanë shprehur interes në ndërtimin e gazsjellësit dhe punimet janë planifikuar për vitet 2009-2012, megjithatë, vendimi final për investim varet nga tërheqja e furnizuesve për tju përkushtuar sasive të sasisë së gazit që ata do të jenë gati të shpërndajnë (ajo që kërkohet është padiskutim më shumë se 10-15 bc metër kubik për dy vitet e para, por përfundimisht 25-30).

ndjekur mosmarrëveshjen midis Rusisë dhe Ukrainës në Janar të 2006, interesi i gazsjellësit Trans-Kaspik u rizgjua kur Kryeministri i Azeirbaxhanit i ofroi Presidentit të Turkmenistanit Niyasov, të eksportonte gaz nga gazsjellësi i Kaukazit të Jugut në Turqi dhe më tej në tregun European. Në rradhën e tij, Turkmenistani kishte sinjalizuar gjithashtu, qëllimin e tij për tju ribashkuar negociatave për gazsjellësin e Trans-Kaspikut. Për më tepër, gjatë vizitës së tij në Bruksel në Nëntor të 2007, Presidenti i ri Turkmenistan Bardimuhamedov shprehu gatishmërinë e Turkmenistanit për të punuar me më shumë së një partner dhe ftoi investitorët European në vend.⁵⁷

Megjithatë, gjatë Samitit të Vendeve të Kaspikut i organizuar në Moskë në Mars të 2006 ndërtimi i çdo gazsjellësi në Detin Kaspik është bërë subjekt aprovimi prej të pestë vëndet e Kaspikut.⁵⁸ Siç tha dhe Ministri i Energjetikës dhe Industrisë së Rusisë Kristenko, “..risqet ekzistuese teknike, ligjore, dhe mjedisore dhe reziqe të tjera të lidhura me projektin e Trans-Kaspikut janë aq të mëdhaja sa që do të jetë pothuajse e pamundur të gjesh investitor. Vetëm nëse ky është një projekt politik, dhe më pas nuk do të ketë rëndësi çfarë do të ketë brenda gazsjellësit për aq kohë sa ai ekziston”.⁵⁹

Një përqasje e tillë ishte e lidhur ngushtësisht me konsideratat mbi sigurinë, siç ka thënë dhe Ministri i Jashtëm Rus S. Lavrov: “rezistenca ndaj infiltrimit politiko-ushtarak të vendeve të huaja në rajonin e Kaspikut”.⁶⁰ Kjo përfshin dhe angazhimin e Iranit në bashkëpunimin rajonal, në veçanti, duke ndryshuar sjelljen e Iranit në mënyrën sesi i shikon ai komshinjtë e Kaspikut, jo si rival ekonomik por si vende që shqetësohen për ndërhyrje të mundshme nga jashtë duke vënë në rezik sigurinë e rajonit.

⁵⁷ BE-Turkmenistan. Fillimi i një miqësie të bukur”, Europa e Re, Çeshtja 755, 10 Nëntor 2007. E disponueshme në <http://www.europe.eu/rticles/79806.php>.

⁵⁸ Sergei Blagov “ Rusia përpiqet të shkatërroj propozimin për gazsjellësin e Trans-Kaspikut”3/28/06 <http://www.eurasianet.org/departments/insight/articles/eav032806.shtml#>

⁵⁹ e cituar në “Triumfi i Putinit në Marrveshjen e gazit me Turkmenistanin” nga Miriam Elder, St.Ora e Pertërburgut, Maj 15, 2007, e disponueshme në http://www.sptimes.ru/index.php?action_id=2&story_id=21649

⁶⁰ Ai në mënyrë të veçantë theksoi çështje të tilla si shtrëngia e zbraktimit të flocave të treta ushtarake në rajon dhe forcimi i mandimit të përbashkët në mënyrë që të garantohet siguria rajonale, navigimi nën fluturim kombëtar të vendeve bregdetare si dhe miratimi i përbashkët për të përdorur ujrat e Kaspikut, të miratuara gjatë Samitit të dytë, të pestë vendeve të Kaspikut në Teheran në Tetor 2007. Shiko Çeprelli Bekirpa, “Wassernutzung zusammen” ne dotychnym otzonenno-ekonomicheskoy. Mocskanie noecra,N14, 19.10.2007, 13 I disponueshëm në <http://www.arba.ru/news/3325>.

Linja e politikës së Ruisë u konsolidua me marrveshjen midis Ruisë, Kazakistanit dhe Turkmenitanit e nënshkruar në Maj të 2007 në drejtimin e eksportit të gazit nga Azia Qëndrore për në Rusi. Kjo marrëveshje përcaktoi volumin e eksportit (30 milion metër kubik për vit për pesë vite) duke përfshirë artikuj në lidhje me rinovimin dhe zgjerimin e ekportit të gazsjellësit.⁶¹

Ndërsa marrveshja u vlerësua gjërësisht nga komentatorët e Europës si hapat e Ruisë në ndërtimin e aleancës së gazit sipas stilit të OPEK-ut në Azinë Qëndrore, si dhe u konsiderua si një 'lajm i keq' për mundimin e Europës për të reduktuar varësinë e saj energjitike ndaj Ruisë,⁶² sipas Komisionerit të Energjisë për Europën Piebalgs, marrëveshja nuk cënonte gazsjellësin e Trans-Kaspikut.⁶³ Komisioni vazhdoi të ndërmernte studimë fiziologjike dhe në Qershor 2009, 200 milion Euro u vunë në dispozicion për gazsjellësin e Nabuccos si pjesë e paketës prej 2.37 bilion euro për përmirësimin e lidhjeve të gazit dhe atyre elektrike në BE.⁶⁴

Megjithatë, problemi është fakti që BE-ja duket se ka mundësi të kufizuara në fushën e politikave energjitike dhe diplomatike. Siç nxirret në pah dhe nga Kristofer Ross, Oficeri i Politikave për Azinë Qëndrore në Direktoratin e Energjitikës të Komisionit European, "BE-ja nuk mund të financojë investime apo të jetë partnere me kompanitë. "shtë (vetëm) e përfshirë në ndërmarrjen e studimeve dhe zhvillimin e projekteve, financimin e infrastrukturës

⁶¹ Dega Perëndimore e gazsjellësit të qëndrës të Azis-Qëndrore të Gazpromit, i ndërtuar në 1974, me një kapacitet prej 10 bilion metër kub (për vit) do të rindërtohet dhe do të ndërtohet një gazsjellës paralel me bregun e Kaspikut.

⁶² AFJ Lajme Të Limituara, "Rusia, Turkmenistani, Kazakistani ranë dakord në nënshkrimin e marrëveshjes së gazsjellësit" 13.05.2007. E disponueshme në <http://www.finanznachrichten.de/nachrichten2007-05/8231965-russia-turkmenistan-kazakhstan-agree-landmark-gas-pipelinedeal-020.htm>.

⁶³ I deleguari i Komisionerit, Ferran Tarradellas Espuny, cituar nga New Europe. Shiko "BE-Turkmenistan: Fillimi i një miqësie të bukur", New Europe, 10 Nëntor 2007-Issue : 755 <<http://www.neurope.eu/articles/79806.ph>>.

⁶⁴ Ky financim është pjesë e planit 5 bilion euro të rindërtimit ekonomik të Europës për tu rimëkëmbur nga kriza. Gjithashtu ajo përfshin mbështetje për zhvillimin e pastër të qymyrit dhe kapacitetit të energjisë së erës si dhe jep 1 bilion për të zgjeruar lidhjet e internetit dhe zhvillimin rural. Për informacion të mëtejshëm shikoni shypin e lëshuar nga Parlamenti European: MEP jep dritë jeshile për rimëkëmbjen ekonomike te BE-së 06.05.2009, I disponueshëm në <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/09/142&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>.

së re energjitike dhe mirëmbajtjen e projekteve si plane diversifikimi...Për më tepër, BE-ja është e ngadaltë dhe burokratike dhe përfundimisht i mungon përqasja strategjike që nevojitet për të gjetur garantues të mjaftueshëm për të tërhequr investitorë të mëdhenj për ndërtimin e tubacioneve.”⁶⁵

Ndërsa konsiderojmë BE-në si partner për vendet e Azisë Qëndrore, duhet të kujtohet se këto vende (veçanërisht Turkmenistani në të cilin eksporti gazit përbën kontributin më të madh të GDP-së) përgjithësisht kanë nevojë për investime të mëdha. Ata janë duke kërkuar për veprime të shpejta për projekte dhe kontrata në mënyrë që të zhvillojnë infrastrukturën për shfrytëzimin dhe transportimin e burimeve të tyre natyrore. Në lidhje me këtë, Presidenti i Kazakistanit Nursland Nazarbayed vlerësoi akordin e Maj 2007 me Rusinë sikur kishte një racionalitet pragmatik të fortë dhe duke ofruar përfitime të konsiderueshme ekonomike për të gjithë pjesëmarrësit, “Ndërkohë që nuk ka alternativa afat shkurtër, marrveshja garanton eksportet për Turkmenistanin, ndërsa Kazakistani gjithashtu do të përfitojë nga projekti i ri duke marrë para nga gazi tranzit që vjen nga Turkmenistani nëpërmjet territorit të tij”.⁶⁶ Në të njëjtën linjë, Drejtori i Përgjithshëm i Kazakistanit, Martin Ferstl tha se marrëveshja hap “një skenar të ri për gazin e Azisë Qëndrore...do të ketë një impakt pozitiv në situatën e furnizimit me gaz në Kazakistan, Rusi, dhe gjithashtu shpresoj dhe për Europën”.⁶⁷

Kështu që, në dy vitet e fundit, mund të gjenden një numër shembujsh të një përqasje të orientuar drejt integritimit në çështjen

⁶⁵ “Zhvillime të reja në energjinë Euroaziatike: risqet dhe mundësitë“ tavolinë e rimbullakët e organizuar nga Qendra BE-Rusi, Shoqata e Këshilltarëve Ndërkombëtar për Rusinë dhe Euroazinë (ASIARE) dhe Instituti European për Studimet Aziatike (EIAS).

⁶⁶ Projekti i rinovuar i gazsjellësit është i një interesi të veçantë për Turkmenistanin ku industria e gazit dhe tubacioneve ekzistuese janë në kushte teknike të mjerueshme dhe kanë nevojë për investime të mëdha kapitali, ndërkohë që Rusia dhe Kazakistani, në mënyrë që të sigurojë investimet e nevojshme, do të fitoj akses në zhvillimin në fushave të reja të gazit dhe vajit në sektorin Turkmen të rajonit të Kaspikut. Për më tepër, pas negociatave të gjata, Rusia më në fund ra dakort të rrisi çmimin e gazit të Kazakistanit nga 60 në 145 dollar (duke lënë përfitime të konsiderueshme për Gazpromin duke marr parasysht se çmimi përfundimtar për eksportimin e gazit për Bashkimin European është vendosur rreth 220-250 dollar për 1000 metër kub). Shiko Kulpash Konyrova “Putin merret me planet e tubacioneve të gazit të Kaspikut”, New Europe, Issue 730, 17 May 2007. Available at <http://www.neurope.eu/view_news.php?id=73862>..

⁶⁷ Ibid.

e furnizimeve të Kaspikut. Për shembull, në raportin e vlerësimit të strategjisë energjitike të BE-së, Anëtarja e Parlamentit European Anne Laperrouze po konsideron të ftojë Rusinë ti bashkangjitet projektit të Nabuccos.⁶⁸ Një tjetër shembull është ai i samitit të organizuar në Sofje në Prill 2009 në mënyrë që të zgjidhte mosmarrëveshjet rreth projektit të South Stream.⁶⁹ Duke akomoduar projektin e gazsjellësit Rus në opinionin publik të Europës, korniza e samitit bëri të mundur një pozicionim të mirë për Bullgarinë në negociimin e kushteve të pjesëmarrjes së saj në projekt me Gazpromin.

Përfundime

Mund të arrihet në përfundimin se, megjithësë përqsja e politikave të BE-së drejt marrdhënieve energjitike me Rusinë është frymëzuar nga diskutimi i integritit, në praktik marrdhëniet energjitike midis BE-së dhe Ruisë mund të karakterizohen si të drejtura nga arsye sigurie. Diskutimi mbi sigurizimin është përkthyer gjërësisht në praktika politike të marrdhënieve të jashtme energjitike të BE-së, duke përfshirë ato të institucioneve të BE-së dhe të vendeve anëtare, duke ngadalësuar zhvillimin e një politike të orientuar integrimi përkundrejt Ruisë.

Në rradhë të parë, përhapja e praktikave politike të integritit pengohet nga natyra e papërfunduar e tregut të brendshëm që akoma ka mangësi të infrastrukturës fizike për të lidhur tregjet e ndryshme kombëtare (në mënyrë të veçantë, në drejtimin perëndim-lindje, midis vendeve anëtare të rinj dhe të vjetër). Kjo është një pengesë e madhe për zhvillimin e një pozicioni të përbashkët në marrdhëniet energjitike me Rusinë. Siç u demonstrua dhe në krizën e fundit të ndërprerjes së energjisë në Janar të 2009, bashkëpunimet energjitike luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e energjisë. Në mungesë të një tregu energjistik europian të vetëm, liberal dhe të ndërlidhur, vendet e varura nga gazi rus do të mbeten me opsione diversifikimi të vogla. Për më tepër, ndërkohë që aspekti i jashtëm i marrëdhënieve energjitike të BE-së mbeti subjekt i politikave kombëtare të 27 vendeve anëtare, Komisioni European nuk ka kompetenca të mjaftueshme në fushën e marrëdhënieve

⁶⁸ "Debatet e BE-së për ftesën e Ruisë në projektin e Nabuccos", 2 Shkurt 2009 http://www.euroactiv.com/en/energy/eu-debates-inviting-russia-joinnabucco/article-179060?_print

⁶⁹ "Tensione për South Stream, por samiti i energjisë ishte një sukses". Prill 26, 2009 http://sofiaecho.com/2009/04/26/710750_tensions-about-south-stream-butenergy-summit-a-success

energjitike të jashtme. Ai po bën përpjekje për të promovuar integrimin e tregjeve energjitike me vendet përreth BE-së. Megjithatë, këto mundime janë në përgjithësi të limituara në bashkëpunimin teknik dhe identifikimin dhe mbështetjen fillimisht të projekteve të infrastrukturës, ndërkohë që një përjasje strategjike drejt furnizuesve më të mëdhenj të energjisë për BE-në akoma mungon.

Përkthimi i dialogut të integritit në praktika politike është veçanërisht i vështirë në bashkëpunimin mbi çështje të politikave të tranzitit dhe tubacioneve rreth burimeve energjitike të Kaspikut. Por, megjithëse BE-ja më në fund ka filluar të impenjohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Ruisë dhe Ukrainës për trazitën e gazit rus në Europë, nuk ka pasur një koordinim midis përjasjeve politike të BE-së mbi të dyja vendet. Si rezultat, masat e marra për të mbështetur infrastrukturën tranzit Ukrainase të gazit rus mund të mos kenë efektet e dëshiruara për të siguruar furnizimin europian. Në të njëjtën linjë, politizimi i projektit të gazsjellësit të Nabuccos nuk shërbeu në progresin mbi çështjen kryesore të lidhjes së trans-Kaspikut. Kështu që, meqënëse projektet prioritare të tubacioneve të gazit për BE-në janë të limituara nga afërsia direkte me BE-në, ato nuk zgjidhin domosdoshmërisht problemin e sjelljes së furnizuesve të rinj në BE, as avancojnë marrëdhëniet me vendet furnizuese. Siç është konfirmuar gjatë takimit të “Korridorit të Jugut” organizuar nga Presidenca Çeke në Maj 2009 me qëllimin për të krijuar kushte të reja për të shpërndarë gazin e Kaspikut, në veçanti për të mbështetur projektin e Nabuccos, vendet e Asizë Qendrore nuk janë gati të ndërmarin angazhime për eksport.

Tendenca e sigurimit është më pak e pranishme në kontekstin e bashkëpunimit BE-Rusi mbi çështje të brendshme, siç është zhvillimi i tregjeve të energjisë, efiçenca energjitike dhe planifikimi strategjik. Në fakt, të dy partnerët janë njësoj të interesuar në modernizimin e sektorit rus të energjisë dhe bashkëpunimi funksional po ecën në rrugë të mbarë brenda strukturës institucionale të Dialogut Energjitik. Situata është më e vështirë në kuadër të bashkëpunimit të përgjithshëm. Ndërkohë që, Rusia mund ti rezistojë adoptimit të modelit të tregut Europian, fokusi i saj mbi reciprocitetin rast pas rasti nuk do të jetë drejtues për transferimin e teknologjisë dhe inovacioneve në shkallë të gjerë, të nevojshme për zëvendësimin infrastrukturës së dalë jashtë përdorimit. Me vendosjen e Marrëveshjes së re të Partneritetit dhe Bashkëpunimit dhe qëndrimin e rëndë të Ruisë mbi ratifikimin e Kartës së Energjisë, ka një pasiguri të madhe mbi të ardhmen e bashkëpunimit dy-palësh si dhe mbi kornizën e

përgjithshme regulluese të marrdhënieve energjitike multilaterale në kontinentin Euroaziatik.

Mund vetëm të pritet që kristalizimi i politikave të jashtme energjitike të BE-së do të pajtojë të dyja diskutimet dhe të bëjë të mundur një prespektivë më të qartë për politikën energjetike të BE-së drejt Rusisë. Ndërkohë, marrëdhëniet energjitike të BE-së me Rusinë do të vazhdojnë të influencohen nga praktika të ndryshme (konkurreuese), ndërsa Rusia, në radhët e saj, do të vazhdojë të ndërtojë marrëdhënie energjitike me secilin vend anëtar të BE-së.

BIBLIOGRAFIA

- Belyi, Andrey V. (2008) "EU External Energy Policies: A Paradox of Integration", in Orbie, Jan ed. *Europe's Global Role. External Policies of the EU*, Ashgate, pp. 203-217
- Bochkarev, Danila (2006) *Russian Energy Strategy in Making: General Trends and Political Implications*, IEE document 40, UCL Press Universitaire de Louvain
- Dodonov, Boris (2003) "Energy aspects of EU enlargement on "Direct Neighbourhood" in Kempe, Iris ed. *Prospects and Risks beyond EU Enlargement. Eastern Europe: Challenges of a Pan-European Policy*
- Ebel, Robert and Menon, Rajan, eds. (2000) *Energy and conflict in Central Asia and the Caucasus*, Lanham (Md.): Rowman and Littlefield
- Elletson, Harold and Rosner, Kevin eds. (2006) *Baltic independence and Russian foreign energy policy*, London: GMBDescr
- Gault, John (2004) "EU Energy and the periphery" in Dannreuther, Roland, ed. *European Union Foreign and Security Policy: Towards a Neighbourhood Strategy*, Routledge, London, pp.170-186
- Goldthau, Andreas "Improving Russian Energy Efficiency: Next Steps", in *Energy Efficiency. Russian Analytical Digest No.46*, 25 September 2008
- Available at www.res.ethz.ch

- Grace, John D. (2005) *Russian Oil Supply. Performance and prospects.* Oxford : Oxford university press
- Hadfield, Amelia (2006) *EU Foreign Energy Policy: In the Pipeline? CFSP Forum, Vol.4, issue 1*
- Helm, Dieter (2006) *Russia's energy policy: politics or economics? Published on 16.10.2006 Available at http://www.opendemocracy.net/globalizationinstitutions_government/russia_energy_4004.jsp (accessed 18.01.2008)*
- Helm, Dieter (2007) *The Russian Dimension and Europe's external energy policy*, Oxford University. Published 3 September 2007
- Larsen, H. (2004) "Discourse analysis in the study of European foreign policy", in Tonra, Ben and Christiansen, Thomas eds. *Rethinking European Union Foreign Policy*, Manchester University Press
- Lavenex, Sandra (2004) "EU External Governance in Wider Europe", in *Journal of European Public Policy*, Vol. 11, No 4, pp.680- 700.
- Lipponen, Juho (1999) *Energy in the Northern Dimension - Opportunities and Unanswered Question in Haukkala Hiski, ed. Dynamic aspects of the Northern Dimension* Turku,
- Narbutiene, Neringa (2007) "Energy Supply Security in the Context of Electricity Market Liberalisation: The Baltic Region Case", in Archer, Clive, ed., *The Northern Dimension of the European Union: Glancing Back, Looking Forward*. Proceedings from the Northern Dimension Network, Technologija, Kaunas, pp. 78-85
- Nies, Susanne "Nabucco et South Stream –des gasoducs trops politisees ?" L'édito du programme Énergie - Mars 2008. Available at http://www.ifri.org/frontDispatcher/ifri/publications/actuelles_de_l_ifri_1197584475485/publi_P_actuelle_edito_dec___1204898510681?view=popupActuelle
- "New developments in Eurasian energy: risks and opportunities" Roundtable organised by EU-Russia Centre, the Association of International Advisors for

Russia and Eurasia (ASIARE) and the European Institute for Asian Studies

(EIAS)

Noel, Pierre (2008) *Beyond dependence: how to deal with Russian gas*. Policy

Brief, European Council on Foreign Relations, November 2009. Available at www.ecfr.eu

Perovic, Jeronim and Orttung, Robert (2007) "Russia's Energy Policy", in

Russian Analytical Digest No.18, 3, April 2007. Available at www.res.ethz.ch

Romanova, Tatiana (2008) The Russian Perspective on the Energy Dialogue

Journal of Contemporary European Studies, 16, 2 : 219-230

Rutland Peter (2000) "Paradigms for Russian Energy policy in the Caspian

Region" in Ebel, Robert and Menon, Rajan, eds. *Energy and conflict in Central*

Asia and the Caucasus, Lanham (Md.): Rowman and Littlefield, pp.163-186

Russia's New Energy Frontiers. Russian Analytical Digest No.33, 22 January

2008 Available at www.res.ethz.ch

Stern, Jonathan (2006) "Natural Gas Security Problems in Europe: the Russian-

Ukrainian Crisis of 2006" *Asia-Pacific Review*, Vol. 13, No. 1

Vahtra, Peter (2005) "Russian Investments in the CIS – Scope, Motivation and

Leverag. Manuscript of the Pan-European Institute, Turku School of Economics, No. 9

Woehrel, Steven (2008) *Russian Energy Policy Toward Neighboring Countries*,

CRS Report for Congress, Updated March 27, 2008. Available at <http://www.fas.org/sgp/crs/row/RL34261.pdf>

Dokumente Zyrtare

Barroso, José Manuel (2007) Opening remarks at press conference on the

Commission's energy package "*Energising Europe: a real market with secure supply*", Brussels, 19 September 2007

European Commission /SG/HR for the European Council (2006) PAPER

"An external policy to serve Europe's energy interests", 15-16 June 2006, S160/06

http://ec.europa.eu/dgs/energy_transport/international/doc/paper_solana_sg_energy_en.pdf

European Commission (2004) COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN COUNCIL AND THE Europeanparliament: "The Energy Dialogue between the European Union and the

Russian Federation between 2000 and 2004", COM(2004) 777 final, Brussels,13.12.2004,

http://ec.europa.eu/energy/russia/reference_texts/doc/2004_0777_en.pdf

European Commission (1995) WHITE PAPER *"An Energy Policy for the*

European Union", 13 December 1995, COM (95) 682 final

European Commission (2000) GREEN PAPER *"Towards a European Strategy for the Security of Energy Supply"*, 29 November 2000, COM (2000) 769 final

European Commission (2003) COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN COUNCIL *"The Development of Energy*

Policy for the Enlarged European Union, its Neighbours and Partner Countries",

Brussels, 26.5.2003, COM(2003) 262 final/2

European Commission (2006) GREEN PAPER *"A European Strategy for Sustainable, Competitive and Secure Energy"*, 8 March 2006, COM(2006) 105 final European Commission (2006a) COMMUNICATION FROM THE

COMMISSION TO THE EUROPEAN COUNCIL, *"External energy relations – from principles to action"*, Brussels, 12.10.2006, COM (2006) 590 final European Commission (2007) COMMUNICATION FROM THE

COMMISSION TO THE EUROPEAN COUNCIL AND THE EUROPEAN PARLIAMENT *"An Energy policy for Europe"*, Brussels, 10.1.2007 COM (2007) 1 final

European Commission (2008) *Communication From The Commission To The*

European Parliament, The Council, The European Economic And Social Committee

And The Committee Of The Regions "Second Strategic Energy Review : an EU energy security and solidarity action plan", Brussels, 13.11.2008 COM/(2008)0781 final

European Council (2007) Presidency Conclusions, Action Plan 2007-2009

- "Energy Policy for Europe"*, Brussels, 8/9 March 2007
- European Council (2004) DIRECTIVE *"Concerning measures to safeguard security of natural gas supply"*, 2004/67/EC of 26 April 2004
- European Parliament Committee on Foreign Affairs, Public Hearing
- "Towards a common European foreign policy on energy?"* 28 February 2007—
- Brussels INI/2007/2000: 26/09/2007-EP: non-legislative resolution.
- Available at
<http://www.europarl.europa.eu/oeil/resume.jsp?id=5430272&eventId=1009084&backToCaller=NO&language=en>
- Ferrero-Waldner, Benita (2006) Concluding remarks at a Conference *"Towards an EU External Energy Policy to Assure a High Level of Supply Security"*,
 SPEECH/06/725, Brussels, 21 November 2006
- Piebalgs, Andris (2007) Speech At The High Level Conference On Nabucco
"Nabucco Pipeline And Security Of Supply", Speech/07/531, Budapest, 14 September 2007
- Press Release *"Developing external energy policy for the EU"* MEMO/07/533
 Brussels, 30 November 2007. Available at <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=MEMO/07/533&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>
- Press Release *"Energising Europe: A real market with secure supply"*
 MEMO/07/361, 19/09/2007. Available at <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=MEMO/07/361&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>
- Press Release *"Russia and the EU agree to join efforts to promote energy efficiency"* Brussels, 8 December 2006. Available at <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/06/1715&format=HTML&aged=0&language=EN>

Dušan Janjiæ

SIGURIA ENERGETIKE DHE KONFLIKTI ETNIK – SFIDAT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Hyrje

Në fund të shekullit të kaluar, një stuhi e vërtetë gjeo-politike goditi botën, dhe në veçanti Evropën dhe shtetet e saj të mëparshme komuniste. Kushtet, pasojat dhe, veçanërisht, efektet e kësaj stuhie ende nuk janë kuptuar plotësisht, por influenca e saj në politikën globale po bëhet gjithnjë e më tepër e dukshme. Në qendër të kësaj stuhie qëndronte nevoja për të siguruar energjinë si bazë e jetës dhe zhvillimit të një shoqërie moderne.

Fuqia e saj dinamike kryesore ishte etniciteti, nën maskën e zgjimit të forcës së identifikimit kombëtar dhe lëvizjeve entonacionaliste. Kufijtë e vjetër dhe të ndaluar u shfaqën si një element statik që përfunduan si humbës në këtë zhvendosje. Në vend të kufijve të padhunueshëm, çështja kryesore u bë çështja e kufijve të jashtëm porozë ose të dobët, duke përcaktuar caqet e shteteve përballë kufijve të brendshëm të fortë e rezistentë, dhe etnicitetin dhe ndarjet etnike në shoqëri (për shembull, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova ose Maqedonia në Ballkanin Perëndimor, kufijtë Izrael-Palestinë në Lindjen e Mesme, kufijtë Turqi-Greqi në Qipro, etj.).

Për shkak të paqëndrueshmërisë në Lindjen e Mesme, luftërave në Afganistan dhe Irak, dhe një lufte të mundshme kundër Iranit, çështja e 'sigurisë energjetike' është bërë një prej çështjeve më domethënëse në marrëdhëniet e sotme

* **Dr. Dušan Janjiæ** është një kërkues i lartë shkencor në Institutin për Shkenca Sociale në Beograd dhe koordinator i Forumit të Marrëdhënieve Etnike.

Ky artikull është publikuar si pjesë TransConflict, një iniciative të re të sapo nisur, [TransEnergy](#), e cila synon të stimulojë debatin dhe diskutimin në lidhje me çështjet e sigurisë energjetike, veçanërisht ato që i përkasin Ballkanit.

ndërkombëtare. Kjo është veçanërisht e dukshme nga ndikimi i rritjes së çmimit të naftës, që u trefishua në periudhën 2005-2008. Në këtë kontekst, roli i Rusisë, eksportueses më të madhe të energjisë në Grupin G8 të kombeve më të industrializuara, është thelbësor. Perëndimi është jashtëzakonisht i shqetësuar për gatishmërinë e Rusisë për të përdorur energjinë si një armë në politikën e jashtme, siç ndodhi në rastin e vitit 2006 kur Rusia pezulloi në mënyrë të menjëhershme shpërndarjen e naftës në Ukrainë, si përgjigje ndaj politikave të perceptuara si pro-perëndimore të fqinjëve të saj.

Rusia e Vladimir Putinit është shndërruar në një sfidë ekonomike globale, e cila ka një influencë të fuqishme në themelimin e tregut ndërkombëtar. Është e sigurt se vendimi i Putinit i vitit 2002 – për të ndryshuar strategjinë për marrëdhëniet me perëndimin në sektorin e energjisë – u influencua në mënyrë domethënëse nga vendimi i Mikhail Khodorkovsky për t'ja shitur kompaninë e tij të naftës, Yukos, blerësve amerikanë, po ashtu edhe nga shfaqja e “revolucioneve të ngjyrave” në Gjeorgji dhe Ukrainë; dy vende të rëndësishme të kalimit të naftës ruse për në BE, dhe dy vende të konsideruara nga Moska si sfera të saja të influencës.

Rusia e Putinit po përpiqet të heqë trashëgimitë e saj negative të periudhës së ekonomisë së planifikuar të BRSS-së. Në atë kohë, shteti ndante atë që natyra sillte bashkë – naftën dhe gazin – përmes formimit të dy ministrive të ndara dhe dy sistemeve të menaxhimit për këto burime. Kjo i dha një detyrë të fuqishme Rusisë post-Sovjetike. Për sa i përket gazit, Rusia kishte trashëguar një sistem të centralizuar të kontrolluar nga Gazprom. Megjithatë, prodhimi i naftës, menaxhohej nga disa entitete, nga entitetet qendrore që merreshin kryesisht me përmbushjen e qëllimeve dhe nga udhëheqës që menaxhonin prodhimin. Kompani, si Lukoil, u formuan në nivelin e burimeve lokale të përqendruara përreth rafinerisë. Në të njëjtën kohë, transporti, infrastruktura dhe eksporti i naftës ishin në duart e qeverisë qendrore, e cila vepronte në mënyrë të pavarur nga prodhuesit. Në rrethana të tilla, ishte relativisht shumë e lehtë të privatizohej prodhimi i naftës. Për pothuajse katër vjet, mbi 65% e furnizimit, prodhimit dhe përpunimit të naftës i shkoi sektorit privat.

SHBA po bën presion mbi aleatët e saj të NATO-s për të marrë një rol udhëheqës në sigurimin e rrugëve të transportimit të energjisë dhe, mbi të gjitha, për sigurimin e për afërsisht 5,200 km tubacione nafte, që transferojnë lëndë djegëse nga Evropa Lindore në atë Perëndimore. Vendet Balltike – të ndjera në rrezik si pasojë e fuqisë ruse në fushën e gazit natyror – favorizojnë projektin amerikan. Nga ana tjetër, Parisi, Berlioni, Moska dhe

Oslo e kanë kundërshtuar këtë projekt. Ato perceptuan se një rol i tillë për NATO-n do të zgjeroj së tepërmi sferën e misioneve të Aleancës, duke i dhënë potencialisht liri veprimi të mëtejshme ndërhyrjes së pakontrolluar ushtarake të SHBA.

Duke e gjetur veten në një udhëkryq të veçantë ndërmjet Kaukazit dhe Evropës, dhe kufijve të Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, vendet e Ballkanit janë – për shkak të vlerave të pozicionit të tyre gjeo-strategjik – një element thelbësor në dilemën e sigurisë energjetike të Evropës. Paqja dhe stabiliteti në këtë rajon, që është prekur nga konflikti etnik në fund të shekullit të kaluar dhe që përballet ende me disa rreziqe, është thelbësore, në mënyrë që të garantohet siguri i furnizimit me naftë dhe gaz për BE-në.

1. Energjia dhe Siguria në Shekullin 21

Vlerësimi Botëror i Energjisë e përkufizon sigurinë energjetike si 'disponueshmërinë e energjisë në çdo kohë dhe në shumë forma, në sasi të mjaftueshme, dhe me çmime të përballueshme'.¹ Të katër elementët e listuar për sigurinë energjetike – disponueshmëria në çdo kohë, në të gjitha format, sasia e mjaftueshme dhe përballueshmëria – përfaqësojnë çelësin e stabilitetit, dhe nëse nuk përmbushen të gjithë këta faktorë, rezultati i menjëhershëm është paqëndrueshmëria. Megjithatë, ka një numër çështjesh dhe sfidash të cilat gjithashtu duhen përmbushur, si diversifikimi i furnizimit, një rrymë e pandërprerë e furnizimit (d.m.th siguria fizike e transportimit dhe infrastrukturës), infrastrukturë e kënaqshme transportuese dhe korridore të besueshme transporti.

Ndërsa çështja e sigurisë energjetike ka qenë një shqetësim politik në të shkuarën, çështja e energjisë është bërë vetëm së fundmi një çështje shumë e debatuar publikisht; shpesh e diskutuar jo vetëm në qarqet e ekspertëve dhe forumet socio-politike dhe ekonomike, por edhe si pjesë e diskutimit të përgjithshëm publik. Pa diskutim, çështja e energjisë ka qenë gjithmonë në krye të agjendës politike dhe ekonomike të çdo administrate shtetërore, por kjo çështje nuk ka provokuar kurrë më parë një lëvizje globale dhe një shqetësim të tillë si në fillim të shekullit të 21. Organizatat kombëtare, ndërkombëtare dhe ndërqeveritare si dhe organizmat botërorë e kanë pozicionuar çështjen e sigurisë energjetike si prioritetin e tyre kryesor. Madje edhe NATO është presionuar seriozisht nga disa nga anëtarët e saj për të përfshirë sigurinë energjetike në mandatin e saj dhe për t'i kushtuar pjesë të

kapaciteteve të saj, kësaj detyre domethënëse. Në samitin e Bukureshtit në Prill 2008, përfaqësuesit e shteteve anëtare përmendën një raport mbi “Rolin e NATO-s në Sigurinë Energjitike”, i cili identifikon parimet udhëheqëse dhe nënvizon mundësi dhe rekomandime për aktivitetet e së ardhmes.

Rreth 40% e nevojave të gazit të BE-së plotësohen nga Rusia, që është dy e treta e eksporteve totale të gazit rus. Rusia është burimi importit i pothuajse një të tretës së naftës dhe një të katërtës të qymyrit për në BE. Kompanitë nga BE-ja janë investitorët më të mëdhenj të huaj në sektorët e naftës, gazit si dhe të elektricitetit rus. Këto lidhje të fuqishme ndërmjet BE-së dhe Ruisë në sektorin e energjisë janë një pjesë integrale e marrëdhënieve politike, ekonomike dhe të sigurisë të cilat po bëhen gjithnjë e më tepër komplekse dhe të vështira. Kjo inkurajon ndërgjegjësimin mbi nevojën për të diversifikuar burimet e energjisë së BE-së. Kjo u pa qartësisht në dimrin e vitit 2006 dhe 2009 kur Rusia pezulloi përkohësisht shpërndarjen e gazit përmes Ukrainës, në përpjekjen për të shtuar presionin mbi Ukrainën për të shlyer borxhet e saj, por edhe për të treguar fuqinë e saj, BE-së si dhe Shteteve të Bashkuara; cka domethënë se, BE-ja është e lidhur me Rusinë, pothuajse si në kohën e Luftës së Ftohtë.

Megjithatë, BE-ja po lufton ende për të arritur këtë gjë, pjesërisht për shkak të mungesës së një politike të përbashkët energjitike. Përsa i përket pjesës tjetër, shtetet e BE-së po përpiqen të evitojnë ndërvarësinë e theksuar nga nafta dhe gazi rus, duke investuar dhe punuar për zhvillimin e një kanali për sigurimin e burimeve të Kaspikut, duke vështruar në mundësitë e OPEC-ut, si edhe vlerësuar mundësitë e kontinentit Afrikan. Një grup i madh i projekteve energjetike si tubacioni Nabucco, PEOP, INOGATE, rrjeti i ardhshëm elektrik evropian, programi për zhvillimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë i mbështetur nga BE-së, projekti i Spanjës për të sjellë stacionin më të madh termo-solar të Evropës, ndërmjet iniciativave të tjera, portretizojnë nevojën e dëshpëruar të Evropës për të diversifikuar jo vetëm burimin energjistik por edhe tipin e energjisë. Prandaj, politika e diversifikimit shkon përtej sigurisë energjitike dhe bëhet një pjesë thelbësore e sigurisë (ndër)kombëtare.

2. Siguria Energjitike në Ballkanin Perëndimor

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, lajmi për ripërtëritjen dhe rikthimin e Ruisë – kësaj rradhe përmes marrëveshjeve energjitike – u prit me kujdes dhe vëmendje të madhe. Nuk ishte

frika e zgjimit të 'ariut rus', duke qene se ekziston një perceptim i përbashkët se a) 'ariu' është ende shumë i lodhur nga ripërtëritja e përvojës së hidhur të BRSS dhe b) Evropa Juglindore dhe Ballkani Perëndimor janë të paarrtshme nga kthetra e tij, por ishte frika më tepër nga influenca indirekte. Për më tepër, ky rikthim i Rusisë në Evropë shihet si një mjet politik i shkathët dhe i pabesë, pjesë e agjendës së saj të fshehur për të rivendosur influencën e saj ekonomike dhe politike në rajon, veçanërisht kur dihet gjerësisht se tregu energjitik rus funksionon nisur nga një logjikë politike dhe jo nga ajo e tregut.

Reagimet e lëvizjes ruse në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë qenë edhe më të acaruara. Lajmet për marrëveshjen energjitike Serbi-Rusi, si edhe për marrëveshjen me Bullgarinë janë parë me një maturi të madhe dhe janë analizuar nga pikëvështrimi i krizës së Kosovës. Besohet se prezenca ruse në rajon është fillimi i "një faze tërësisht të re në zgjidhjen e krizës, në të cilën Serbia ka tentuar sërish të destabilizojë situatën përmes nxitjes së re të dhunës dhe kërcënimit të konflikteve të reja, madje edhe kundër forcave të OKB-së në pjesën veriore të Kosovës, duke besuar se kjo do ta tërheqë më drejtpërdrejt Rusinë në konflikt".

Frika se vendosja e energjisë ruse në Evropën Juglindore, dhe kryesisht në Serbi, shkon përtej fizibilitetit ekonomik dhe politik, dhe që padyshim do të përfundojë në provokimin e problemeve serioze të sigurisë, konflikt(eve) të fshehura dhe ndryshimeve të mundshme të kufijve, bëhet gjithnjë e më e madhe pas konfliktit në Gjeorgji. Pas analizimit të mundësive të marrëveshjes, llogaritjes së kostove dhe përfitimeve të saj, një numër ekspertësh e vunë fuqishëm në dyshim fizibilitetin e marrëveshjes ruse me Serbinë, ndërsa kundërshtuan nënvlerësimin e perceptuar të Industrisë Petroleum të Serbisë (këtu e më poshtë, NIS), dhe procesit të paqartë përmes së cilit *Gazprom* do të investojë në modernizimin e sektorit të energjisë.

Gjendja e vështirë e sigurisë energjitike të Ballkanit Perëndimor është e ngjashme dhe, në një masë të caktuar, influencon atë të BE-së. Ka një besim të theksuar në naftën dhe gazin rus. Vetëm në 2006, Federata Ruse e furnizoi Evropën Jug-Lindore me 73 bilion metër kub gaz dhe 59 milion ton naftë. Shpërndarësi kryesor i gazit natyror për Serbinë është Rusia, ndërsa sasi më të vogla importohen nga Ukraina dhe Gjermania. Për shkak të vjedhjes së vazhdueshme të gazit natyror që tranzitohet nga Rusia, Ukraina konsiderohet si e dyshimtë në terma të furnizimit të pandërprerë dhe në kohë, duke rritur rrezikun e disponueshmërisë energjitike. Gazi rus kalon përmes tubacioneve të gazit në Hungari, duke e bërë atë më të shtrenjtë

në bazë të marrëveshjes së vitit 1977 e cila rrit çmimin për transitin. Pritet që përfundimi i gazsjellësit South Stream (Rryma e Jugut) të reduktojë në mënyrë të ndjeshme koston e gazit për Serbinë.

Zhvillimi i sektorit të energjisë perceptohet shpesh si një lojë me shumë-zero në rajon, dhe prezenca më agresive dhe në rritje e Ruisë mund të acarojë tensionet që tashmë ekzistojnë. Në veçanti, mbështetja e Ruisë për Serbinë dhe vendimi i saj për të investuar fuqishëm në sektorin energjitik të Serbisë, provokon frikën se kjo mund ta bëjë Serbinë më agresive në marrëdhëniet me fqinjët e saj, po ashtu edhe më pak të hapur për bashkëpunim.

3. Siguria Energjetike dhe Sfidat për Paqen dhe Stabilitetin

Ekzistojnë dy sfida të mundshme për sigurinë energjitime dhe stabilitetin në rajon;

- perceptimi i prezencës ruse në Serbi dhe implikimet e saj si edhe mundësia e rritjes së saj të shpejtë, dhe;

- kriza e statusit të Kosovës, e cila do të vazhdojë.

Lajmet mbi marrëveshjen energjitime Rusi-Serbi erdhën më tepër si një shok sesa si një surprizë. Nuk ishte shumë përmbajtja dhe volumi i marrëveshjes se sa lajmërimi i prezencës indirekte të Ruisë në rajon, që shkaktoi më tepër vëmendje. Pasi u shpall marrëveshja në Moskë, u vonua procesi i ratifikimit, kjo jo vetëm për shkak të zgjedhjeve të parakohshme në Serbi dhe të pazarllëkut pas-elektoral. Fakti që pala serbe – ose për të qenë më precizë, pjesa e qeverisë së re serbe – ndërmori iniciativën e rishikimit të marrëveshjes vetëm pasi ajo u nënshkrua, sollli një debat të madh politik në Serbi, pakënaqësi të konsiderueshme në Moskë dhe besim të theksuar në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor që marrëveshja mund të prishej. Përgjigja politike e Moskës u tregua përmes shumë vizitave të politikanëve.

Rusia – dyshuese se ndryshimi i mundshëm i palës serbe mund të ishte shkaktuar nga mundësia e një tjetër rregullimi energjitik – reagoi menjëherë. Ideja se debati energjitik me rusët mbi marrëveshjen energjitime mund ta çojë tanimë Serbinë në të njëjtën rrugë të ‘disiplinës energjetike’ – ashtu si shumë prej fqinjëve të Ruisë, si Ukraina, Polonia, Gjeorgjia, Bjellorusia etj. – bindën qeverinë që të shtyjë marrëveshjen energjitime drejt ratifikimit.

Çështja e paqëndrueshmërisë së Serbisë u bë një çështje që shqetëson BE-në, jo vetëm nga pikëvështrimi i stabilitetit rajonal, sigurisë “së fortë” dhe politikës por edhe nga pikëpamja e sigurisë energjitime. Fakti që Serbia ndaloi procesin e planifikimit të

gazsjellësit Rryma e Jugut, provokoi një shqetësim të madh në BE, veçanërisht në Itali, duke marrë në konsideratë që gjiganti energjetik, ENI, është një nga partnerët e Rusisë në projektin e Rrymës së Jugut. Shqetësimet lidheshin me faktin se Serbia, si një vend jo anëtar i BE-së, ka një përgjegjësi të madhe për një projekt të tillë kritik energjistik. Sasia e konsiderueshme e destabilitetit politik, çështja e statusit të Kosovës dhe një tërësi çështjesh të tjera të brendshme potencialisht problematike, e kanë bërë Serbinë një pjesëmarrës potencialisht të padëshirueshëm në këtë projekt të ndjeshëm për shumicën e aktorëve ndërkombëtarë.

Duke e parë çështjen nga një perspektivë rajonale, ka pasur një shqetësim të madh se mund të krijohet një disbalancë e konsiderueshme përmes kësaj marrëveshje energjitike, që për pasojë do ta shtynte Serbinë në pozicionin e një vendi udhëheqës në rajon, duke reduktuar deficitin e saj tregtar me Rusinë dhe duke rritur zhvillimin ekonomik. Gjithashtu, politikë-bërësit ndërkombëtarë i shqetëson frika se Serbia mund të tërhiqet nga pjesa tjetër e rajonit shumë shpejt dhe shumë larg. Mundësia që Serbia të ketë të gjitha të ardhurat dhe kushtet e domosdoshme për të përfunduar Korridorin 10, për të optimizuar sektorin energjistik, të zhvillojë plotësisht korridorin VII të lumit Danub, të privatizojë basenin minierë dhe bashkëshkrirës të Borit, të hedh marrëveshjen e suksesshme bërë me Fiat, dhe zbatoj shumë projekte të tjera strategjike të zhvillimit, shkakton më tepër frikë sesa kënaqësi që vendi po tërhiqet nga humnera e dekadës së fundit të shekullit të njëzetë. Rritja e fuqishme e Serbisë është stimuluar shumë krahas asaj të fqinjëve të saj, për shkak të kujdesit për të mos krijuar pabarazi në rajon.

Kosova është në një pozicion shumë delikat për shkak të debatit mbi statusin e saj. Ajo përballet me një situatë të skajshme për shkak të brishtësisë energjitike, paaftësisë për të prodhuar elektricitet të mjaftueshëm dhe muajt pasues të kufizimeve në 2008.

Rezervat minerale të Kosovës kanë qenë për një kohë të gjatë objekt spekulimi. Sipas një sondazhi të përbashkët të bërë në 2005 nga Drejtoria e Kosovës për Minierat dhe Minerale dhe Banka Botërore, është vlerësuar se burimet minerale të Kosovës kanë një vlerë prej 13.5 bilion €, duke e bërë atë një burim potencial të energjisë rajonale. Në këtë kuptim, të dhëna të tilla janë një arsye tjetër për Serbinë për të mos u tërhequr nga kërkesat e saj mbi Kosovën, duke marrë në konsideratë edhe vlerësimin se rezervat energjetike në Serbinë Qendrore janë duke u shtuar. Megjithatë, Kosova ka një problem kryesor në lidhje me faktin sesi të zhvillojë potencialet e saj energjitike për shkak të kushteve shumë të këqija të infrastrukturës së saj ekzistuese, investimeve domethënëse që duhen bërë si një parakusht për burimet energjitike

ekzistuese, dhe statusit të paqartë ligjor të pothuajse të gjitha vendndodhjeve. Megjithatë, ka interesime nga kompanitë e huaja për të zhvilluar minierat e saj, ndërsa Maqedonia ka ofruar shkëmbimin e qymyrit të Kosovës me elektricitetin.

U krijua një plan zhvillimi me qëllimin për të përmirësuar sektorin energjitik ekzistues të Kosovës, duke theksuar si zgjidhje privatizimin e sektorit energjitik, i cili nisi në fund të vitit 2006 me shpalljen e një tenderi ndërkombëtar. Vlera totale e projektit për ndërtimin e një stacioni të ri energjitik me një përlllogaritje 2,100MW, rikonstruksioni i një impianti të vjetër dhe zhvillimi i prodhimit të linjitet për të furnizuar këto impiante energjitike në rajon, pritet të jetë 3 bilion •. Është parashikuar që kostot do të rikuperohen nga eksporti i elektricitetit në Shqipëri dhe Mal të Zi, po ashtu edhe potencialisht në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Rezervat e mëdha të linjitet të zbuluara në Kosovë (sipas disa vlerësimeve deri në 12 bilion tonë metrikë) janë të lira për tu shfrytëzuar dhe sigurojnë një burim energjetik lehtësisht të arritshëm dhe të aksesueshëm për impiantet termo-elektrike të energjisë. Prania e këtyre rezervave formon një bazë solide për zhvillimin e sektorit energjitik në Kosovë, me potencialin e shndërrimit të saj në një aktore rajonale në tregun energjitik. Kosova ka tashmë dy blloqe të reja prodhuese të energjisë termale, "Kosova A" dhe "Kosova B", të ndërtuara ndërmjet viteve 1960 dhe 1984, me kapacitete respektive prej 800 ME dhe 678 MW, fuqia e përbashkët e të cilave nuk mund të kalojë 640 MW, për shkak të shkatërrimit fizik.

Pavarësisht faktit se statusi i Kosovës perceptohet nga shumica si një *fait accompli* (fakt i përmbushur), duhet të pranohet se për sa kohë që ka një debat ndërmjet aktorëve globalë dhe rajonalë mbi statusin e Kosovës, nuk mund të ketë progres të konsiderueshëm në çështjet energjitike të Kosovës dhe për pasojë edhe të mjediseve përreth. Edhe me skenarin e një privatizimi mjaft të suksesshëm të sektorit energjitik të Kosovës, risqet e larta të investimeve janë duke ulur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha opsionet për rikonstruktimin, zhvillimin dhe optimizimin e sektorit energjitik. Një nga problemet aktuale më të dukshme është mungesa e elektricitetit, ku Korporata Energjetike e Kosovës (këtu e më poshtë, KEK) nuk është e aftë të plotësojë kërkesat e sektorit të banesave. Kjo paaftësi vjen si pasojë e disa shkaqeve, ndër të cilat:

- Prodhimi i dobët i elektricitetit;
- Infrastruktura e dobët elektrike për shkak të shkatërrimeve dhe sabotazheve të mundshme, për shkak të keq menaxhimit prej vitesh dhe mos investimit;
- Shumica e popullsisë në Kosovë nuk i ka paguar faturat e energjisë për një kohë të gjatë;

- Paaftësia e KEK për të importuar/eksportuar elektricitetin për shkak të refuzimit të Serbisë për të paguar tarifën e vendosura ndërkombëtarisht kur dërgohet elektricitet në vendet e tjera të rajonit përmes Kosovës;

- Korrupsioni dhe mashtrimi financiar në menaxhimin e KEK, duke përfshirë si ndërkombëtarët ashtu edhe vendorët.

Kosova ka vuajtur prej vitesh nga kufizimet e energjisë, dhe situata ka arritur nivelet kritike gjatë muajve të dimrit, në disa zona të privuara nga energjia elektrike për më tepër se dhjetë orë. Ky problem është politizuar gjerësisht dhe është keq përdorur nga KEK, Beogradi dhe Prishtina. Zyrtarët e KEK, së bashku me liderët politik shqiptarë të Kosovës, kanë mohuar akuzat se ndërprerjet e energjisë si masë shpagimi me bazë etnike, duke e bazuar këtë më tepër tek faturat e papaguara, dobësitë infrastrukturore dhe prodhimin të pamjaftueshëm. Nga ana tjetër, Beogradi dhe liderët serbë të Kosovës pohojnë se një shpjegim i tillë mund të jetë i vlefshëm për disa raste, por nuk mund të justifikojë ndërprerjet e energjisë për enklavat serbe, të cilët për shkak të pasigurisë personale dhe kufizimit të lëvizjes, nuk mund të punojnë ose të kultivojnë zotërimet e tyre dhe për pasojë nuk mund të fitojnë mjaftueshëm për shpenzimet e tyre të jetesës dhe koston e energjisë elektrike. Agonia vazhdon për vite dhe Beogradi është duke negociuar me KEK dhe UNMIK për një zgjidhje të mundshme të problemit. E gjithë situata karakterizohet nga rreziku për sigurinë, acarimi i tensioneve etnike dhe parandalimi i një normalizimi për kushtet e jetesës në të gjithë Kosovën.

4. Rekomandime dhe Përfundime

Siguria energjetike është bërë çështja kryesore e marrëdhënieve ndërkombëtare në dekadën e kaluar. Ndërsa ka një rritje të ndërgjegjësimit për çështjen e sigurisë energjetike, ekziston nevoja për të zbatuar një sërë masash që do të siguronin një bashkëpunim më të mirë rajonal dhe ndërkombëtar, ndërsa diversifikohen burimet, si në lidhje me llojin ashtu edhe vendndodhjen gjeografike. Bashkëpunimi rajonal në aspektet elementare të sigurisë energjetike, duke nënkuptuar sigurimin e rrugëve të sigurta për transportin, është thelbësor. Ndryshimi klimaterik, lufta ndaj terrorizmit dhe sigurimi i furnizimit me energji – të gjitha këto janë sfidat globale bashkëkohore ndaj të cilave asnjë shtet nuk mund të përgjigjet i vetëm, prandaj bashkëpunimi është thelbësor. Bashkëpunimi pan-evropian është i një rëndësie më të madhe.

Prandaj, rekomandimet kryesore për këtë dokument janë:

- Në radhë të parë, siguria energjitike duhet të trajtohet nga çdo vend individualisht përmes një kuadri politikash të brendshme dhe planifikimit të vazhdueshëm. Ky duhet të jetë jo vetëm fokusi mbi sigurinë e furnizimit me energji por edhe i organizimit të strategjive të biznesit dhe korporatave në sektorët e tyre energjistik respektivë në rajon, me një konsideratë të përshtatshme mbi impaktin dhe efektin afatshkurtër dhe afatgjatë. Prandaj, zhvillimi i kuadreve të tillë të politikës së brendshme kërkon një perspektivë më të gjerë përkundrejt diskutimeve të gjera të të gjithë rajonit.

- Shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të hartojnë, financojnë dhe ndërmarrin kërkime shkencore dhe para-studime fizibiliteti që do të vlerësojnë kapacitetet e tyre për të zhvilluar, prodhuar dhe përdorur burimet e rinovueshme energjitike si era, energjia diellore dhe energjia hidro-elektrike. Përmes përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, shteteve do t'u jepet një mundësi për të diversifikuar burimet e tyre, duke pëmbushur kështu një nga kërkesat e para të sigurisë energjitike, rritjen e efikasitetit energjistik dhe dhënien e kontributit në zvogëlimin e ndryshimit klimaterik.

- Edhe pse nuk ka baza për t'u shqetësuar mbi mundësinë e armiqësive në rajon, duke u nisur nga prezenca e fuqishme e NATO-s, do të ishte sjellje e matur që të gjithë aktorët e rëndësishëm të zhvillojnë një plan gjithëpërfshirës pasigurie në rastet e veprimeve terroriste ose të veprimeve nga aktorë kundërshtarë jo-shtetërorë të tjerë (d.m.th sindikatat e krimit të organizuar, grupet terroriste ose grupet e dyshuara, etj.) kundër asetëve kyçe të energjisë. Për të evituar zmbropsje serioze në këtë drejtim, të gjithë aktorët relevantë duhet të adaptojnë një përgjigje sigurie dhe inteligjence efektive dhe të përshtatshme, e cila duhet të përfshijë një sistem paralajmërimi gjithëpërfshirës paraprak.

- Duhet të kthehen në prioritet shkëmbimi i informacionit kritik të sigurisë dhe të dhënave të inteligjencës që lidhen me sigurinë energjitike në nivel rajonal. Hapi i parë i ndarjes së informacionit duhet të jetë krijimi i takimeve rajonale të përbashkëta me përfaqësues të shërbimeve të sigurisë, së bashku me ministritë përkatëse dhe përfaqësuesit e sektorit të energjisë, me qëllim që të diskutohet situata rajonale e sigurisë energjitike.

- Duhet të ketë një përpjekje më të madhe për të përmirësuar procesin e Athinës për ndërtimin e një tregu të përbashkët energjistik në Evropën Juglindore. Kjo përpjekje duhet të integrohet më fuqishëm në programet e BE-së dhe procesin e anëtarësimit. Duhet të inkurajohet përmes kushtëzimit dhe ndihmës financiare një sistem i efektshëm që lejon shkëmbim më të mirë dhe përpjekje të përbashkëta në prodhim dhe akumulim.

- Zgjerimi si një masë stabiliteti – “më shumë, më të sigurt”. Me synimin për të siguruar stabilitetin dhe sigurinë energjitike në Ballkanin Perëndimor, BE-ja do të duhet të inkurajojë bashkëpunimin rajonal energjistik si një parakusht për anëtarësim.

- Është e domosdoshme për shtetet që të ndërmarrin veprime të koordinuara ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat në zhvillimin e burimeve alternative energjitike. Në rastin e Ballkanit Perëndimor, ky rekomandim duhet të vlerësohet në mënyrë të kujdesshme duke marrë parasysh institucionet e dobëta, një ekonomi tregu të pafuqishme dhe vështirësitë transitore të hasura nga secili prej këtyre vendeve. Kjo duhet të adresohet si pjesë e një përpjekje më të gjerë për të konsoliduar demokracinë përmes një fushatë kundër korrupsionit dhe rritjes së përgjegjshmërisë në sektorin e energjisë.

- Duhet të iniciohen seri takimesh multilaterale të cilat do të rezultojnë në një marrëveshje, me qëllim që të sigurohet bashkëpunimi rajonal, të vlerësohen rreziqet dhe dobësitë mundshme, të krijohet një plan veprimi që do të mund të ulë këto rreziqe dhe të propozohen zgjidhje që do të përmbushin interesat e të gjitha palëve rajonale të përfshira. Kjo iniciativë duhet të përkrahët dhe të udhëhiqet nga BE-ja. Duhet të ketë një organ të vogël e të qëndrueshëm koordinues, si agjencia rajonale e energjisë.

- Shtetet në rajon duhet të negociojnë një marrëveshje të përbashkët multilaterale që do të ndalojë çdo keqpërdorim të qëllimshëm të burimeve energjitike me qëllim që të detyrohet sjellja ose politika e shteteve të varura/përfituese. Një marrëveshje e tillë mund të përcaktohet nën parashikimet e “Komunitetit të Energjisë” ose në një dokument të veçantë ligjor. Do të duhet të ketë një mekanizëm verifikimi.

- Politika e fqinjësisë Evropiane është një instrument kryesor në promovimin e sigurisë energjitike në Evropë dhe për pasojë edhe në Ballkan. Masat e saj do të stabilizojnë jo vetëm mjedisin e drejtpërdrejt ose të zgjeruarin tregun për produktet e BE-së, por të garantojnë edhe sigurinë energjitike – sigurimin e rrugëve energjitike që vijnë nga ose përmes këtyre vendeve. Interesat e BE-së në stabilizimin e Ballkanit dhe ndërvarësisë në lidhje me sigurinë energjitike, e bëjnë BE-në mjetin ideal për zhvillimin e politikave efikente dhe të përshtatshme të sigurisë energjitike.

Prandaj, siguria energjitike ka potencialin e luajtjes së rolit kryesor si një masë e ndërtimit të besueshmërisë në Ballkanin Perëndimor. Me ndihmën e BE-së si dhe me vullnetin politik për të punuar drejt zgjidhjeve të përbashkëta, bashkëpunimi në fushën e energjisë do të realizojë një furnizim të përmirësuar dhe divers; ndërsa në të njëjtën kohë do të ndihmojë në lehtësimin e disa tensioneve të vazhdueshme etnike.

SUMMARY

Paul Belkin

The european union's energy security challenges

Recent increases in energy prices and a steady escalation in global energy demand — expected to rise by nearly 60% over the next 20 years — have led U.S. policy-makers to engage in a wide ranging debate over how best to address the country's future energy requirements. Similarly, energy security has become a policy priority for the European Union (EU) and its 27 member states. The EU imports about 50% of its energy needs. Barring significant changes, the European Commission expects this figure to rise to 65% by 2030. About half of the EU's natural gas imports and 30% of its imported oil come from Russia. Europe's growing dependence on Russian energy, and long-term energy agreements between Russian firms and some European governments have fueled speculation that Moscow is using the "energy weapon" to try to influence European foreign and economic policy.

The EU has traditionally exerted little if any influence over individual member state energy policy. However, in March 2007, in the face of increasing concern about Europe's reliance on Russian energy, and growing public pressure to address global climate change, EU member states agreed to forge an "Energy Policy for Europe."

They have agreed on a set of EU-wide targets — some legally binding — to increase the use of renewable energy, and reduce carbon emissions. However, member states continue to pursue divergent external energy policies, particularly toward Russia, and some European countries remain reluctant to cede national control over energy markets. The United States and Europe have steadily broadened the transatlantic energy dialogue to include joint promotion of collective energy security, energy efficiency and alternative energy sources. At the April 2007 U.S.-EU summit, leaders on both sides of the Atlantic agreed to advance cooperation to develop alternative and renewable energy technologies. However, U.S. officials have expressed concern

at some European member states' unwillingness to exert more pressure on Russia to comply with EU market principles. On the other hand, European leaders appear increasingly frustrated with U.S. reluctance to pursue binding multilateral regulatory frameworks to reduce carbon emissions and promote energy efficiency.

This report examines some of Europe's critical energy security challenges and EU efforts to coordinate a common European energy strategy. It also includes an overview of broader transatlantic energy security cooperation.

Stefan Bouzarovski
**Post-socialist energy reforms in critical perspective:
Entangled, boundaries, scales and trajectories of change**

Despite its extensive political, economic and social ramifications, the process of energy sector transformation in the post-socialist states of Eastern and Central Europe (ECE) and the Former Soviet Union (FSU) has received very little theoretical attention to date. This paper draws attention to the multiple ways in which the energy reform experience of the past two decades has undermined established understandings of scale, reform trajectories and national boundaries in this part of the world. With the aid of concepts developed in Science and Technology Studies (STS) and Actor Network Theory (ANT), is discussed the ability of energy relations and interdependencies to create material and political 'topologies' and 'entanglements' of power in post-socialism. This exploration is grounded in a discussion of the tensions between the legacies and path-dependencies inherited from the centrally planned economy, on the one hand, and the neoliberal project for energy sector reconfiguration that became the dominant reform paradigm in the early 1990s, on the other.

Csis-Ekem policy report
Re-linking the western balkans: The energy dimension

The wars of Yugoslav succession that dominated the first post-Cold War decade of Southeast Europe's political and economic development have had structurally negative repercussions for the energy industry and infrastructure in most West Balkan states. It was only after the establishment of the Energy Community

Treaty in 2005 that a robust regulatory framework was established with the purpose of streamlining the region's economies with EU transparency and liberalization norms so as to prepare the West Balkan region for a massive inflow of foreign direct investment (FDI) that could rejuvenate the energy infrastructure and more effectively utilize each country's energy resources.

Despite the fact that the EU and the West Balkan states face the common challenges of increasing energy efficiency, reducing import dependency, and expanding renewable energy sources (RES), the current state of affairs in the region is inadequate or sub-standard, with the sole exception of Croatia, which has advanced significantly in aligning its legislation and policies with the EU *acquis communautaire*. The report gives an overview of different position of the West Balkan countries along the path of European integration and also the varying energy and environmental standards and targets that they possess. Finally, the concluded policy recommendations focus on greater cooperation, harmonization, and integration in Southeast Europe in all its dimensions, from transportation and trade to energy and security, and reveal a significant contribution to gradually integrate all the Western Balkan countries into the European Union and NATO.

Viktoriya Khasson

Discourses and interests in eu-russia energy relations

The aim of the present paper is to assess the impact of different discourses on the EU-Russia energy relations and how these discourses, which dominate the policy formulation process are reflected also in the policy practices. Two distinct discursive practices are identified: one of integration (based on the promotion of liberalisation pertinent to the internal EU energy market) and another one, of securitisation or diversification (based on the assumption that energy security needs to be addressed as a separate issue of the EU foreign policy). It is argued here, that the securitization discourse which appeared following the supply disruption crisis has been dominating and hampering integration practices in the EU's energy relations with Russia. Russia is increasingly perceived as an unreliable energy partner and its external energy policy is largely viewed as a tool of political pressure on the energy dependant Russian neighbours and even as a threat for the EU energy security. Therefore, the paper starts by looking at EU-Russia energy

relations in the context of the growing assertiveness of the Russian energy policy. Then, it analyses the ongoing process of the EU external energy policy formulation. Finally, the interplay of these discursive practices is being assessed in the context of EU - Russia energy relations, in particular, around the issues of the Russian supplies transit to Europe and the access to the Caspian energy resources. In conclusion, some observations are made about the perspectives of energy cooperation between Russia and the EU.

Dušan Janjić

Energy security and ethnic conflict- challenges in the western balkans

At the end of the last century, a real geo-political storm shook the world, and in particular Europe and its former Communist states. At the centre of this storm stood the need to provide energy as a basis of life and the development of a modern society. Therefore, the issue of 'energy security' has become one of the most significant questions at the moment. Peace and stability in the region of Western Balkans, which has been affected by ethnic conflict at the end of the last century and which still face several threats, is essential in order to guarantee the security of oil and gas supplies for the EU. Finding themselves at a particular crossroads between the Caucuses and Europe, and bordering the Middle East and North Africa, the Western Balkans are – by virtue of their geo-strategic position – a crucial element in Europe's energy security dilemma. The paper starts with presenting energy security question in the twenty-first century as the most discussed issue and the top priority of national, international and intergovernmental organizations and bodies agenda, around the world. It gives an overview of the present energy security question in the Western Balkans in view of Russian energy policy and the possible threat to peace and stability to this region, referring mostly to Kosovo-Serbia conflict and Russian energy policy implications towards it. Finally, recommendations on how to address the main challenges the whole region is facing are the final part of this paper.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 17

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 22 40 116
Tiranë, 2010